

BAHRI MYFTARI

BIBLIOTEKA

884-32  
M 99

DUYETEN  
DOD


Onufri

8JH-32  
1498

BAHRI MYFTARI

BAHRI MYFTARI  
1498  
1498

QYTETI IRIQ



1498

ONUFRI

## **QYTETI IRIQ**

**N**ga ai qytet i vogël buzë detit, në se hyje në lidhje me ndonjë nga ata kapidanët e motoskafëve, për dy orë gjendeshe në bregun tjetër të Jonit. Berti nuk njihet kërkënd aty, ose më saktë, kishte pasur një farë rekomandimi, por pasi rrahu këmbë tri ditë me radhë për ta gjetur, hoqi dorë dhe tanë e vëtmja shpresë për të krijuar lidhje midis tij dhe kapidanit, ishte ajo biondja, që shërbente tek lokali "Pranë Detit", ku ai pinte kafen në mëngjes. Biondja ishte alamet vajze: e gjatë, e kolme dhe me ca sy të goditur keqas prej makiazhit e që tregonte qartë se ajo, prej vitesh, i kishte thënë lamtumirë virgjërisë. Miqësinë me të e nisi me reston e rëndomtë e me ca qerasje të lehta buzë mbrëmjes, e edhe pse e kuptonte se ajo ziente nga dëshira për të frekuentuar ato lokalet e vogëla gjysmë të ndriçuara buzë detit që, për djall, kishin mbritë si kërpudhat pas shiut, ai s'guxonte ta bënte atë hap. Ky qytet i vogël, sa pëllëmba e dorës, që lagej deri tek këmbët nga ujët e detit, e kishte futur shpejtë jetën e natës nën sqetull. Por ai s'kishte ardhur për ta shijuar atë. Ai vinte nga një qytet, që edhe pse ishte një 20 herë më i madh se sa

ky qytet iriq, sepse e pagézoi me këtë emër qytetin buzë detit, një zot e di, -pra nga një qytet ku ende vazhdonin ca rregulla të vjetra, por që çuditërisht i pëlqente dhe administryratës së re, ora 22 i gjente gjithë banorët në shtëpi. Ai vinte nga një qytet ku asistenca kishte bërë kërdinë, ku dhjetra shokë të tij, madje të specializuar edhe jashtë, kishin rrëmbyer tezgat, mbushur me çamçakiz e mbroçkulla të tjera e rrihnin ujë në hava, atje tek pazari pranë selvive të famshme. Bertit i kishte mbaruar asistenca, përkrahja sociale s'ishte për shpatullat e tij, aq më tepër për stomakun. Prandaj këmbanat e biondes binin më kot, ai s'kishte veshë për to. Dhe ndonjë qerasje që bëhej, i nënshtrohej në darkë nga llogaria e dhjetfishitë. C'ishte taksur për kapidanin ishte e paprekëshme! Ata ujjqër nuk lëshojnë pe për kësi, punësh. Me këtë gjendje hyri tek lokal "Pranë Detit". Do t'ia priste shkurt bjondes. Nuk mund ta shtynte më gjatë me dy amburger në ditë, me katër pesë kafe për vete dhe me pesë-gjashtë limonata për vajzën, e cila, edhe pse ishte e tëra kofshë tërë seks, atij i dukej se mbante në krahë tezen e vet. Hyri në lokal dhe zuri vend në tavolinën e këndit. Ajo e pa dhe, ashtu siç ishte ulur atje te një karrike rrrotulluese pranë banakut, u kthyte gjithë gëzim drejt tij. Sot, as ujë çezme nuk të jap, në se nuk më thua ndonjë lajm të gëzuar, tha më vete Berti. Ajo i bëri shenjën e zakonshme se do të takoheshin pas punës. Ai e miratoi me kokë. Ndërkohë u dukën tek dera dy burra. Njëri, një cilak i vërtetë, thinjosh plotësisht por që ato zor se trëgonin moshën e vërtetë të tij, vështroi nëpër lokal sikur të kishte hipur mbi kalë; tjetri ishte më i shkurtër, por dërdëng nga shëndeti dhe me ca buzë si prej arabi. Berti i njohu me të parë. Dikur, të dy ata, kishin qenë vartësit e tij në Institutin e Mekanikës. Dhë, ishin pikërisht ata të dy që i vunë kazmën asaj bërrthame shkencore dhe papërdorur asnjë argument, asnjë arsy, yetëm e vetëm me armën e mediokrititetit, se që të dy ata nuk arriten kurrë as tek mesatarja e kolegëve të tjerë. Me t'i bërë gropën institutit, u përzjenë që të dy në politikë, natyrisht më tepër kafeneve e nëpër salsa të mbyllura, por çuditërisht të dyve u kish ecur fati, kishin bërë karierë. C'punë të mirë mund të presësh prej tyre vallë! - belbzëoi Berti aty pak mënjanç. Thinjoshi ishte po ai, po ai që Berti e mbante mend që 20 vjeç, me kokën të tërë gri, me ato dhembë gjithnjë të pandreqshëm, që kundërmonte erë të keqe edhe kur mbante cigare të ndezur në gojë. Tjetrin, atë bullarin e shkurtër, ai e kishte njohur gjatë kohës së punës në institut, një manjak sekzi pakufi, aq sa së fundi vuri dorë edhe mbi pastrueset e institutit, por që s'u muar vesh. Berti në

atë kohë ishte drejtuesi kryesor dhe më tepër nga turpi, pér hir të opinionit, bëri c'ish e mundur dhe e mbylli.

Ata shkaktuan pak zhurmë kur u ulën dhe po atë çast lëshuan një përshtendetje me kokë drejt Bertit. Nuk kishte ndonjë shenjë entusiaste në atë salutim, por edhe ndonjë gjë e keqe nuk u vu re, megjithatë prania e tyre, atje përballë, Bertin po e shqetësonë së tepërmë. Një mëndje i thosh të ngrihej e të ikte sa më parë, por ja ai kamarieri i krrusur që shërbente nga ana me dritare, vuri menunë mbi tavolinë. Si të bënte? Por edhe pér të ikur nuk i ikej. Atyre, me siguri do t'u bëhej qejfi dhe, pa dyshim, do ta quanin fitore largimin e tij, sepse pér fitore të tilla ishin prerë ata. Jo, s'kam përsë të iki. Dhe, si pér inat, ai pasi bëri një llogari të shpejtë me mend, porositi plot guxim një drekë që do ta kishte zili edhe një paralli i thekur, madje kur porositi shishen e verës e ngriti zërin goxha lart. Po lozete me gishtrinjtë e vet mbi tavolinë, a thua sikur çdo gjë i shkonte mborth, veçse herëpashere, duke hedhur shikimin shkarazi tek lista e çmimeve, betohej se kjo gafë s'duhej përsëritur më, por u pa që do të sakrifikonte darkën, rrezik edhe mëngjesin e të nesërmes.

Kamerieri i krrusur pruri porosinë dhe ai filloj të përtipej. Hante por i dukej sikur ushqimi i shkontakte në kurriz. Por sikur, tha, sikur ata ta marrin vesh se ja, eprori i tyre, docenti i shkencave të mekanikës, kishte ardhur këtu, këtu në këtë qytet... - s'ia zuri goja epitetin "iriq", - pér t'ia mbathur matanë detit! Jo, vetëm këtë ata s'duhet ta marrin vesh kurrrë, madje në se ata e kuptojnë qëllimin e ardhjes sime këtu, unë do të kthehem, po, po do të kthehem, jo tezgën, por edhe karrocën e plehrave do ta punoj me qejf! Unë këtë gëzim atyre kurrë nuk do t'ua jap...

Atij iu bë sikur kishte folur me zë dhe një përskuqje e lehtë i ra fytyrës. Kërkoi me sy kamerierin, por në vend të tij, erdhi një bukuroshe nja 17 vjeçë.

-Mos dëshëroni kafe, profesor?

Ai e vështroi i çuditur, por buzëqeshja e saj sikur ia nxorri fjalët shpejtë e me rrokullimë.

-Jo... do... dua të paguaj.

-Dreka është e paguar, -tha ajo me atë buzëqeshje, por që tani ai pati mundësi ta kundronte e ta shijonte më qetësisht atë ëngjëll që e kishte fare pranë.

-Jo, jo zonjush, -u ngrit paksa, por ata ishin larguar. Zuri të nxirrte lekët. Ndërkohë dora e butë dhe e lehtë e vajzës u ledhatua si një flutur mbi të tijën. Ai ndërpreni veprimin që pat nisur e në

**zjarrillék tē plot dēgjoi zérin e saj tē ēmbēl:**

-Ju lutem, -tha bukuroshja, -Ata tē dy ishin dy miqtē e tu, nuk i paske njobur?

Ai nuk foli, por ndjeu se ajo dorē e vogēl, pasi peshoi diçka mē tepēr mbi tē tijēn, u tērħoq ngadalē.

-Por janē dhe miq tē ngushtē tē pronarit. Unē pata fatin tē rrija disa minuta me ta nē verandē. Ata juve ju quanin porofesor... Pra, pēr sa kohē do tē qəndroni nē qytetin tonē, jeni i mirēpirtur kētu. Kētē e kam porosi, por unē... unē... Ajo lēshoi aty buzēqeshjen e saj marramendēse, - unē dhe vet do t'ju prisja gjithē kēnaqësi. Kaq tha. Bēri njē pērshendetje tepēr femērore e me buzēqeshjen e saj u duk sikur fluturoi. Ai largoi gjendjen e hutimit e, pa parē as majtas, as djathtas, doli nē rrugē. Aty e ndjeu veten tepēr tē kēputur, tepēr tē lodhur sikur sapo kishte mbaruar njē maratonē tē vērtetē. Si ta cilēsonte xhestin e dy ish vartësve tē tij?! Thjeshtē, nē respekt tē kujtimit, tē viteve tē shkuara? E ç'kujtime na kishin qenē ato! Ata, gjatē kohēs qē po prishej instituti, kishin qenē kundërshtarët e tij mē tē rreptē.

Megjithatē Berti vetēm kishte argumentuar e ai qē ka argumentin s'ka pērse fyen, por, ama, s'ka edhe pse lavdëron! Jo, ai tē dyja kēto nuk t'i jep. Po atēhere... pērkundrazi ata... ata qē s'kanē ç'thonē kēpusin dokrra. E ca tē tyre ai, docenti i mekanikës, ende i mbante mend. Ndoshta ai bullari s'e ka harruar mbrojtjen qē i bëri pēr atē turpin me pastruesen. Ndoshta, ndoshta! Jo, nuk janē tē tillē ata, jo! C'ka qenē ȫshtë kthyer nē pērrallē pēr ta... Punët e shumta, detyrat e mëdha qē kanē zenë, ironizoi Berti, s'u lënë kohē tē merren me kujtimet. Xhesti i tyre ȫshtë thjeshtē njē lëmoshë, lëmoshë! Ai pështyu. Drekë mē tē ndyrë kurrë s'kam pasur!

U kujtua se kishte ardhur nē atē lokal pēr tē takuar bionden. Largoi si me urdhēr tērē pērsiatjet qē i sulmonin qënien. Zuri njē vend pranē njē kioske e priti, priti... S'kaloi shumë dhe ja, u duk ajo. Me atē fodullékun e saj, me atē krenari qē s'dihej nē ç'dreq burimi pinte ujé! Ai i thirri, i thirri. Ajo, jo vetēm qē s'ndaloi, por me hedhjen e atyre flokëve bjondë prapa supeve, tērē nerv, sikur po i linte lamtumirën. Ai shpejtoi dhe fare pa trup e kapi bërrylin.

-Hiq dorën! - tha ajo.

Dy-tre kalimtarë tē ngeshëm zunē tē qeshin. Berti ndaloj dhe, si pēr inat tē tij, biondja, pasi ishte larguar goxha, thirri:

-Mashtrues!

Atēhere ai guxoi. Nuk pyeti mē se ç'njerëz kishte aty pranē.

me hapa të shpejta e arriti.

-Unë mashtrues?... Pse, çfarë? Për çfarë të kam mashtruar?

Ai gati sa nuk i tha se mos vallë ajo kishte pritur që ai t'i vinte në gisht unazën? Mos vallë i kishte kaluar ata 35 vjet beqar, vetëm e vetëm se në një fall që patën hedhur dikur, e pa të përcaktuar qartë se nusja e tij do të ishte në këtë dreq qyteti, që të shtrydhëte, të tkurrte, duke të dreqosur në mendje, me zemër dhe, nusja do të ishte pikërisht ajo pelë e bardhë që kishte në krahë e që hidhët shkelma sikur të ishte në lëmë!

-Fol këtu, - i tha. -Mos më luaj teatër!

-Teatër luan ti, -ia ktheu ajo.

Do që kjo përgjigje atë gati e çarmatosi e mend pohoi hapur se vërtetë po luante teatër, por jo me të tjerët, me veten e vet, madje po luante rolin e palaços, veçse tjetër gjë tha:

-Ke ndonjë informacion, apo jo?...

-Po, -kërceu bjondja dhe përsëriti : -Ti je mashtrues. Në se do... e ke qejf të bësh me mua dashuri, mos m'u hiq si vagabond, refugjat...

-Pse ç'jam? -tha ai si në faj.

-Sot pronari e zgjidhi nga zinxhiri konen e vet. A nuk të shërbeu Ada ty? E, pra, ajo është konia e tij dhe zgjidhet vetëm për ju, për ju profesor, për pecogrosot, për ju të zgjuarit, të mençurit, se ju po na bëni vezën e kuqe...

Ajo gati u shkreh në vaj.

-Unë nuk hyj fare këtu, - u përpoq ai ta qetësonte.

-E dëgjova me veshët e mi, kur i dha urdhër asaj, asaj kones që vetëm të lëpihjë di, t'u shërbejë juve... Juve, profesor i madh!

Berti qeshi nën buzë.

-Na ishte një herë një profesor, - tha, -madje jo i madh... Pra, tani unë jam, jam një ish, një... Kot fliste.

Bjondja u dha edhe njëherë flokëve prapa dhe çau me hapa të shpejtë.

... Dhe ti trembesh prej një ishi, prej një që na ishte një herë ... e që tani... Çfarë duhet të bëjë tani? Budallaçka, tha për bjonden, kur e pa që ajo doli tutje tek kthesa. Jo, tha, s'duhet ta lë të më iki. Po më iku dhe ajo ç'të bëj? -ia dha vrapi. sikur të ishte në një pistë stadiumi. Atje tek kthesa, ku bjondja kishte humbur përfundimisht, ai, për çudi ia dha një të qeshure në ekstazë, por që më tepër ishte një përqeshje, ndoshta jo shumë e përcaktuar: për vete, për ata që e shikonin, apo për të gjithë, për të gjithë.. Pas pak u qetësua, gulçte

dhe u tremb tej mase kur vërejti se pështyma po i varej si shkumë. Të kthehem, të largohem sa më parë! Na atë gjendje siç ishte, si në një tynmajë të dendur, iu shfaq qyteti i tij, ai sheshi i selvive të famëshme, por që tani nën to baresnin, nxinin nga vapa e dridheshin prej të ftohtit njerëz dhe shokë të barabartë me të, duke mbajtur përparrë vetes tezgat e çmendura dhe ato arkat e shtrembëra e të shqyera. Nuk duhet të tërhiqeni, zotni, jo, nuk duhet të tërhiqeni, përkëdhelte veten jo dhe pa ironi.

Ishte pranë hotelit. Ç'të bënte më jashtë? Dalëngadalë po binte mbrëmja. Dielli, i kuq flakë, po rrokullisej në det. Hyri në dhomë. U zhvesh me aq kujdes, sikur të ruhej mos zgjonte dikë dhe u shtri, por gjumë jo. Ai ishte trembur prej syve dhe kishte marrë arratinë. Tamam si unë, tha, veçse me një ndryshim. Arratinë e kam marrë, por ama, ama stomakun e kam plot. U zgjat, mori protofolin. Kishte qenë dita më e kursyer. Asnjë lekë nuk kishte prishur. Dhe këtë nder ma bënë ata. Ai përfytyroi thinjoshin, me ata dhembët e krimbur dhe atë bullarin, që me siguri, duhet të jetë, tha, sipër ndonjë femre. Po pse, pse e quajte nder xhestin e tyre? Po sikur të jetë lëmoshë! Ai numëroi persëri paratë. Pjesa e kapedanit ishte më vete dhe e pacënuar. Shumë mirë, tha. Mos vallë edhe lëmosha, në një farë kuptimi, nder është? Po e kuptonte dhe madje po e ndjente se diçka, fare pa dashjen e tij, po i lëvizte prej karakterit. Dikur e zuri gjumi. Në mëngjes u betua të mos kujtonte asgjë për të djeshmen. Të gjente patjetër bjonden, t'ia fuste këmbët në një këpucë, siç u shpreh, të hynte në lidhje me atë birbon e motoskafit, që të merrte fund kjo punë, punë m...-tha.

Doli me të shpejtë. Ishte një mëngjez i mrekullueshëm. Deti ishte si vaj, qelli i pastër, i pastër deri në çudi, madje edhe njerëzit më të ngeshëm, por atij s'i duhej asgjë nga këto. Ai e dinte prej kohe e ja, tani bindej pse për këtë qytet ishin pictuar aq peisazhe, ishin shkruar aq poezi. Mirpo ai i kishte vënë epitetin "iriq". Do të zemëroheshin piktorët, do të shanin poetët. Punë e madhe! Biondja, bjondja më duhet. Shkoi drejt e tek lokali "Pranë Detit". Me t'u ulur, u rrëthua prej gëzimit dhe fërfërimës së Adës. Ada e djeshme ishte tjetër gjë sot; e bukur, po e po, por më e afërt, më e ngrohtë.

-Po të prisja, -tha ajo. -Po të prisja. Dhe shtrëngimin e dorës e shoqëroi me një lëvizje beli, që ia pruri trupin e brishtë e ndjellës m'u pranë kofshëve të tij.

Ai po kërkonte me sy bionden. Ada e vuri re dhe pa farë ngurimi e përkëdheli tek mjekra, duke e detyruar atë të shihte drejt

saj.

-Sot jam unë në dispozicionin tënd, -tha. -Është urdhëri i pronarit. Ai ka dalë në det dhe më urdhëroi mua t'u shërbej, dhe lëshoi buzëqeshjen e saj, sikur të kishte pranë idhullin që e priste prej 17 vjetësh, sa ç'mbanin ato dy supet e vegjël, në ngjyrë gruri e që shkonin deri poshtë lakuriq.

-A nuk jeni i kënaqur, profesor?

Atij iu duk se ajo, nga çasti në çast mund t'i hidhej mbi gjunjë. Ndërkohë, një thyerje gotash, plot zhurmë, u përhap nëpër lokal.

-Hopa! - bëri Ada. Uaaa! Ç'shtrigë!- dhe tregoi me sy bionden që po mblidhë copat e gotave të thyera. -Nesër, me siguri, qërohet prej këndeji.

Berti s'e dha veten por e pa qartë se të dy vajzat jo që s'kishin shkuarje, por mund të ishin armike me njëra-tjetrën. Megjithatë ai s'pati kohë të filozofonte më gjatë. Ai kamerieri pak i krrusur, serviri dy pajtanca dhe dy shishe vere mbi tavolinë.

-Për të gjitha këto e për ç'të duash, përgjigjem unë, -tha Ada.  
-A doni t'u mbush gotën?

Berti, si i zënë në faj, e bëri vet atë veprim. Kjo gjendje pak si e nderur kaloi shpejt dhe ajo që pruri harenë dhe humorin, para se të ishte vera në gotë, ishte vajza që edhe pse tepër e re, ishte një mjeshtre e vërtetë me intimititet që krijonte. Në të errur dolën nga lokali. Ai propozoi një shëtitje buzë detit. Ajo refuzoi, por refuzoi me aq takt sa tjetrit iu duk se e priti me kënaqësi. Afër hotelit vajza i zgjati dorën për t'u ndarë. Ai s'pranoi. Tani vera e kishte mbërthyer mashkullin tek dobësia e vet.

-Jo, -tha ajo. -Herë tjetër.

-Tani! -këmbënguli ai.

-Herë tjetër, - pëshpëriti ajo. Xhesti lozonjar i saj i dha kurajo. Ai e përfshiu për beli.

-Ju lutem! -u dëgjua më e vendosur ajo.

-Atëhere, një qerasje ne Bar, -tha ai.

-Në Bar, po, -tha ajo. -Veçse s'jam unë që përgjigjem.

Ajo bëri shenjë. Ishte puna për paratë. Ai trokiti gjithë entuziazëm tek xhepi i vet dhe të dy përfunduan në thellësi të Barit, nën tingujt e një muzike ritmike.

Vonë dolën prej andej. Ai, më shumë duke u zvarritur arriti tek dhoma e porositur në katin e dytë. Ai aty e rrëmbeu përsëri prej beli, por ajo prapë rezistoi, madje dhe e shtyu

-Po tē ishin ata, ata tē dy miqtë e mi, ti nuk do tē refuzoje, nuk- atij iu muar goja. -Edhe pse njeri... ai, ai me qime që qelbet... kurse tjetri bu...ba....bu... S'mund tē fliste më gjatë. Dikush që shoqërontë Adën, u dha aty papritur dhe, duke e shtyrë me forcë e çoi Bertin direkt e mbi shtratin e tij, ku ai më tepër se sa fjeti, humbi pér gjithë natën.

U ngrit në mëngjes si i rrahir me kopan rrobash. Më e keqja ishte se dhe mbi sasinë e caktuar pér pazarin me kapedanin e motoskafit, ishte venë dorë dhe madje rëndë. Ç'do tē bënte! I kaloi ndër mend tërë dita e djeshme. Dhe ajo kishte qenë ditë e keqe, e ligë, madje e poshtër. I erdhi turp nga ç'ka kujtoi. Dhe atje në Bar do tē jem dukur karagjoz i vërtetë, një sharlatan, një m... U hodh mbi shtrat, gati tē lotonte. Profesor, profesor, sikur dëgjoi në koridor, por jo ishte gabuar. Kush e zuri këtë fjalë në gojë në këtë qytet? Ç'ishte kjo fjalë më pér të? Ajo s'është më. Tani ai është: ishi... ishi! Dhe ata tē dy, -tha pér ish vartësit e tij, -dhe këtë e quajnë një fitore. Dhe ata pér fitore tē tillë janë...

U dëgjua një trokitje në derë.

-Profesor, ju presin në holl.

Ai u ngrit. Mbajti vesh, por zëri nuk u dëgjua më. Lau edhe një herë sytë. Kjo është thjeshtë tronditje, tha. Ose, e tëra kjo është një gjë e ndyrë. U nxeh, por më tepër me vetveten. Në këto raste duhet bërë tutje, duhet bërë para, vetëm përpara! Zbriti shkallët. Vërtetë aty në holl dikush e *priste*. *Ishte bionda*. Ajo, me ta parë, shpërtheu në dënesa. Ai u përpoq ta qetësonte dhe kur e arriti pjesërisht këtë, ajo i tha se pronari e kishte pushuar nga puna dhe shkaku kryesor na paskej qenë fyterja që ajo i kishte bërë Bertit...

-Po ju nuk më keni fyter, jo aspak, i vetmi gabim juaji është që ju nuk besuat se unë jam thjeshtë një ish... pra, ti e kupton...

-Unë jam papunë tani, - e ndërpreu ajo. -Dhe ja kaq gjë e dini: ç'do tē thotë tē jesh femër dhe e papunë! Unë nuk dua tē breth me si dikur rrugëve të Athinës. Jo, nuk dua! ... Ajo shpërtheu në një tē qarë që tē rrënqethëtë mishtë! Njerëz tē tjerë u *grumbulluan* pranë tyre.

-Ju, vetëm ju mund t'ia ktheni mendjen atij, - ulëriu bionda.

Tashmë ai ishte têrhequr drejt derës së jashtme. S'dua tē breth rrugëve të Athinës, s'dua ... kumboi edhe një herë zëri i biondes dhe se ç'u bë më tutje ai kurrë s'e mori vesh. U nis pér tek lokali "Pranë Detit". Do t'i thoshte pronarit tē vërtetën. T'i thoshte se ai nuk ishte kthyer kurrë në shkak pér t'u bërë fatkeq tjetri, përkundrazi: dhe tē

mirën, kur e kishte pasur, ishte përpjekur ta ndante me ta afërt e ta largët. Aq më tepër biondja... Rrugëve të Athinës... rrugëve! Po a nuk po merrte edhe vet rrugët?... Ky qytet i mallëkuar, palë-palë e paska edhe të keqen, siç ka gurët, njerëzit, dallgët e detit... S'po dinte ç'të bënte edhe pse ziente i téri. Me t'u gjendur para hyrjes, ai u ndesh me Adën. Ajo sot vërtetë ishtë kthyer në mrekulli. Kishte veshur një fustan të lehtë, të lehtë, bojëqielli dhe të krijonte idenë se nga çasti në çast do të shkonte drejt qiellit. Ajo hidhej e përdridhej para tij duke lëshuar një lumë fjale fyterjesh e sharjesh për bjonden. E quajti xhelozë, egoiste, imorale. Ma lau paq një borxh të vjetër që më kishte. Ajo duhet ta kuptojë qartë se njerëzit që duhet t'u bëjë shoqëri ajo, janë vetëm ca peshkatarë e ca rfeugjatë morracakë... e jo ti, jo ti profesor!

-Ku është pronari?

-Sot jam unë në dispozicionin tuaj, madje jo vetëm për në Bar por edhe...

Ai vështroi përqark, sikur ruhej prej dikujt. Iu kujtua orgjia e djeshme. Po, po, orgji kishte qenë!

-Në ç'kat të hotelit është dhoma? -pyeti e queshte ajo. Ai lëshoi një kollë të thatë.

-Domethënë, sot...

-Sot jam me ty, -tha ajo.

-Po dje, a pardje ishe me ata miqtë e mi? - ironizoi ai.

-Unë atë e kam punë dhe ju s'kini pse më fyeni.

-Era e qelbët...

-Çudi! - u tërhoq Ada. -Ata s'të kishin aspak inat... përkundrazi...

-Dhe ti fijete me të dy?

Berti s'desh të tërhoqej. Ajo bëri të largohej dhe ai desh i thirri : Kurvê! -por ndrrroi mendje. Nga dita që kishte ardhur e deri tani çdo gjë e quajti kurvêri, prandaj e shtrëngoi fort krahun e bukur të saj dhe pyeti ndryshe:

-Ti sot ke marrë urdhër të rrish me mua e s'mund të largohesh, apo jo?

Vajza nuk foli.

-Por unë do të largoj vetë, veçse me një kusht: të më tregosh ku është pronari?

-Ka dalë në det, -tha ajo e frikësuar.

Berti nuk i besoi. U hoq më i qetë dhe duke buzëqeshur, i futi krahun, duke e ftuar të ecte. Të dy pas pak ata ishin buzë detit.

-Pse s'do tē më besosh? -tha vajza.

-Ai është pronar lokal i s'ka punë në det, -tha ai.

-Ai është pronari i gjithë skafeve që hedhin njerëzit matanë detit, -tha vajza tepër e besueshme.

-Ai është kapiteni?

-Ai është kreu, tha Ada, që ndaloj atë çast e shtoi me zë lutës: -Të lutem, këto s't'i kam thënë unë! Dy miqtë e tu prandaj erdhën këtu... Ata bënë ç'ish e mundur që të zhbllokohej... Pse habitesh?

-Jo, unë s'po habitem fare.

-Atëhere, pse më sheh kështu?

Ai ndjeu keqardhje dhe lehtë hodhi dorën e djathtë mbi supet e vajzës.

-Ata miqtë e tu ishin tepar tē fuqishëm.

-Veçse qelbnin... nbjëri, pa tjetri...

-Pikërisht ai tjetri fliste më mirë për ju, madje ai e urdhëroi pronarin...

-Bullari, -e ndërpree ai. -Po si, si the, Ada, ata janë tē fuqishëm?... Dhe kush? Ata, ata që edhe për një zyrë 3 me 4 ishin tē tepërt...

-Ata, - vazhdoi vajza, -çajnë dete dhe oqeane...

Hëm, ia bëri Berti dhe iu drodh trupi, si nga një rrëqethje e tmerrtë, kur kujtoi se po tē mirrnin vesh dy vartësit e tij që ky, tashmë, ndodhej në këtë qytët në përpjekje për tē migruar si dhjetra shokë tē tij përtej detit, ata tē dy, përmes një ngazëllimi ogurzi, do tē dëshëronin tē degdisej në humbëtitrat më tē largëta tē rruzullit, mbasë diku në ishujt e Oqeanisë.

Hëm, ia bëri Berti për herë tē dytë dhe ndjeu t'i mbushej goja me hidhërim. Ai u largua nga vajza, sikur mos e kish takuar kurrë.

-Profesor, profesor!

-Çajnë dete e oqeane... -ironizoi ai. -Dhe çajnë vërtetë. Ata çajnë dhe vendin e tyre dhe përsëri këtë e quajnë fitore... Dhe për fitore tē tilla ata janë... U drodh. U mbështet aty diku. Sepse e kapi një ndjenjë malli për qytetin e tij, që edhe pse qeverisej me ca ligje të shkuara, që edhe pse jetën e natës ende s'e kishte pranuar, iu duk i mirë, i mirë... E, megjithatë, ai ndjeu më shumë se kurrë se pikërisht për atë qytet do ta merrte malli, një mall që do ta sulmonte me dallgë, ja, si ky det, këto brigje, pranë këtij qyteti që çuditërisht, në çast u pendua për atë emër që i pat vënë.

## **MYFTIU I BERATIT**

**M**yftiu i Beratit ktheu kokën mënjanë, kur pa dy ushtarët e huaj të shurronin tek oborri i xhamisë pranë lumit. U ligështua keqas. Duke u mbështetur mbi shkopin e vet, me atë dorezë prej fildishi, mërmëriti : -Jo aty, o njerëz, jo! Xhamia është vend i mirë e nuk përgëret! Xhamia s'është për të ndryrat, por pastërtia është fytyra e saj.

Nisi të ecë, ashtu i gjatë e pak i kërrusur. Myftiu i Beratit i jepte lezet tërë rrugës e më gjërë, veçse përbrenda trembej, trembej se këto ditët e fundit po frynte vërtetë një erë e keqe. Sapo kishte marrë vesh se po atë mëngjes, tek mejhania e Tas Vozaxhiut, kur në të po bëhej gati të hynte, për një punë të vet, hoxha i Goricës, ushtrarët e huaj që u gjendën aty, me gjoja se po i bënин nderim efendiu, bënë ca gjeste e ca lëvizje që të vinte turp te mendoje e jo t'ia bëjë robi robit. Por Tasi ishte ashtu siç e njihnin të gjithë: kockë e fortë, dhe i matur, s'e lidhët feja me hoxhën, por rraca e lidhët amai! U vuri fshesën të huajve dhe i bëri nderet e duhura vëllait të vet. Mos vallë ka mbrritur ndonjë mesazh prej Vjene? -tha Myftiu i Beratit me vete

dhe, ndërkaj s'linte pa ua kthyer përshëndetjen qytetarëve të shumtë, që çapiteshin nëpër rrugicat e gurta, të ndriçuar qorrazi prej atyre fenerëve, që e jepnin dritën me pika. Pra, vërtetë të ketë ardhur ai mesazh përcarës? Mesazh grindjesh midis qytetarëve të tij?! Po mbartësit e tij nuk e kuptojnë ç'gjë të keqe mbajnë mbi vete dhe ç'mëkat të madh po bëjnë? A nuk e dinë të mjerët se Zoti i madh dhe i plotfuqishëm nga atje lart na sheh dhe na gjykon të tëra ç'ka bëjmë? Pse përpinqen të shkatërrojnë e të përcajnë këtë qytet, që vet i Madhi e ka ndërtuar e lartuar kaq bukur, sa s'i gjendet shoku as në Lindje e as në Perëndim?

Ky ishte halli i madh i myftiut që e ndoqi gjer në të errur dhe vetëm pasi hyri në shtëpinë e vet dhe pasi lexoi goxha surete prej librit të shenjtë të Kur'anit, tanë, tepër më i qetë tha :

-Po Vjena është nga lulet e botës, -ai kishte një adhurim të madh për qëtytet, krejt ndryshe nga ajo lakmia historike e Perandorisë Osmane, -pra, prej asaj luleje s'mund të shparndahet kjo erë e keqe!

Ky përfundim që melhem i zemrës së tij. E zuri një gjumë i lehtë me të venë kokën në jastëk. U ngrit kur do të falte namazin e sabahut. U la e u pastrua mirë e mirë si të ishte djalosh, sepse ky rit i bekuar pastërtinë e trupit e të shpirtit ka pasurinë më të madhe. Ra me gjunjë dhe me fytyrë e duar përdhe, zuri të këndojet lutjen. Nuk kaloi shumë dhe një e trokitur e sertë u dëgjua në portë. Ajo, ashtu siç erdhi papritur, po ashtu iku dhe ai vazhdoi i qetë, por përsëri shtangu. Shejtani e xhebraili bridhte nëpër konak dhe kërkonte të prishte këtë lutje të urtë. E ja, akoma më keq, një e qeshur shpërthyese aty pas tij. Myftiu i Beratit ktheu kokën prapa. Lutja u ndërpren. Ushtarët e huaj shtynin njeri-tjetrin aty tek dera. Ata e urdhëruan që ai të bëhej gati a të vinte pas tyre. Nuk kundërshtoi. Aty ishte i kot shpjegimi. Paska, ardhur, paska ardhur mesazhi, -tha, dhe ashtu i vënë në udhë, rrethuar prej ushtarëve të huaj, por një kokë më i gjatë se ta, ndiente një trishtim të parrëfyer dhe i erdhi keq për qytetin e tij, të mirë e të bukur, që ditën nën dritën e diellit, i ngjante një trëndafili të bardhë. Të paktën të këmbehej me ndonjë prej bashkëqytetarëve të tij, të përshëndetëj me dikë, që pastaj ta merrnin vesh të tjerët se ç'po i ndodhë këtij njeriut të Zotit në tokë, pasi vet atij një si humnerë sterrë i shfaqej përpara syve.

-Si të jetë shkruar, -tha, e vazhdoi në gjuhë të Kur'anit: -Kul-

lu nefqur-dha i katul ment baraz...”<sup>1)</sup>

Tashmë kish ngjitur të përpjjetën e kalasë dhe, aty tek hyrja, tek porta e madhe, dy fenerë ende pikonin mbi kalldrëm. Ushtarët e lanë myftiun mënjanë dhe vrapuan për tek oficeri, që po i priste. Diç i thanë atij dhe prej andej brodhi një e qeshur që të çante veshët. Pastaj oficeri, një bardhosh i tërë, dhe me ca flokë të butë e dredha dredha, si të një qëngji rudë, i bëri shenjë nyftiut dhe ai u afrua. Frymëmarrja po e mundonte pak, por ai e fshehu, madje edhe shkopin e hoqi nga toka, duke e varur dorezën e fildishit aty tek kyçi i dorës së djathtë.

Oficeri kërkoi përkthyesin e, ndërkohë, Myftiu që e kuptoi i tha ngadalë që, në se donte ai, oficeri i Perandorisë, puna e përkthyesit s'ishte e nevojshme.

-Pse ju e dini gjuhën tonë? - ia priti ai i çuditur e, në qejf tē tij, vazhdoi: -Nuk është as turqisht, as persisht.

Myftiu nuk foli. Ushtarët përsëri diç i thanë oficerit, madje dhe po i luteshin. Ai po ua kthente me të qeshur, por kur e pa se ata këmbëngulnin, iu drejtua myftiut:

-Kur ushtarët erdhën tek ti, çfarë po bëje?

-Lutjen e parë tē ditës, -u përgjegj myftiu, -po falja namazin e sabahut.

-Ata duan ta bësh përsëri, -tha oficeri.

Koka e bardhë e atij, tashmë myftiut i shëmbëlleu me një kokë dashi tē hedhur në garth.

-Ajo s'është cirk, -tha. -Dhe ka vaktin e vet kur bëhet!

-Mos thuaj përbajtjen, veçse bëj formën, -tha oficeri duke iu drejtuar ushtarëve, prej tē cilëve sapo mori aprovimin.

-As njérën, as tjetyrën, tē dyja bashkë i takojnë atij, vetëm atij, krijuesit tē madh, Zotit!

-E çfarë i thoshje ti, Zotit tënd? -tha me padurim bardhoshi.

-Zoti s'është vetëm i imi, ai është i tē gjithëve e për tē gjithë!

-Ne kemi tonin, -tha lehtas oficeri.

-Zoti është një dhe për tē gjithë, -këmbënguli myftiu. Oficeri sikur e shlodhi veten. U bëri shenjë ushtarëve që tē largoheshin dhe si më i tërhequr, iu kthye MYftiut:

-Për tjetër gjë tē kam thirrur!

-Urdhëro! -tha myftiu krejtësisht i shlodhut dhe tepër i freskët.

1) Çdo qënic e gjallë do ta shijojë vdekjen!

-Atje, thellë në burgun e Kalasë, janë tre burra të dorës suaj, vendalinj. Të tre janë kriminelë dhe më tepër. Ne si ushtarakë e kemi bërë punën tonë, u kemi bërë edhe gjyqin dhe, që të tre, do të pushkatohen afër drekës, pra, para Perandorit tonë, ne dimë dhe e kemi bërë detyrën, mjafton vetëm ekzekutimi tani, por veç ushtarak, të kësaj Perandorie hirëplotë, ne jemi edhe njerëz të thjeshtë, prandaj ashtu si para Perandorit, duam të jemi edhe para Perëndisë. Të thirrëm ty që të shkosh tek ata e të bësh atë që ta lejon petku yt, pra asgjë më shumë. KUjdes, s'duhet të flasësh aq tepër, siç bëre pak më përpara para ushtarëve të mi.

Myftiu i Beratit miratoi me kokë. Ç'ishin ata tre burra? Pas pak ai zuri të zgresë shkallët e gurta e të lagështa të burgut, duke u mbështetur fort mbi shkopin e vet. Në kthinën e parë u hap një derë hekuri që të ngjethte mishtë. Vetëm nga shkëlqimi i mekët i syve, u kuptua që aty ishte dikush. Myftiu i Beratit u qas edhe më. Para, ose fare pranë tij, qëndronte një burrë tek të 40-tat, i kthyer në kockë e lëkurë. Mal Diku, më quajnë, tha ai me një zë shpues e të fortë, si e vëtmja dëshmi, që ende mbahej i fortë. Myftiu i Beratit diç mërmëriti.

-Mos më mallko, efendi! - tha ai.

-Jo, or bir, jo, -ia ktheu tjetri, që kurrë s'do t'i shkonte ndër mend të nëmte kërkënd pa e ditur e pa e njojur.

-As krim s'kam bërë, as në ngasje të keqe s'kam rënë...

-Zoti atje lart gjykon të mirën e të keqen, prandaj fol... fol, qoftë e mira, qoftë e keqja nuk fshihen dot.

-Kullosja bagëtitë e mia në mal, -ia nisi Mal Diku. -Kurrujti s'i bëra dëm e zarar! Këta ranë në ato anë dhe i kallën tmerrin jo vetëm gjësë së gjallë, por edhe, edhe...

Ç'ta zgjas, efendi, më vunë thikën në fyt. Më urdhëruan të therja bagëtinë time, t'ua kripojsa, t'ua thaja e t'ua bija këtyre! Po pse, punë që bëhej ishte ajo? Atëhere vendosa ta shes, dhe e shita! E shita, efendi, e shita por ti duhet të më besosh se çdo ditë që bëja atë punë, më dukej se nxirrja në pazar jo bagëtinë por njerëzit e shtëpisë!... E, megjithatë, unë e bëra. I mblodha paratë, i futa në një qese dhe e vara atë në grykë të pushkës! Atëhere u dërgova haber dhe ata erdhën. Merrini, -u thashë, -merrini ja, në këtë qese i kini...

Veç të shihje si u çmendën nga gëzimi, se ti e di zoti im, njeriu për të qënë njeri prej të vërteti a gjë tjetër, vëre para parasë që t'ia vesh emrin siç duhet! Pra, të parit që u sul drejt meje, ia shkreha pushkën dhe e palosa për tokë. Tani ç'të të them, Myftiu i Beratit, një amanet kam: atë pushkë, të vetmen pasuri, dua që të ma

trashëgojë im bir. Ndersa ti, bëj tënden, efendi, dhe mos u ligështo se të keqen që më ka zënë, dyfish ma bën më të rëndë!

Myftiut të Beratit i rrrohdhën lotët. Zemra ia donte të fliste, të fliste gjatë me atë njeri aq të mirë, por ushtari që e shoqëronte i kujtoi porosinë që pat dhënë oficeri, atje lart, e prapëseprapë Myftiu i Beratit tha veç një fjalë:

-Njeriu i mirë vdes, por nuk shuhet!

Ushtari e tërhoqi dhe më pas hungërima e derës së hekurt çau errësirën e asaj gryke të nëmür. Këtu është nëntoka, është Xhehnemi e Mal Diku s'ka vend këtu! Pas nëntë shkallëve më poshtë, u hap një derë tjeter, po aq e rëndë, po aq gërryese sa ajo tjera.

Aty brenda ishte mbyllur Haxhi Filipi, shpatarak, pronat e tij zinin fill aty rrëzë Tomorrit e gardhonin rrëzë Polisit, por namin ama s'kishte kut që ia maste. Ai, me të parë Myftiun, bëri kryqin e fësë së vet, përshtëndeti me dorë në zemër dhe tha:

-Të njoh, të njoh mirë, Myftiu i Beratit!

-Edhe unë ta kam dëgjuar zërin, Haxhi Filipi. Vallë ç'të keqe mund të kesh bërë ti? C'është kjo hata? C'do ti këtu në Xhehnem? Ti Haxhi Filipi je besimtar me qok. Ti nuk e ngatërron Zotin me xhyben e hoxhës, dhe as me rrason e priftit. Unë them se padrejtësia këtu, me ty, do ta ketë hapin litar. Pa më fol!

-Të falenderoj për besimin, -ia ktheu tjetri. -Më dëgjo e gjyko vetë. Këta ia kishin vënë syrin Shpatit efendi, me sa duket, se drejt me folë, këta nemcellinj, edhe të mençëm nuk janë pak, pra me sa duket, paskeshin mësuar nga historia se Shpati me shpat e hekur zor se e pushtonin dot. Atëhere, a e di ç'na kurdisën? Na dërguan një kalë me shalë, me takëme që, për atë Zot, zor se edhe Perandori i tyre t'i ketë. U mblohdhën gjithë burrat; jo më takon mua, thoshte njeri, jo mua, ja priste tjetri. Shkoi puna deri tek kamat dhe koburet. E mora vesh këtë hata dhe ia dhashë vraptit. Daleni, mor, daleni, ç'bëni? Po pse uleshin gjakrat? Atëhere më shkrepi një mendje: ta kthejmë kalin. -u thashë, t'ua kthejmë sa më parë atyre që na e prunë! Zoti me ne, efendi, më dëgjuan. Shpëtuam sherrin e shpëtuam Shpatin. Nuk arriten të na ndanin, nuk bënë dot veçim, se ti e di fort mirë, një veçohet nga kopeja e pastaj zenë e shkojnë dhe të tjerat. Dhe, ashtu, kohë pas kohe pritet një e nga një të gjitha...

-E tani, ç'të të them? Ti mirë bëre që erdhe e që më dëgjove, një fjalë e kam dhe ua thuaj atyre të Shpatit. Le të shikojnë gomerët e tyre e të mos lakmojnë kuajt e botës.

Myftiu i Beratit tundi kryet gjithë pikëllim.

54956

C'mund tē bënte fjala midis tyre! Mbështeti ballin me ballin e Haxhi Filipit e tha:

-Ty tē ka ndriçuar e tē ndriçon vet Krijuesi ynë.

Ushtari shoqëruesh u kollit thatë dhe i bëri shenjë Myftiut, që tē merrte shkopin e mbështetur aty prapë. Myftiu e mori e për një farë kohe s'ia hoqi sytë Haxhi Filipit, që po i shëmbëllente atë çast me një figurë tē papërcaktuar nga forma, por dritëleshuese.

Në katin përdhesë, aty ku lagështia ishte gjol, dhe tē ftohëtit tē pickonte si gjilpëra, Myftiu i Beratit takoi Beg Përdiellin, ish oficer në Perandorinë Osmane, por që e pati braktisur nga që u bashkua me Ismail Qemalin dhe ndenji me tē deri sa ai drejtoi vendin. Ai s'pranoi tē fliste, madje sikur as me sy nuk pati qejf ta shihet Myftiun e Beratit, por kjo për myftiun qe e rëndë, tamam si një gur, si një shpellë hedhur së larti mbi supe. Mos vallë ky ishte vërtetë mëkatar? S'dihet ç'ngasje ia kish dreqosur shpirtin, por prapëseprapë ç'humbje do tē kishte prej fjalës, përkundrazi lehtësimi ishte më i mundshëm.

-Po ti fol, fol, or bir! Njeriu prandaj është krijesa më e mënçur e kësaj bote se di t'i shërbejë vetvetes e njeri-tjetrit.

Beg Përdielli u kthyte si i penduar dhe e nderoi myftiun me dorë në zemër.

-Kulu-mafus-dha-i katul; ment baraz - tha Myftiu i Beratit, i bindur se ish oficeri i perandorisë Osmane, e njihet mirë Kurianin dhe s'u gabua. Beg Përdielli vuri lehtë buzën në gaz.

-Nuk i druhem vdekjes, -tha, -mjafton që këtu- ai vuri dorën tek zemra, -nuk më rëndon asnje e keqe.

-Hair!, -tha gjithë gjëzim myftiu.

-E po, veç një merak kam...-kërkoi njëcopë letër dhe ngadalë e i menduar shkroi: "Ej, nënë e dashur! Si e kërkova e gjeta. Kështu 'ë gjen kur kërkon tē bëhesh i parë aty ku, as tē dëgjojnë, as tē kuptojnë!" la zgjati letrën Myftiut, i cili shpejtë e leksi dhe së fundi ngriti supet dhe vështroi i habitur.

-Nëna, -tha Beg Përdielli, - jam i bindur që ç'kam shkruar aty do tē ma kuptoj lehtas. Por, që edhe ty, o njeri i nderuar, që tē mos brejë dyshimi, po t'i them ca fjalë: Kur ra Qeveria e Plakut tē Vlorës, ramë edhe ne që e mbështetëm. Andej nga Veriu se ç pordhonte Esat Pasha, nga Jugu nuk ishte katraura më e paktë. C'të bëja? U ktheva në fshat. Sa mu gjëzua ajo qyqe nënë! Mendoi, e shkreta, se ja, më në fund, mbasi kisha bredhur tërë Azinë e Ballkanin do t'i gjendesha pranë kur ajo, e mira e botës, do t'i vinte

krahët dheut. Nëna të do, të do që kur të nxjerr në dritë, por aq fort të do ajo edhe kur bëhet gati ta ndrrojë, ta lerë këtë dritë për në atë tjetrën, të përtrejmen. Zura të leroj me parmandë. Zura të kullo bagëtinë. Nuk ishin zanatet e mia këto, o njeriu i Perëndisë, jo! Po, bë, c'të bëja? Ajo që më jepte forcë, ishte vetëm kënaqësia që i falja asaj të gjore. Veç nuk zgjati shumë, e unë i marri, unë i çmenduri e braktisa atë. E braktisa atëhere kur hyri nemcja, ky i sotmi, e që lëshoi atë thirrjen e mallëkuar se cilido që na paskesh qenë oficer në ushtrinë turke, mund të shërbejë edhe në ushtrinë tonë. Patjetër duke na ruajtur titujt dhe gradat. Ika, - i thashë nënës. Ik - më tha ajo, veçse një psherëtimë e saj ende më fërférin në vesh. U paraqita në ushtrinë e nemces e këta m'i dhanë me tituj e me grada. Më dhanë edhe një kompani të tërë për ta komanduar. Ç'të të them, efendi, e pata më qejf, apo ishte halli që më pillte qejfin! Nuk e di. Po ajo kompani ishte një përzjerje e llahtarshme, një çorbë e vërtetë: kishte aty ushtarë kroatë, gjermanë, sllavë, boshnjakë deri italianë nga ata të Veriut. Unë jepja komandën "majtas!", ata ia këputnin djathas! Unë komandoja "djathas", ata përsëri të kundërtën: majtas! Zot, o Zot, më keq s'kishte! Unë para, ata prapa: unë -prapa, ata para! Betejë pas beteje erdhën e u rralluan sikur të ishin lakra... Ja, prakuptimi i atyre fjälëve në atë dy gisht letër...

Ra një qetësi e thellë, aq sa mund të dëgjoje pikën e ujit që zbriste prej mureve të plakur. Po Beg Përdielli foli:

-Dhe ajo psherëtima ende më fëshférin në vesh.

Dhe Myftiu i Beratit ngriti kokën lehtë-lehtë e duke e parë në sy Beg Përdiellin mërmëriti:

-Lavdi të qoftë, o njeri i bukur!

Ushtari shoqëruar i vuri drynin e madh portës. Myftiu i Beratit mori përpjetë shkallët. I lodhur dhe i drobitur, ai dukej se vinte nga fundi i botës dhe, nës e ende kishte fuqi të përballonë atë thikë të përpjetë, ishte vetëm e vetëm shpresa e besimi se dielli i madhërishëm shumë shpejtë do të shfaqej mbi të. Kur doli sipër në Kala, kur ajri i freskët i përfshiu trup e shpirt, atij iu bë sikur Tomorri, mali i shenjtë përkarshi, po vinte drejt tij plot madhështi. Atëhere, befasisht, Myftiu i Beratit, ra në gjunjë, uli kokën dhe duart. Nuk ishte vakt namazi, por as mëkat nuk ishte. Ai veprim u bë me urdhër e, patjetër që urdhërin e dha vetë i madhi Zot, përndryshe si mund të lëvizte Tomorri i shenjtë?

Ai u lut për ata të tre, ata të tre futur atje thellë në atë vrimë të zezë, ku as dielli, as ajri, as gjë nga tërë kjo mirësi e kësaj bote

nuk arrinte. A s'janë pjesa jonë edhe ata? C'gjynah, ç'mëkat kishin bërë? Mbaji dorën mëkatarit, Zot i madh, se sa par ata ta tre, të tutë janë, bij më të devotshëm as kjo jetë, as ajo tjetra zor se gjen!

Me këtë lutje në gojë e në zemër Myftiu i Beratit u gjend përballë oficerit bardhosh e sakaq zuri e ia tregoi ato ç'ka i thanë ata, të mbyllur atje në atë vrimë të djallit e të dreqit, siç e quajti burgun pa fije ngurimi.

-E, megjithatë, unë të porosita, apo jo? Të porosita që të mos flisje shumë! - tha oficeri.

-S'munda, -tha Myftiu i Beratit. -Kisha urdhër nga Ai, -dhe ngriti sytë përpjetë.

-Nga Zoti yt, - qesëndisi oficeri.

-Nga Zoti ynë, -këmbënguli Myftiu i Beratit.

-Unë të thashë: ne kemi tonin...

-Mos u ngut, -ndërhyri Myftiu që trokiti lehtë me shkop, - mos u ngut! Zoti një është sepse edhe në Një jemi! Të gjithë jemi prej një babe e prej një nëne e në se jemi ndarë në fise, në popuj, jemi ndarë pér të lehtësuar më shumë njojhen e njëri-tjetrit, e jo pér t'u larguar e përçarë! Të gjithë njerëzit janë vëllezër, pér rrjedhojë një Zot të vetëm kanë.

-E atëhere?

-Eja të shpëtojmë mëkatarin, e nëse Ai na dëgjon, vëlla e kemi, nuk e nëmin. Ata të tre ...

-Atyre të treve, -e ndërpren bardhodhi, -u është bërë gjyqi,jeta e tyre me minuta është...

-Ta zemë se është ashtu. Ata, prapëseprapë, trëndafila janë në këtë jetë, trëndafila do të jenë edhe në tjetrën, veç halli është gjetkë.

-Ku? -pyeti oficeri.

-Tek mëkatari dhe nuk bën mëkat kur gabon padashur, por mëkaton kur gjërat i bën me dashje, me vendimin e zemrës suaj. Ju jeni i ri, zoti oficer, e përsa kërkoni të mbani një, një mallëkim të tillë?

-Ç'hyj unë këtu, -tha disi i trembuir oficeri. -Ata i ka dënuar gjyqi dhe gjyqi është ndërtuar sipas urdhërit të Perandorit tonë.

-Perandori s'është Zot, ai është njeri, si ti e si unë...

Oficeri u ngrit në këmbë, tepër i frikësuar.

Iu afrua dritäres, si pér të kontrolluar në se e dëgjonte kush.

-Ju mund ta ulni zërin! -tha së fundi.

-Kur thashë "si ti, e si unë" nuk jua hoqa gradat, -tha Myftiu

i Beratit.

-Perandori është vet i dërguari i Zotit.

-Nuk e kam lexuar këtë, or djalë, jo, as në Bibël, as në Kur'an. As perandorët, as mbretërit, as sulltanët s'janë të tillë.

-Po ç'janë? - pyeti ai edhe më i tronditur.

-Njerëz prej mishi e gjaku edhe duke qenë të tillë gabojnë. Por ama vjen ajo dita e bekuar, dita e gjykimit të madh. Aty ku peshohet vepra e sejcilit. Në këtë gjyq, për ata të tre te bukurit atje poshtë, ju kini pjesën tuaj.

-Ju vetë thatë, efendi, se ata e kanë të sigurtë Parajsën...

-Por ju, ju... -myftiu tundi shkopin në të djathtë të oficerit. ju s'kini të drejtë t'u hiqni gjëzimet e kësaj jete mbi tokë!

Oficeri bardhosh bulëzoio prej djersës në ballë. Herëpashere shihte orën e varur në jelek.

-Diçka kam mësuar nga historia juaj, kam vënë re se ju, klerikët e këtij vendi, myslimanë a të krishterë, u ka pëlqyer roli i bariut për popullin tuaj...

-Ka qenë vullneti i ...

-Po vullneti mund të jetë edhe i keq.

-S'ka vullnet të keq, ka ngasje të keqe. E ngasjen e lind djalli, shejtani, por edhe njeriu i lig e këtë të keqe ta ngjit ty që mund të jesh krejt i pafajshëm, por me faj më të madh bëhesh papritur. Po a shkulet kollaj mëkatit? E, pra, shkule, shkule, ja aty, aty nën xhaketë e ke!

-Jo, jo! -bëri oficeri.

-Unë e shoh, biri im, e shoh me këta sy, se po me këta sy e pashë dhe atje tek ata të tre të mbylluyrit në pus, që s'kishin askurrfarë të lige. Ndërsa aty, aty ja, e dhe formën e shoh. Nuk mban dot xhaketa shpërthimin e mëkatit...

E në të vërtetë oficeri bardhosh krejt pavetëdije shtrëngonte kopsat kot më kot. Flokët rudë i kishin marrë përpjetë e dridhej si në ethe...

-Hidhe mëkatit! Shporre! Mos e kthe veten edhe shpirtin në lëndë djegëse, ku, as në ferr e xhehnem nuk do të gjesh vend.

Oficeri mbertheu duart në kokë. Thirri me forcë ordinancën e vet, por nuk u mjaftua, doli edhe vet jashtë, duke parë gjithnjë sahatin që tani e mbante në dorë. E aty tek dera, thirri, thirri jo vetëm ordinancën por edhe togën e pushkatarëve: - Prisni, prisni!...

Por ishte tepër vonë. Një breshëri armësh tundi kalanë. Myftiu i Beratit e flaku shkopin e doli me të shpejtë jashtë. Aty kërkoi të

peshonte diku, gati u rrëzua por u mbajt. I dha forcë vetes duke ia ngulur sytë malit të Tomorrit a pikërisht aty, në majën e tij, mbuluar prej borës së përjetëshme, iu shfaqën tre pëllumbat të bardhë..

## **KAPËRCIMI I YLBERIT**

**A**ty duhej të ndryshohej çdo gjë, në mundësi që nga ajo tavëll e hedhur mbi tavolinë, si një bretkocë e ngordhur dhe deri tek ato perdet e trasha, që me anë të një suste, venë djallëzisht në cep të dritares, të kthehej dita në natë kur të duash. Por duhej ndrruar padyshim, dhe me të parën ai qëndrim nervangritës i tavolines kryesore. Ajo vendosja e saj në formë T të ngjallte alergji, madje më tepër. Në zyrat e pushtetit të mëparshëm, ajo tavolinë në formë T ishte, si ta thuash, fytyrë e përbashkët, e pra ndryshimet kishin filluar dhe duhej të kryheshin sa më shpejtë vertikalisht dhe horizontalisht. Kjo ide tashmë kishte prekur tërë frysëmarrësit e këtij vendi, të kuptohemi ata të botës njerëzore. Kështu që s'kishte asnjë arësy që të ngurohej para një zyre, aq më tepër që aty diku pat drejtuar Dan Kela, një burrë afro të pesëdhjetave, por me një forcë prej kau. Thuhej e ç'nuk thuhej për të në atë qytet, por ajo fjala që kishte përhapur ish sekretarja e tij, se Dan Kela të mbathurat i mbante me zinxhir, kishte ngjitur si në dyll. Të mbathurat me zinxhir! Naivët kërkonin arsyet e këtij veprimi, të paditurit ngrinin supet, ndërsa ata që ishin të thekur nëksi punësh, e sidomos ata që

e njihnin drejtpërdrejt ish sekretaren bukuroshe të Dan Kelës, e kishin quajtur vërtetë një gjetje origjinale.

Dhe ja, tani në atë zyrë do të shërbente Xhek Peni, përfaqësuesi i pushtetit të ri, një ndër majat kryesore të piramidës së qytetit. Ai do të donte ta transformonte krejtësisht atë ambjent, jo vetëm nga që ishte pushtuar prej asaj idesë madhështore të ndryshimeve, por edhe sepse kujtime personale e lidhni pér keq me të. Dikurt, jo vetëm një herë dhe jo vetëm ai, e kishte ndjerë shtypjen dhe përcudnimin e asaj zyre. Madje shumë kush trembej prej saj dhe largohej si djalli nga temjani. Në djall vafsh, Dan Kela, ti dhe pushteti yt, ti dhe të mbathurat e tua me zinxhir... Këtu Xhek Peni gati pështyu, por sakaq ndrroi mendje dhe me të shpejtë ia nisi punës. E filloj me perdet e trasha, i hoqi ato pa pikë ngurimi dhe kur syri i kapi atë sustën venë djallëzisht tek qoshja, sustë që pat shërbyer pér hapjen e mbylljen e saj, mendoi se mos vallë ishte ndonjë manovër e poshtër e atyre të SHIK-ut, pasi ende në atë organ punonin ca nga ata "ustallarët" e vjetër, por elektricisti i institucionit që u ndodh aty, fare rastësisht, duke e ngacmuar paksa me kaçavidën e vet. e ktheu atë në diçka të papërdorëshme. Tavllen e duhanit e hoqi fare. Ai, mbi dhjetë vjet, s'kishte vënë cigare në gojë. Pastroi tërë raftet e vëna në mur, mbushur me turli farë librash, shumicën e të cilave ia kishte qejfi t'i griste fare a t'i digje, por druajtja se ato mund të ishin në ndonjë inventar, ia frigoi dorën dhe mendjen. Ja ku i erdhi radha dhe asaj T -së së mallëkuar! Tashmë kënaqësia e ndryshimeve ia përshkoi shtatin si një fërfellizmë, a thua nëpër trup e nëpër gjak i fërgëllonte një qenie e imët, e gjallë dhe e bënte që ai nëpër hapësirën e asaj zyre të shihte mirazhe, që më parë as pat rastin t'i përfytyronte. Kjo formë, kjo T e mallëkuar, kjo monedhë e fytyrës së përbashkët e tërë zyrtarëve të pushtetit të dikurshëm, duhej të hidhej në erë! Pushteti i ri kishte pér zemër tavolinën e rrumbullaktë, madje kjo shprehje pér të ishte bërë e domosdoshme si uji dhe ajri. Shtypi, tërë masmedia, por dhe njerëzit që kërkonin të dallohen në kohës, si evropianë e më tutje, këtë shprehje ua hidhnin grave të tyre tek gatuinan, po dhe fëmijëve kur kryenin detyrat e shtëpisë. Padyshim që dhe Xhek Peni s'bënte përjashtim nga ky rregull. E krijoi tavolinën e rrumbullaktë dhe do thënë se e krijoi vërtetë bukur, gjë që e shtyu të vepronë dhe në shkatërrimin e atij aneksi që dikur shërbente pér të pritur popullin. Jo, tani e tutje, populli le të vinte aty, të ulej rreth asaj tavoline të rruymbullakët dhe të thoshte ç'të donte e të kërkonte ç'i nevojitej! Xhek Peni do të ishte aty midis tyre, i bërë njësh me ta.

i padallueshëm pér ta. Në se do tē kishte diçka që do ta dallonte, le tē ishte përgjegjësia, përkushtimi dhe jo... atij i erdhi ndër mend ajo fjala e përhapur pér Dan Kelën, tē mbathurat me zhinxhir dhe pa ngurim shau nëpër dhëmbë.

Që tē nesërmen njerëzit filluan tē dyndeshin në zyrën e tij. Policin e largoi nga dera e hyrjes kryesore. Nuk vuri as orar pritjeje, as njeri tek dera e vet. Dhe ja, ashtu pa fije paragjykim, hallexhijntë uleshin aty rrëth tavolinës së rrumbullakët, si rrëth një sofre tē madhe. Xhek Penit i bëhej qejfi dhe kujtonte plot mall fëmijërinë e tij tē hershme, atëhere kur në Teqenë e madhe, në ditën e hashures, njerëzit uleshin pranë teptive tē mëdha, duke pasur me vete vetëm lugën në brez. Dhe ja tani, ata vinin këtu qetësisht e pastaj zinin e parashtronin kërkесат, i qanin hallet shtruar. Ai i dëgjonte me vëmendje e patjetër plot adhurim pér guximin e tyre, pér lirshmërinë që i kishte pushtuar tē gjithë. Hallet ishin tē shumta. Xhek Peni ishtë dhe vet tepër i vuajtur, kështu që hallet e atij tjetrit e bënin tē squllej disi, deri sa i mbusheshin sytë me lot. Ai vërtetë i kishte mbushur tē 60 vjetët, por me ngulm kishte thirrur vitet e rinisë pér t'i shërbyer kësaj kohe tē madhe që çuditërisht e kishte nxjerrë në krye tē saj. Duhet shërbyer njeriuut dhe jo më sipas atyre pallavrave tē ideologjisë që i kishte shtypur pér vite me radhë, por sipas parimit madhësahtor tē humanizmit e aq më tepër kur bëhej fjalë pér bashkëqytetarët, shumicën e tē cilëve, ai e quante bashkvajtës.

E, pra. njeriu eshtë mrekjullia vetë, por c'po bëj unë pér tē? Kjo sikur e motorrizonte téré qënien e tij dhe tetë deri dhjetë orë pritje sikur s'peshopnte asgjë. Njerëzit s'e patën vështirë tē kuptionin, apo tē ndjenin këtë natyrë kaq tē mrekullueshme tē tij, dhe jo rrallë disa nga ata, jo halli i shtynte tē vinin në takim me tē, se sa kureshtja. Xhek Peni u jepte këshilla, urdhëra dhe copa letra, shkëputur prej një bllok xhepi me kapak blu, që mbanin firmën dhe vulën e institucionit që drejtonte. Ata iknin, por shumë prej tyre kthehen përsëri, madje më tē trishtuar, më pesimistë. Xhek Peni tronditej vërtetë dhe rrinte e u bënte moral duke u thënë se, si trishtimi, si pesimizmi s'kishin tënbenin aspak me kohën e re që po jetonin... dhe me sistemin e ri. Këtu atë e kapte një ngazëllim gati poetik dhe e përshkruante tē sotmen e tē ardhmen, a thua ata që e dëgjonin s'jetonin mbi këtë tokë e nën këtë qiell. Po c'të bënin, veçse nën çarçafin e frymëzimit tē atij sikur përgjumeshin, sikur ëndërronin, pa kur ai mbaronte, dëgjoej një zë disi i mbytur:

-Unë një gjë tē vogël kam.

-Çfarë? -pyeste Xhek Peni.

-S'kam punë, s'kam...

-Ta kam dhënë letrën... e pra, do të zgjidhet. Atëherë po në atë formë, dikush tjetër thoshte:

-Edhe halli im i vogël është, shtëpi zoti ...

Xhek Peni i ndërpriste duke i kujtar edhe atij letrën dhe tepër i emocionuar, tërhiqej për në zyrë.

Tani, i zhystur në kolltukun e vet, ndërtonte patetikën e së ardhmes. Po njerëzit s'po e kuptojnë!... Veç duhet durim, durim... unë prandaj jam këtu t'u hap sytë, t'u ndriçoj mendjen. Pra durim ... por këtë zotim s'e mbajti gjatë. Ditë më pas e lajmëruan se punëtorët e atyre dy fabriukave tek plepat kishin shpallur grevë. Atij i shkuar mornica nëpër trup. Grevë!... Ju bë sikur tërë ai ambient që e kishte ndryshuar me aq merak, shije dhe mundim, po kthehej në formën e dikurshme. Ja tavolina e rrumbullaktë po lëvizte në pjesë-pjesë.

-Mos, mos! - thirri me forcë aq sa sekretari i tij tepër i frikësuar, u dha tek dera.

-Ç'kërkojnë punëtorët?

-Sapo mbrritën, ja aty në shesh janë, -u përgjegje sekretari, -kanë një petition që do një orë të lexohet.

-Të lajmërohet polici. Kërkend të mos lejojë të vijë lart!

-Ju e kini hequr prej kohësh policin, -foli si me zë gruaje sekretari.

-Të rikthehet, bile i përforuar!

Tjetri doli jashtë. Xhek Peni u ul me tërsëllimë dhe pavetëdije hapi sirtarin aty pranë dhe në çast, prej një korenti ajri, fluturuan nga aty dhjetë, njëzetë... njëqind copa lettrash ta kthyera. Ato përplaseshin në tavan, mbi mur e pastaj binin si pupla zogjsh të vrarë mbi tavolinë. Ai vuri duart në kokë. Jo, tha jo, s'është fajti i tyre! Fajin e kanë ata, ata që janë jashtë. Dhe me një lehtësi të çuditëshme, ky njeri, vet i përvuajturi si rrallë kush, tha pikërisht një gjë të tillë, të përafërt me atë që ishte thënë para tij nga qindra, ose mijra të tjerë: Njeriu është i keq!

Sikur u qetësua dhe tërë admirim e ledhatim bashkë. vështronë ndryshimet që i kishte bërë jo vetëm me shije, por dhe me mendim të caktuar, ambientit të tij. Ndërkohë u hap dera dhe u duk një fytyrë e rreshkur, e plakur para kohe. E njihte fort mirë Xhek Peni atë, po, po e njihte. Mund ta kishte të katërtën a të pestën herë që ai vinte aty, kërkonte punë për të mbesën e vetë. begare të lashtë.

"Shih ç'monstër është, shih" - tha nën zë e pastaj me tèrë forcë bërtiti:

-Dil jashtë! Jashtë!

I sapoardhuri shtangu. U përpoq të linte atë copë letër që patjetër do ta kishte marrë po aty, por nuk mundi, u largua sikur t'i ruhej plumbit. Xhek Peni e ndoqi nga pas. Dridhej si ta kishte kapur sëmundja e tokës. Bëri të dilte matanë derës, por nuk mundi e, i dërmuar, tek kupa e gjurit, zuri të thërrasë:

-Antipërparimtar! Antieuropian! Anti... seç tha dhe ca fjalë të tjera nëpër dhëmbë, duke u përplasur mbi karriken e vet.

-Anti... Anti! - zunë t'i buçisnin në veshë këto fjalë. Hodhi sytë rrrotull, sikur të përgjohej prej ndokujt. Ja, po këtu, po këtu, por pranë asaj tavolinës së dikurshme në formë T-je i kishin thënë dhe atij vetë:

-Anti... Antipopullor... Antikinez!...

-Djalli ta marrë! -tha. Ndjeu nevojën e një cigareje, edhe pse kishte dhjetë vjet që e pat lënë. Befas tavolina e rrumbullakët sikur iu stërzgjat, duke shkuare drejt formës së T-së. U ngrit në këmbë. Sepse iu shfaq Dan Kela aty... të mbathurat e tij...

-Shyqyr, shyqyr, o Zot! -tha. -Shyqyr që nuk jam nja njëzetë vjet më i ri!

## **VRASJE BUZE DETIT**

**D**o të vras. Met Bali, do të vras...

Ai shpejtoi, po kërcënimi e ndoqi nga pas, madje e ndoqi edhe kur ai shpejtoi poshtë kodrës, edhe kur hyri në pyll. Ai e dinte fort mirë se ai që po e kërcënonte, kushëriri i tij Dash Leka, ishte nga ata burra që s'e bëjnë fjalën dysh. A s'ua mbajti fjalën fshatarëve të Bregasit, kur ata i thanë se një farë e keqe, hajdut dhe kriminel, u vinte në fyt thikën e koburen fëmijve të tyre, u rëmbente lopët dhe i degdiste matanë kufirit për në Greqi. Ata i kishin kërkuar disa herë ndihmë qeverisë, por qerrja e saj s'po vihej në lëvizje. Dash Leka një ditë të bukur i qëroi hesapet me vjedhësin kriminel dhe tërë krahina mori frymë lirisht.

A s'ia mbajti fjalën atij policit të Komunës, një kokorosh i vërtetë, që e mbante varur koburen edhe kur ishte me brek banje aty buzë liqenit! Atë ditë pazari, kur ai, polici, pasi kishte rrëkëllyer një 5-6 shishe birre kishte sharë Dash Leka, e kishte fyter dhe, më e keqja, i kishte kërkuar t'i binte në gjunjë. Dash Leka i hapi rrugë. Të pirit dhe budallait hapi rrugë. Veç ama këtë ia kishte thënë: Këto që

m'i the sot dhe që më kërkove sot, m'i thuaj dhe m'i kërko nesër, pérndryshe... Të nesërmen ai i doli ballëpérballë policit: bëj atë që bëre dje, i tha. Tjetri shpejtoi dorën pér tek koburja, por s'pati kohë: Dash Leka e goditi tri herë dhe e pérplasi pér tokë.

Kohët e fundit ai ishte bërë dhe më i rreptë, e dëlhe më i sertë. Në vjeshtën e shkuar i ndodhi një fatkeqësi që tash se fundi po e fuste të gjallë në dhe. Kishte dërguar të shoqen, së bashku me të dy djemtë e vet, i madhi 10 vjeç, tek gjyshi. Koha që ai duhej të shkonte pér t'i marrë po kalonte dhe atëhere e shoqja, e mërzitur, merr të dy djemtë dhe niset, por edhe pa kaluar pyllin e madh, një rrufe e zjarrtë i goditi të tre nën një pishë të goditur disa herë nga qielli. Ngeli perfundimisht fill i vetëm, mallëkonte qiellin dhe tokën, por më tepër vveteten. Në se ai do të kishte shkuar t'i merrte në kohën e caktuar, do ta kishte shtëpinë plot dhe jo si tani gërdallë, të shqyer ku vershëllente tërë ditën era. Dhe sikur të mos i mjaftonte ky mal hidhërimesh që i kishte rënë mbi vete, vajti hapi sherr edhe me kushërin e tij Met Balin, që sapo e kërcënoi se do ta vriste. Shkak u bë vendimi i Metit pér të ndarë të shoqen, Shegën. Ai kishte 10 vjet martesë me të, por ajo kishte qëlluar barktharë, s'po i falte që s'po i falte një fëmijë. Kulmi i neverisë pér të arriti atë mbasdite, kur ai e pa Shegën së bashku me një të mbesën e saj, nja 16-17 vjeçë, që t'i prisje kokën. Të dyja lakuriq dhe lakuriq të hedhura mbi krevatin e madh, ku Shega e puthte dhe e lëpinte, sa Met Bali dhjetë vjet në shtrat me të, s'e kishte shijuar atë ëmbëlsi. Njerëzit e Shegës e futën në thes Dash Lekën, i thanë se ç'ka kish dëgjuar rrëth Shegës, ishin pallavra, se shkaku i vërtetë i ndarjes së Met Balit me vajzën e tyre, na paskësh qenë dashuria e tët kushërirri me atë jevgën e ardhur nga Bosnja. Bëhej fjalë pér Zarën, që së bashku me fisin e saj, ishte shkulur prej Bosnje, kishin jetuar disa vjet në rrithinat e Shkupit e ja tani ishin ngulur në këto anë. Dhe ç'vajzë ishte Zara! Nje perlë e vërtetë. Me një fytyrë të zeshkët, të ëmbël, me dhembë të bardhë, të shndritshëm si zajet e lumi, me sy të zes e me ata qerpikë të mëdhenj, që çelur të dukej sikur shihje tërë botën e, të mbyllur, sikur tërë bota të kishte thënë natën e mirë. Ajo e kalonte ditën duke kënduar dhe gjindja aty pérreth s'ngopej së dëgjuari. Të vjetrit i puthnin dorën, të rinjtë i betoheshin se pér të e shkonin veten në thikë kur të donte ajo. Ajo s'përtonte. Kurrë nuk u kursye. Dhe ata njerëz të lodhur dhe ta drobitur ngajeta dëgjonin Zarën e shpërthenin në lotë. Aty e pa ajo pér herë të parë Met Balin që ai s'ishte i rracës së saj, dukej nga koka tek këmbët, e megjithatë edhe ai lotonte.

veçse edhe loti i tij ishte ndryshe, krejt ndryshe. Në të siç dukej një dritëz që të falte dashuri, guxim, jetë. Ja, këtë pikërisht atë dritëz, s'kishte parë ajo tek asnjë nga meshkujt e fisisit të saj, prandaj ajo, atë natë me hënë, atje tek mullari i barit, iu dha me tërë shpirt. Met Bali e ndjeu veten tamam mashkull përsëmbari. Përkëdheljet e saj i ktheu në forcë, të puthurat e saj i kthente me zjarr. Mbas kësaj ai fluturonte e shkonte e dëgjonte për orë të tëra Zarën. U përpooq t'i mësonte asaj ca kangë të krahinës së tij. Ajo melodinë e kapte lehtë, por fjalët jo. Kur e pa se atij i vinte keq nga kjo, i tha se në këngë s'ka aq rëndësi fjala se sa melodia. Se ka muzikë të plotë që s'ka fjalë fare. Nuk e di në se e ke dëgjuar ti Valsin e Danubit, aty s'ka asnjë fjalë por ai është aq i afërt, si për mua që jam lindur e rritur pranë tij, si për ty që je më larg, madje edhe për shumë më të largët se ti. Dikur kur kam qenë gjimnaziste, në Sarajevë, u bë një festival rinie dhe ata që morën çimin e parë në kërcimin e Valsit të Danubit, ishin një çift nga Kenia. Nuk e di a më kupton? Për të s'kishte rëndësi kjo histori, për të kishte rëndësi zëri i saj, për të kishin rëndësi buzët e saj, pak të përthyera, pa të kuq, te ftonin t'i puthje tërë ditën. Megjithatë ai mundi t'i mësojë të plotë asaj këngën e Dudisë, që jetonte atje në pyll, me fëmijët e saj të vegjël dhe që padashje i helmoi me kërpudha, por që nënëzeza kurrë s'e pranoi vdekjen e tyre. Hapi fjalë se fëmijët i ishin kthyer në engjëj e kishin fluturuar në qiell. Nëna e marrë brodhi fushë dhe male, deri sa më në fund vdiq në një azil në kryeqytet. Atë natë që Zara e këndoi për herë të parë për njerëzit e fisisit të saj atë këngë, u bë batërdia. Dikush shkulte flokët e dikush cirrej. Hëlmi i këngës ra dhe pllakosi zemrat e helmuara. I vetmi që i shpëtoi tronditjes dhe së keqes, ishte Met Bali. Ai lëvizi prej vendit të tij, shkoi dhe, pasi e ngriti hopa Zarën, e puthi fort-fort dhe me këtë veprim bëri dy punë: e para, njerëzit rikthyen qetësinë dhe, e dyta, u përshëndet nga të gjithë, dashuria që u shpall para tyre.

-Ti atë evgjittë nuk ke për ta marrë, ti nuk e ndyn dot gjakun tonë.

-Shiko hallet e tua, Dash Leka, se nuk i ke të pakta.

-Unë do të vras, do të vras...

Ai doli matanë pyllit, por kërcënimi sikur t'i ishte qepur aty në rrëzë të veshit. Priti një çast. Sakaq u shfaq mbi gurin e madh Zara... Ajo, sikur e kishte kaluar tërë natën aty, futur thellë zemrës së asaj mase të gurtë. Zu të qesh dhe çdo gjë rrëth saj u zbukurua. Dhëmbët e bardhë i ndritën dhe atij iu duk pa vend lindja e diellit që sapo kishte nisur të zbardhët gjithësinë. U hodhën në krahët e

njëri-tjetrit. Për Met Balin, nata që po merrte arratinë kishte qenë e keqe, e ftohtë, por tani nën puthje t dhe përkëdheljet e Zarës u ngroh e gjaku nisi t'i gurgullonte.

Ra brinjas i përqafuar me të e pastaj e hodhi mbi gjoksin e vet duke ia puthur e thithur herë njërin gjii, herë tjetrin, rënkonte, a thua s'kishte mbi vete atë femër flutur, por një arushë të egër e të rëndë mali. Për pak u ndanë dhe u shtrit seicili në hesap të vet. Nuk vonoi shumë e Met Bali i tha :

-Më këndo një këngë.

-Cilën? - ia ktheu ajo.

-Atë që të kam mësuar vet. Këngën e Dudisë...

-Ajo s'është këngë, ajo është shigjetë, është plumb, -tha ajo, -e tani ne s'kemi nevojë pér to, -përfundoi duke qeshur dhe duke e tërhequr më pranë buzëve të saj. Afër drekës, të dy në të njëjtën kohë, bënë të njëjtën pyetje : ku do të vemë? Dhe vërtetë: ku do të shkonin? Në pyll, pranë Gurit të Madh, nuk çohejjeta.

-Marrim rrugën pér në Greqi, -tha Zara.

-Atë rrugë Dash Leka e ka bërë si rrugë vreshti, -iu përgjegj ai.

-Atij do t'i bjerë inati, -tha ajo.

-Ai është derr, -tha Met Bali, -dhe inatin si të derrit e ka. Ra një heshtje e thellë. Më pas Met Bali vazhdoi : Shkojmë drejt detit. Me pak harxhime mund të hidhemi në Itali.

Ajo brofi në këmbë. Shqiptoi emrin e Italisë në gjuhën e vet sa atij iu duk sikur do të këndonte. Çudi, të gjitha rracat e dashkan atë vend.

U nisën kur dita zuri të thyhet dhe të nesërmen në mëngjes u gjendën në atë qytetin e bukur bregdetar, kur dikur Met Bali pat kryer shërbimin ushtarak.

Ja, këtu mbaronte si tokë atdheu i vet, pak më tutje, disa milje në ujë, mbaronte tërësisht. Këtë ndjenjë trishtimi që e kapi në çast, e fshehu, s'e nxorri mbi vete. Jo, duhej të ikte patjetër, ishte i sigurtë se vdekja e ndiqte hap pas hapi, të ikte, të ikte matanë detit. Po me këtë mendje ai gjeti aty dhjetra e dhjetra njerëz. Njerëz të rraskapur, të lodhur, shpresëkëputur që vozisnin, që shtynin ditët dhe netët me sytë të mbërthyer andej nga shkonte dielli, drejt perëndimit. Por më kot, më kot shpresa po fanitej, po tretej ashtu si rëra nën llapaçitjet e ujit të kripur. Met Bali dhe Zara zunë vend në një hotel të rëndomtë dhe mbrëmjet i kalonin tek ai bari i vogël por i pistë në katin e parë, ku një orkestër më e keqe se lokali, e përbërë

nga tre-katër orkestrantë që me të drejtë mund të thoshje se njeri i binte brokës e tjetri këmborës, të detyronin të largoheshe me vrap. Zara prishej në fytyrë, zinte veshët e i lutej Met Balit që më mirë të shkonin e të shëtitin buzë detit, edhe pse atje po aq keq ishte, të mbërthente mërzia e atyre dhjetrave të tjerë. Ai së fundi u bind. Shëtitin deri sa lodheshin e, me të hyrë në dhomën e tyre. Zara me zë të ulët, për të kënaqur veten dhe atë, këndonte nga këngët e saj të mrekullueshme. Në një nga këto mbrëmje, në mes të shëtitjes së tyre të përnatëshme, ata dhe shumë të tjerë u shtangën, u befasuan. Prej atij bari të pistë vinte një melodi e mahnitëshme. Ç'të kishte ndodhur? Mos vallë ata qeraxhinj orkestrantë kishin futur diplomën e konservatorit brenda një nate? Të dy të zenë për dore shpejtuani drejt lokalit. Vunë re se aty kishte ndrruar çdo gjë: jo vetëm orenditë e zbukurimet e tjera, por dhe orkestra, atje tanë katër djem të rinj lozni plot virtuozitet. Zara dhe Met Bali u ulën tek këndi. Shumë shpejt u përqëndruan dhe humbën nën tingujt e melodisë. Pas pak, pranë tyre, erdhi pronari. Ai kërkoi leje për t'u ulur dhe njëherazi porositi për klientët e vet.

-Siç e shikoni, -tha ai.

Met Bali shpejtoi dhe uroi për gjithçka që kishte ndryshuar aty.

-Po shkaku jeni ju, je ti, - iu drejtua ai Zarës. Met Bali gati kërceu përpjetë dhe gati ta hante me sy. Pronari e kuptoi dhe bëri një shenjë me dorë.

-Ju, kur ktheheni nga shëtitja, shkoni në dhomën tuaj. Atje, ti këndon, -i tha Zarës. -Të më falni, por unë, si dhe gjithë ata që punojnë këtu në hotelin tim, për sa kohë ti këndon, rrimë të mbështetur aty pas derës tuaj.

Met Bali u qetësua. E mori vesh hallin e pronarit dhe i dha shenjë Zarës që të heshtte. Do të bëhej fjalë për ndonjë marrëveshje këtu dhe ashtu u bë, kur ai, Met Bali u tregua çuditërisht njeri i thekur prej vitesh. Pronari u tërhoq dhe Zara fluturoi për tek orkestra. Djemtë u ngritën në këmbë. Nuk ia njihnin aftësitë, por bukurinë ia çmuani me të parën. Ajo diç foli me orkestrantët dhe ata ia kthyen me duartrokite dhe entuziazëm. Shpejt Zara ia nisi një këngë. Ajo këndoi, këndoi si për herë të parë. Pak e emocionuar, pak e tronditur. Shumëkush, jo për të justifikuar, por për të thënë të vërtetën pohoi: se ari, kur gërvishet, asgjë s'humbet, përkundrazi shkëlqimi i del më në pah, prandaj ajo që atë natë u rrëthua me ngrëhtësi, me adhurim, madje pronari i shoqëroi të dy dashnorët deri pranë dhomës së gjumit.

Aty u uroi natën e mirë, duke shtuar me buzë në gaz:

-Këtë natë askush nuk do të përgjojë mbas derës suaj.

Mbas kësaj ato mbrëmjet e bukura e të qeta buzë detit u bënë pronë e saj. Zara shkëlqeu. Ajo i dha emër të ri atij bari, dikur aq i papërfillshëm, aq i pistë. Tani ai thirrej shkurt: "Tek Zara". Dhe vinin aty pushues të ngeshëm, qejflinj hokatarë, të mbështjellë me zërin e saj ata i shëmbellënин një familjeje. Dhe rrinin aty, tek pragu e tutje tij, dhjetra nga ata që gjithë ditën e bardhë kishin kullotur sytë dhe mendjen matanë detit, nën zërin e saj, dukeshin më të menduar, më të qetë dhe ashtu, të mbledhur kokëmëkokë, i zinte gjumi mbi rërë.

Në një ndër këto netë, zëri i saj sikur bridhte nëpër qiell e tërë ledhatim mblidhë yjet e ndritshëm në atë hapesirë të pafund, i kthente në buqeta të mahnitëshme e i shpërndante sa në tokë e mbi det. Zor se e besonte kush, se kjo ishte vetëm forca e këngës, jo, diçka si magji a nja Zot e di si mund të quhej, çudia që po ndodhte atë çast; dhjetra njerëz si përkëtej pragut e si përandej, të ktheheshin në yje, të kapeshin dorë për dorë të këndonin si në një kor sirenash, duke valëruar më harmonishëm, më mrekullisht se valët e detit atje pak më poshtë. Pikërisht atë natë, pas atij suksesi të paharrueshëm, Met Bali më tepër përpëlëte j në shtratin e vet, se sa flinte. Aty në të gdhirë, ai kërceu prej shtratit dhe i mbuluar me djersë, mbante sytë dhe duart drejt tavanit. Zara u llahtarës e shkoi pranë tij. Ai gulçonte.

-Ç'pate? - pyeti ajo.

-Pashë èndërr, pashë èndërr atë...

-Bukuroshi im, -i tha ajo dhe e puthi në ballë, - ai na ka harruar.

-Dash Leka nuk harron, -ia ktheu ai.

-Na ka falur.

-Ai s'të fal.

Ajo po përpiqej të gjente fjalë tjetër për ta qetësuar, por këtë më shpejtë e arriti aroma dhe ngrëhtësia e trupit të saj përpara tij.

-Më këndo këngën e Dudisë, të lutem, -tha ai.

-Jo, -i tha ajo, -jo e jo.

-Pse, se ta ka ndaluar fisi yt?! Po ti tani i përket fisit tim dhe unë dua të më këndosh.

-Dudia i pati fëmijët dhe i helmoi, -i tha ajo, -ne...

-Ne s'kemi ende, -ia ktheu ai.

Ajo e puthi përsëri në ballë dhe dalëngadalë ngriti këmishën e natës, duke i treguar barkun e vogël, që sapo kishte nisur të

rrumbullojë pak. Ai vuri duart leht-lehtë mbi të, e përkëdheli, pastaj mbështeti veshin butë, qeshi si fëmijë dhe e mbuloi Zarën me të puthura.

Hyri vjeshta. Para se të lajmëronin për ardhjen e saj gjethet e pemëve, shpejtoke ujët e detit. Pushuesit u rralluan së tepërmi. Ata që kishin ardhur për të kaluar matanë detit, dukeshin sikur mbanin varur në qafë tabela me fjalët : Shpresa të këputura!

Met Bali e Zara, me fitimet e mbledhura, kishin nisur një shtëpi mbi truallin që u kishte shitur pronari i hotelit. Jetën dhe tërë gjithësinë sikur e kishte mbuluar një qetësi në kufijtë e përgjumjes. Prapëseprapë atje "Tek Zara" frekuentimi ishte ende për t'u patur zili, në krahasim edhe me lokalet moderne dhe tepër më të bukura. Atë buzëmbrëmje, pas asaj dite plot shi dhe erë, Zara po i kënaqte klientët e vet me ca këngë melankolike që ngjiznin me atë mot të zyrtë. Burrat në lokal, rrëkellenin herë pas here gotat që kishin përparrë, e përsëri merrnin një pamje të trishtuar. Vonë, tepër vonë, kur edhe pronari e humbi durimin e mezi po porosiste që klientët të largoheshin, u hap dera dhe hyri brenda një burrë i gjatë dhe i shëndetshëm, i panjohur për kërkënd. I panjohuri shkoi dhe u ul drejt e tek tavolina e kreut. Kjo i çuditit të tjerët. U ul me zhurmë dhe po më zhurmë porositi. Ai sikur donte të protestone ndaj asaj gjendjeje që ishte krijuar aty. Por i panjohuri s'ngeli përfundimisht i tillë. Met Bali luajti nga vendi dhe u bë gati të shkonte drejt Zarës, ta rrëmbente, ta hidhte në krah e të zhdukej sa më parë, por iu duk e pamundur. I panjohuri ishte e keqja, e zeza e tij, dora vet Dash Leka. U përpoq dhe hyri në lidhje me Zarën. Ajo i dha një shenjë si për ta qetësuar, si për t'i thënë atij se unë mortjen e pashë dhe e njoha që sapo hyri. Prandaj me të mbaruar këngën ajo nisi një tjetër dhe një tjetër dhe herë pas here vështronte pjerrtas Dash Leka që hiqej sikur s'donte t'ia dinte për asgjë, veçse porosiste e rrëkelliste gotat gjithnjë me zhurmë, madje dhe me një farë kapadaillëku. Pronari aty tek këndi përpiquej t'i jepte asaj shenjën e pushimit, por ajo bënte sikur s'e vinte re. Në një çast diç bisedoi me djemtë e orkestrës dhe sakal shpërtheu prej gjoksit të saj një zë krejtësisht i padëgjuar nga adhuruesit e vet aty në lokal, por jo për Met Balin. Ajo kishte nisur këngën e Dudisë. Ai u ngrit në këmbë. Të tjerët shkundën prej vetes plogështinë dhe atë melankolinë kapitulluese. Zëri gjëmonte. Nisi i lartë, por kurrë nuk ra, veçse ngrihej e ngrihej, me nota plot drithërimë, që shkonin prej zemrës deri në ngjethjen e krej trupit. Në pjesën e dytë kënga i shokoi të gjithë. Nja dy-tre

burra djathtas lotonin dhe sikur krenoheshin pér këtë. Pronari s'di pse kishte përqafuar Met Balin. Ndërkaq Dash Leka kafshoi me tërsëllimë gotën.

Dudia helmoi fëmijët e vet, thoshte kënga, fëmijët janë ëngjëj në qiell. Prej buzëve të Dash Lekës kullonte një rrëkezë e gjaktë. Kënga sulmonte ngado. Këngëtarja kishte marrë formën e shpatës. Gjendja aty përqark, e mbërthyer nga ankthi, gati të përlotur. Fëmijët s'kanë vdekur, fëmijët janë në qiell... Nëna u çmend.

Ndërsa unë jam gjallë, jam gjallë, belbëzoi Dash Leka, kur dy djemtë e mi dhe ajo kërcure, nëna e tyre, janë... Ai u mek.

Nëna marroke vdiq, vdiq... Kënga mbaroi dhe aty, me sende e me njerëz, sikur vareshin diku në fije të perit. I vetmi që mundi të veprojë ishte Met Bali. Ai u shkëput nga pronari me forcë e bëri këmbë mu aty në mes të sallës, përballë kushëriut.

-Më vra, Dash Leka, - i tha, -vramë në se të bëj të lumtur!

Ankthi i mëparshëm u kthye në tronditje, në lemeri. Zara lëshoi një klithmë të llahtarshme. Pas saj një krismë arme çau muret e fluturoi në krahët e asaj nate sterrë të zezë. Një trup i gjatë, i shëndetshëm, u përplas mbi dysheme. Dash Leka kishte vrarë veten.

## MI NË BIBLIOTEKË

Drejtori i bibliotekës ndërroi krejtësisht, madje ndryshoi fare papritur. Ai njeri që, dikur, për vite me radhë s'ishte parë të hynte nëpër klube ditën, tani po frekuentonte ato të natës. Prej kohësh ishte krijuar përshtypja se edhe hapat e veta kur i hidhte i mendonte e jo si tani: i zhurmshëm, i shpenguar deri në prag të skandalit, kur polici i Bashkisë sipas rregullores dhe me mirësjellje i kishte kërkuar identitetin, ndërsa ky i kishte rrëfyer bërrylin dhe kishte hyrë drejt e tek kryetari. Shumëkush këtë ndryshim e lidhte me atë të krejt vendit. Sistemi i dikurshëm e pati vlerësuar, drejtor e kishte emëruar, dhe ky i riu qerpikun nuk i kish lëvizur. Prandaj me të drejtë disa nga kolegët, pra vartëset e tij, nuk bashkoheshin me këtë opinion, por zunë të rrëmijnë në jetën e tij personale. Disa të tjerë, të një rrëthi më të largët, këtë gjendje të re, e quajtën thjeshtë rol të ri. Këtyre pak kush ua vinte veshin. Vet drejtori, i detyruar për të frenuar këtë larmi opinionesh, u deklarua në një intervistë në një gazetë jo pa rëndësi. Ai akuzoi sistemin e kaluar që, qysh para 20. vjetësh, kishte qenë i pashpirt ndaj tij, duke emëruar edhe pse i diplomuar

shkëlqyeshëm, në një zonë të thellë. Shkruante për një privacion të pakuptimtë në pezullimin e studimit për arte figurative, madje aludonte edhe për martesën e tij, bërë 17 vjet më parë, me vajzën e një oficeri, të cilën e kishte për bashkëshorte edhe sot e gjithë ditën, por që kishte pasur një kusht në mes. Thoshte diçka për një gjyshin e vet, që diku ishte përpjekur të botonte një gazetë private e përkëtë qëllim ishte dënuar me 10 vjet burg. Në të vërtetë, edhe atëhere, edhe tani për gjyshin e tij, bashkëqytetarët shpreheshin me admirim. Pastaj, drejtori në atë intervistë sikur shpaloste, si të thuash, një platformë të shpirtit dhe të punës. E krahasonë veten me një përrua malore, me një rini të rikthyer rishtas, plot energji, që vrapon të arrijë kohën e humbur dhe, këtë thirrje, në formë postulati, ua drejtonte gjithë lexuesve. Vartëset jo që e lexuan të parët intervistën, por më mirë të themi e thithën, veçanërisht ajo më e reja, që ishte marrë në punë para një muaji për libralidhëse, por shpejt u ndërrua e tani punonte si gjysmë sekretare aty para zyrës së drejtorit. Ajo u emocionua tepër dhe mbushi sytë me lot. Të tjerët e vështruan të habitur.

-Pse më shikoni? - pyeti ajo.

-Ti dhe kur qan je për të këputur kokën, -tha Lili, punonjësja më e vjetër.

Dhe vërtetë ajo ishte një mrekulli. Jo më kot verën që shkoi kishte marrë një çmim goxha të vlefshëm në shkallë vendi në Miss Albania, organizuar nga Televizioni. E gjatë, flokëzëz, që gati i arrinte belin, me këmbë të bukura, provokuese që më kot përpinqeshin ta fshihnin këtë meritë, me anë të atij minifundi meshine, një pëllëmbë mbështjellë mbas vitheve vezake.

-Mua më tronditi intervista - tha bukuroshja, duke hëdhur ato këmbët e bukurë njëra mbi tjetrën, e tani lakuriqësia e tyre që shkonte gati rrëzë kofshëve, ishte e befasishme, ndjellëse. -Intervista ishte e sinqertë, -vazhdoi ajo, -kështu që dhe hamendjet tona rrëth drejtorit shkuant kot.

-Ua, ç'na the! - tha Vera, një vajzë e urtë, e sjellëshme, që kishte filluar punë aty këto dy vjet, me rekandimin e një shoqate, pasi s'kishte arësimin përkatës, por që ajo, falë zotësisë dhe dinjitetit të saj po e mbaronte fakultetin me rezultate të mira. -Unë kurrë nuk u kam besuar gazetave, -tha ajo, pasi hodhi vështrimin përqark, -unë kam një mendimin tim, kur bëhet fjalë për ndryshime në karakterin e njeriut, aq më tepër kur ndryshimet bëhen për mirë, siç mendojmë ne për drejtorin, pra shkak për gjendje të re, bëhen vetëm gjëra të

brëndëshme, të ngushta. Unë para dy ditësh, fare rastësisht zbulova një të tillë në jetën familjare të drejtorit.

-Ç'farë? - gati u hodh përpjetë Lili. Ndërsa Monda, sportelistja e librit, që s'kishte marrë pjesë në bisedë deri atëhere, u afroa më pranë, kurse Sana, ose "tetoja" siç i thoshin të tjerat, pastruesja historike e institucionit e la fshesën atje tutje.

-Para nja dy ditësh, -e ngriti zërin Vera, -një nga shoqet e mia, nga matanë trotuarit më tregoi gruan e drejtorit. Ju më kishit thënë se ajo që rrëth 20 vjet martese nuk kish mundur të mbetej shtatzanë. Ja ku po ua them me bindje: ajo, më në fund, kishte mbetur shtatzanë... Si thoni, - tha ajo më me forcë, -a s'ka të drejtë të fluturojë me krahë drejtori ynë?

Një buzëqeshje e lehtë kaloi nga Lili tek Monda e përfundoi në një të qeshur si prej burri të teto Sanës. Ndërsa sekretaria bukuroshe kishte mbetur si pikëçuditëse. Këtë gjendje e prishi Lili.

-Të më falësh, Vera, se nuk dua të të fyej. Kaq budallaqe je vërtetë? Mirë eksperiencë s'ke, se je ende vajzë, por nga ç'ke parë, nuk e dallon dot rrumbullakosjen e barkut të gruas nga shtatzania dhe rrumbullakosjen nga makaronat, nga brumrat. Drejtori ynë nuk ia thotë për ato punë; për këtë ne kemi dëshmi tepër bindëse, - përfundoi ajo, duke hedhur shikimin shkarazi drejt Mondës. Monda, dikur, kur u nda nga i shoqi, një burrë pijanec që tani kishte përfunduar në pacient të përhershëm të senatoriumit, gjatë një ekspedite për përhapjen e librit në fshat, falë një çasti dobësie a rrethane ende të pashpjegueshme, pati një flirt me drejtorin dhe, në se ai nuk u realizua përfundimisht, faji ishte i paaftësisë mashkullore të atij. Monda s'kishte ndërmend të rrëfehej aty, por siguroi Verën se, ç'ka tha Lili, ishte tepër e vërtetë.

-Megjithatë, - tha Lili, -unë po ju siguroj se tërë këtë ndryshim të tij, tërë këtë mobilizim, siç thotë kjo bukuroshja jonë. Pra këtë optimizëm që ka mbërthyer zotin drejtor, mos u lodhni t'u jepni krahë të tjerë, veçse këtij që them unë: ai ka rënë në dashuri!

Sytë e të gjithëve shkuan drëjt bukuroshes. Në të vërtetë një farë dobësie e drejtorit për të ishte vënë re dhe sdiomos kur ajo nga punëtore e thjeshtë, përfundoi në një sekretare të plotë, edhe pse e pashpallur, sikur hamendjet s'mbetën më të tillë.

-Uaaa, po ti Lili, sikur the se ai, ai?! -tha Vera.

Bukuroshja gjithë naivitet dhe si për t'u thënë të tjerëve se edhe në këtë fushë të jetës dinte diçka më tepër, nisi plot emocion të flasë:

-Ç'ka thotë Lili s'duhet marrë si absolutisht e vërtetë, vazhdonte ajo të përkëdhelte gjunjët e vet. -ja unë kam lexuar në gazetën "Eros" se gjëndja seksuale shpesh është e kushtëzuar prej streseve të ndryshme të jetës, do të mjaftonte një ngacmim, një gjendje emocionale e re, dhe papritur do të kishim riaktivizim të fuqishëm të...

-Dmth, drejtori ynë deri dje me strese s'na ishte për burrë, kurse sot kur tërë shoqëria po ndryshon nga themelat atij po i rikthehet... si e thatë ju? Po i riaktivizohet...

Të qeshurat qenë shpërthyese, por bukuroshja u fye.

-Pse ma banalizoni mendimi!... Pastaj unë thashë diçka që e kisha lexuar.

-Në ç'gazetë? -e ndërpren Lili.

-Në "Eros".

Lili, po të kishte më tepër afinitet me të, me siguri do t'ia kishte dhënë një pëllëmbë fytyrës. Ajo "Erosin" ende s'e kishte futur në bibliotekë, madje dhe në lagje i turrej asaj gazete si macia miut. Shpesh thoshte, ashtu siç tha dhe tani: kot flasim për ekzistencën e tre pushteteve, jo, janë katër e i katërti është imoraliteti dhe më i fuqishmi! Bota këtij po ia sheh dhe do t'ia shohë më tepër sherrin. Ruhuni ju. - i tha bukuroshes, -se mund të jeni në martiret e para!

Teto Sana kur e pa që biseda hyri në ca gjëra që as i kuptonte, as i honepte dot, u ngrit dhe duke u bërë një xhest shakaje shoqeve, vajti e mori fshesën. Edhe të tjerat u ngritën.

-Megjithatë, hamendjet për të gjetur burimin e ndryshimit të drejtorit vazhdojnë, -tha Lili buzëgas.

-Ti tek pushteti i katërt, -qeshi bukuroshja që edhe tani në këmbë, ndriste nga kreu në fund hijeshi. -Po ti? -iu kthye ajo buzagas Sanës.

-Unë, unë, -që me sa u duk s'e kishte marrë vesh pyetjen, - unë me ty, vetëm që s'jam mashkull, pa ua kisha treguar atyre kofshëve të tua! -përfundoi teto Sana dhe iku e para.

U ndanë. Nuk kaluan shumë ditë, diku aty nga fundi i javës, ndërsa prisnin të mblidheshin në zyrën e drejtorit për një çështje punë të lajmëruar kohë më parë, ato tre punonjëset që prisnin në koridor, u vunë si në radhë kur doli drejtori i shoqëruar prej sekretares që ndriste si një yll nate. Ai u tha se ishte thirrur për në Bashki, së bashku me bukuroshen, kështu që takimi do të bëhej javën tjetër. Ata ikën. Punonjëset pak të befasuara, po edhe të gëzuara që sot ishin më të lira, i ndoqën me sy deri matanë oborrit.

-Edhe drejtori e paska ndrruar kostumin sot. Vetëm këto ditë e ka të tretin që ndrron, -tha Monda.

-Të jesh pranë asaj femre ndrron edhe kokën, -qeshi Lili që ftoi Verën për të ngrënë mëngjesin së bashku. Ndërsa teto Sana iu përvesh një pastrimi të përgjithshëm. Njerëz në sallë nuk kishte fare. Ajo u mor në fillim duke u ndihmuar herë pas here prej Mondës, pastaj ajo vendosi të pastrojë zyrën e drejtorit.

Hapi derën me kujdes. Kaloi dhomën e sekretares, por veç pasi u dënd mirë e mirë me aromën e deodorantit të saj të zakonshëm, dhe hyri në zyrën e drejtorit. U shkoi një dorë me kujdes, me leckë të thatë, tërë orendive të xhamta të zyrës. Pastaj u ra parvazeve të dritareve. U afroa tek dera e brendëshme. Aty ndaloi një çast. Ai vendi i ziles së zakonshme që qysh prej kohësh ishte bllokuar, sepse ishte zhbllokuar e lejonte të shihje tej e tej. Ajo afroi syrin dhe shikimi i shkoi drejt e tek karrigia e sekretares. Me siguri, tha, drejtori ka vendosur të verë përsëri zilen. U shkëput prej aty e u bë gati të mirrte koshin e hedhurinave tek këndi. Sipër hedhurinave të tjera, që padyshim ishin copa letre të pavlerë, i tërhoqi vëmendjen një e palosur me kujdes. E mori atë e nisi ta hapë, por në çast e lëshoi sikur të kishte kapur me dorë një minë. Në të ishin vizatuar një palë këmbë, pra me gjurin e me pjesën e parë të kofshëve. Për nga finesa, eleganca, padyshim që ishin të seksit femër. Ajo mori koshin me rrëmbim dhe atje ku i derdhë vuri re se si ajo letër nuk ishte vetëm një, por 5, 10, 100 të atilla të vizatuar. Thirri punonjëset e tjera. Ato u shtangën. Vera mbuloi sytë, Monda ishte bërë dyll, kurse Lili me stoicizëm ia pat:

-Po kjo bukuroshja jonë shalët hapur ia mbaka gjithë ditën atij?

-Qyqja! -ia bëri Sana, -qyqja për sekretaren e ke fjalën. Pse të sajat janë? Seç i tha Mondës në vesh dhe e mori më vete duke e shpurë drejt e tek ajo vrime ku diku kishte qenë vendi i ziles. Monda ngjeshi syrin e menjëherë iu shfaq karrigia kur rrinte sekretaria bukuroshe, madje sepse iu duk sikur ajo edhe atë sekond ishte ulur aty, ja ashtu këmbë mbi këmbë, befasuese, ndjellëse dhe për një të rastësishëm dhe jo për atë të shkretë që gjoja na paskish nisur studimin e anglishtes, kur në fakt kullonte i tëri mbërthyer pas asaj djall vrime.

Monda porositi Sanën që ky muhabet të mbyllej njëherë e mirë. Kjo nga ana e vet jo vetëm që i premtoi, por edhe sot e gjithë

ditën vazhdon t'ia mbajë fjalën, veçse herë pas here i thotë se vizatimi i kofshëve vazhdon, me një ndryshim fare të vogël, se për vizatimin e tyre kanë nisur të përdoren edhe ngjyrat.

Korrik, 1994

## MUHAXHIRËT

**M**uhaxhirët, që çuditërisht, edhe pse i rrumbullakosnin mbi njëzet vjet, të ngulur aty në ca moçale e në një rrip zallishtë buzë lumit, ende vazhdonte të quheshin të tillë. Kishin zbritur nga malësitë e Pejës, ndonëse vendasit në fillim nuk i priten mirë, pasi ato hapësira atyre u kishin shërbyer për bagëtitë dhe për peshkim, përkundrazi qeveria qe treguar më mikpritëse, por edhe kjo, kur e pa se ata bij të gurit, lindur e rritur në ato kullat e llahtarshme dhe krenare, zunë të përdornin baltën, po me atë mjeshtëri të fusharakëve për të ngritur ato kolibet e tyre, u tërroq e s'u kujtua më për ta. Ky fat i ndoqi ata gjer aty nga gjysma e viteve pesëdhjetë. Shumë ujra kishin rrjedhur. Ngjarje të mëdha për ta e për botën mbarë kishte pasur. Ishte zhvilluar një luftë e tërë botërore e megjithatë ata prapëseprapë thirreshin muhaxhirë. Ky ishte një absurditet. Pak gjëra tashmë i dallonin prej fqinjve vendës, madje, edhe për nga shtati, ata njerëz, bij të një fisi të madh e të bukur, të drejtë e të gjatë, sikur ishin shkurtuar. Por gjëje ende midis tyre burra të një fare të fortë. Një ndër ta ishte kryetari i këshillit Cen Rama, burrë

i fuqishëm, eshtak dhe gati dy metra. Me një qeleshe të bardhë në kokë, që s'kishte asgjë të njëjtë me takijen e vendasve, rrrethuar me zhul djerse, kurse qeleshja e tij vetëtinte dhe e pastër si në një ditë në ditën tjetër. E, pas Cenit, binin në sy edhe dy miqtë e tij, veç jo gjithnjë të tillë: Lin Bodinaku dhe Dem Zeka, themi jo gjithnjë miq se ja, kur priste të vinte për një takim me popullin vet i madhi i rrrethit, për arsy se askush prej "muhaxhirëve" nuk jepte as taks, as nuk njihet kurrfarë detyrimi ndaj shtetit, ata të dy, bashkëpatriotët e tij, do të ishte mirë të mos vinin. Ata nuk mbaheshin. Ata e kishin gjuhën brisk, fjalën majë thike dhe për vetë kryetarin e këshillit, mikun e tyre, e jo më për të tjerët, që as ua bënte koka bëf. Pra, ashtu siç parandjente kryetari i këshillit, mbledhja mund të merrte zjarr, se thika, popullit që drejtonte ai, i kishte vajtur në palcë, e ndërsa ai, me urtësinë e tij, me autoritetin e vet do përpiquej të shuante zjarrin, dy të tjerët, si Lini, si Demi, nuk do ia mbanin krahun, përkundrazi do t'i hidhnin benzinë. Prandaj ai, thirri sekretarin, një i krishterë vendës Toli Nasen dhe e urdhëroi të lajmëronte njerëzit, veç atyre të dyve, ata të liheshin mënjanë, e në se kjo ishte e pamundur, t'u thuhej se mbledhja s'do të ishte kushedi çfarë. Më tepër do flitej për gjëra familjare, për fëmijët, shkollat e të tillë mbröçkulla, shkurt, punë grash. I krishteri i urtë bëri kryq.

-Jam i detyruar të gënjej - i tha Cen Rama, -dhe shiko, atë kryqin shko e bëje në vendin e vet. Kauri i derrit!

Toli s'ia mori për keq. Atë shprehje kryetari e përdorte gjithmonë me humor, por tani s'ishte punë shakaje e, megjithatë Toli që ia kuptonte hallin, nuk e zgjati. Iku.

Kryetari i këshillit hyri në atë sallën ku do të zhvillohej mbledhja. Aty, çdo ishte në vendin e vet. Ishte pastruar, stolat ishin në radhë. Parrullat e kohës kuqelonin ngado. Përballë dallohej ajo që fliste për miqësinë e madhe midis Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik. Vet kryetari s'e kishte me sy të mirë këtë miqësi, madje ai, pikërisht ata që atë me gjithë fisin e tij e kishin shpërndalur prej bjeshkëve të Pejës i quante të një rrace me rusët. Mirpo ja, Tirana thoshte se dhe me këtë rracë mund të shkoje. Ai u përtyp dhe tha me gjysmë zëri: "Ashtu qoftë!" Vajti atje tetavolina e podiumit. Ishin pesë karrike. Ai i hoqi dy. La një për vete, një për Tolin dëj një për atë të madhim. Hallahile, the me vete, çdo të thotë ai këtu në mes të mixhlist? Po a e di ai që këtu ka shtëpi që nuk prodhon as një muaj bukë? Se zallishtja s'jep grurë, por zall, se moçalishtja s'të jep grurë, por mushkonja, mushkonjat që po na i thajnë fëmijët.

Ç'taksë tē japim ne? Ndërsa mendohej dhe fliste me 'veten, njerëzit zunë tē hyjnë nē sallë. Shumë shpejt aty kërciti muhabeti dhe tymi i duhanit tē sertë. Ai urdhëroi tē hapan dritaret, por ndërkokë merakun e kishte nē tjetër vend. Jo vetëm me sy, por edhe me këmbë i ra sallës. tej e. tej. ...U kthye i kënaqur: as..Lini, as Demi nuk kishin ardhur. I dha një shenjë gjithë kënaqësi sekretarit tē vet, Lonit dhe ky po ashtu ia ktheu. Një rresht grash, aty nē radhën e parë, i kërkoi atij që t'u jepte nga një letër me firmën dhe vulën e tij pér tē marrë sikur dhe nga dy kile miell nē depot e grumbullimit. Ai u premtoi dhe u afroa pranë njerës që mbante dy fëmijë tē vegjël qurramanë mbi gjunjët e vet.

-Po, këta, pse i ke prurë, i lije atje tek pulat.

-Jo, kryetar, jo i kam marrë t'ia lë atij tē qeverrisë! Atij do ia lë, ja m'u aty mbi tavolinë, se unë, ti e di...

Ai e dinte fort mirë dhe s'kishte ndër mend ta dëgjonte pér tē sajtën herë, ndaj bëri më tutje me tē shpejtë.

Në çast një borri e zgjatur makine jehoi së largu e sakaq, në oborr u dëgjua një zhurmë nē fikje. Pas pak hyri nē sallë një burrë i shkurtër, veshur gjysmë ushtarak, që nderoi ashtu alla partizanë dhe shkoi e u ul në presidium. Ishte ai, dora vet, kryetari i rrethit. Salla gumiëzhiu, mëdje andej nga fundi shpërthyen edhe tē thirrura. Cen Rama e ndjeu veten ngushtë. Të paktën njerëzillëku s'ka pse mungon edhe pse tē mungon pasuria!

-Motra, vëllezër...

Po pse pushonin ata? Atëhëre kryetari i këshillit, Cen Rama përplasi fort mbi tavolinë qeleshen e bardhë. Salla heshti. Ata aty, pa përjashtim kishin jo vetëm respekt, por edhe adhurim pér këtë burrë që jo vetëm ishte nga gjaku i tyre, por nga që e dinin se atë e donte tërë ajo nahi nga ku lindtë e perëndonte dielli.

-Nuk e di ç'u ka thënë Loni, - vazhdoi pas kësaj Cen Rama, -po, po nuk e di në se ua ka bërë tē qartë pse ka ardhur ky burrë sot këtu, pa po ua them: ka ardhur me mendje tē keqe.

Salla u ndez më keq dhe kryetari i këshillit e kuptoi paq se e shkeli. Dreqi ta hajë! S'mësova që s'mësova se si hapan këto jallane...

-E po mos bëni si gratë, -bërtiti e prapë e prishi. Pse pak gra kishte aty? Kjo s'qe gjë hiç me ç'e gjeti më vonë, pikërisht pak më tutje; aty mbështetur pas parmakut pa, si dy gjela majë plehut, ata tē dy: Linin dhe Demin. "Të marrët" - belbëzoi dhe në çast i futi një shqelm aty nën tavolinë Lonit, i cili u drodh e u përdrodh sikur ta kishte kapur korenti. Nuk tha asgjë. Ç'të thoshte! Edhe ai i pa ata tē

dy që rrinin krekosur atje tek dritarja. Ai i madhi i rrethit ndërhyri për të rikthyer qetëinë. Diç bisedoi me Cen Ramën. Me siguri po i thoshte se ti e nise për djall këtë punë...

-Mjaft, de, mjaft! -ulériu Ceni këtë radhë kryetarit të rrethit, a sallës, a vetes së vet, zor se e përcaktoje dot.

-E mirë, keq, keq e nisi kryetari juaj, - ndërhyri ai i rrethit. - Nuk është e vërtetë se kam ardhur me mendje të keqe. Kam ardhur si përfqaqësuesi i qeverisë dhe...

-Qeveria na e ka hequr fillin! -ia këputi dikush.

-S'është e vërtetë, s'është e vërtetë.

-Si s'na qenka e vërtetë, -u hodh e nxehur ajo gruaja që mbante të dy fëmijët mbi gjunjë. -Qeveria, qeveria po na bën të hamë, të hamë... që hëngërt kokën e vet ishalla!

-Ta marrim më shtruar, -tha kryetari i rrethit.

-Ne s'kemi ç'të japim, doni gurë zalli?

-Doni mushkonja?

-Doni shpirtin?

-As njërin, as tjetrin, -po këmbëngulte ai për t'i qetësuar dhe vazhdoi: Unë i di të gjitha, me Cen Ramën kam folur...

Një kollë si bubullimë brodhi nëpër sallë. Cen Rama e njohu, e dinte se ai gjyryk ishte i Lin Bodinakut dhe s'ishte kollë, por thikë që sapo u nxorr prej myllit. Priti në ankth. Kryetari i rrethit vazhdoi

-Unë them se këtu, pavarësisht se ju qaheni, pra them se ju mund t'i shlyeni detyrimet, taksat e ç'u takon. Kjo ndonjë tokë Myzeqeje s'është, por dhe e keqe shumë s'më duket. Po të punoni...

-Të kanë thënë që s'punojmë, a?

Cen Rama e njohu zërin e Dem Zekës... Prit kur të hedhë shkëmbinj. Por për fat ai s'foli. Kryetari i rrethit bëri sikur s'dëgjoi dhe vazhdoi në të tijën:

-Ne ju duan dhe qeverria ju do.

-Ju këput barku, -tha dikush.

-Kështu nuk shtyhet. Mjaft me përkëdhelje, dhe ju si gjithë fshatarët e tjerë... Pse çfarë jeni ju? - i madhi i rrethit u nxeh, po turfullonte me veten. -Po, po asnje ndryshim. Qaheni, qaheni tepër, por t'ju vijë turp, trup nga vëllezërit sovjetikë, -dhe e tha këtë fjalë i zi, sikur vëllezërit sovjetikë të ishin diku aty matanë gardhit, -ata punojnë dhe ne hamë. Ata djersijnë dhe ju hiç. Atje një kolkoziane i thjeshtë, se ç'do thotë kolkoz ju e kuptoni, kjo punë ka filluar edhe tek ne, pse ajo shoqja kolkoziane mbledh e lidh 3000, 4000 duaj në

## I hektar.

Salla gati tē ngruhej nē këmbë. S'kishte zot qē t'i khente qetësinë. Tē gjithë ishin bërë si tē çakërdisur. U desh zëri i Dem Zekës qē mundi ta dalë mbi tē gjithë.

-Zotni, -tha ai. -Zotni, kryetari i madh...

Kryetari i vogël, qē tanj jo vetëm zërin ia njohu, por i pa dhe fytyrën, ato mustaqet si bigë, qē atë çast i përkëdhelte me qejf tē madh. Pra Cen Rama, ku ta gjente një sebep qē tē dilte jashtë. Që Dem Zeka mbante bidonin e benzinës nē dorë, s'kishte më pikë dyshimi.

-Zotni kryetari i madh, -vazhdoi ai, - kam qenë e ku s'kam qenë, nē tē rit, kam qenë hafi, suvari, akçi, kam bredhur tej e tej Moskovin, hiq Dobruzhën, e kudo kumbulla tē tharëta kishte, qē një tē lëpije, vrapin nē shtatë katunde e mbaje.

Shpértheu gaz i madh, pa nën tē vlonte dhe inati. Atë ç'ka dëgjuan prej tē madhit tē rrëthit, ata gati e kishin quajtur marrëzi...

-Ndërhyni, ju lutem, ndërhyni, -po i lutej kryetari i madh tē vogëlit, por ky tashmë e kishte tē qartë si drita e diellit se s'bëhej më mbledhje aty, veçse zjarri do shtohej. E ja, ia pat Lin Bodinaku.

-Mos i thuaj gjë hiç kryetar Cenit, jo hiç, do flas unë tanj. Aty midis tē tjerëve ai dukej si mal.

-Unë zotni i qeverisë, jam myhip, po jam myhip dhe nuk i vë dot shpatullat tokës, pa thënë gjithmonë tē vërtetë. Ja ku po ua them, nuk shkoj dot nē botën tjetër pa ua thënë edhe këtë. Hatri le t'i mbesë kujdo. Ky zotnia i qeverisë është duke na shqep me rrena. Asnjëlloj, asnjë fjalë tē këtij se besoj. Pse s'i besoj. Dua ta di: ajo kol-zjanja (kolkozianja) njeri është apo xhindi. I paska lidh ajo 3000, 4000 duaj, ajo sikur edhe nē bythë tē rrijë, nē bythë tē ulet nuk i numëron dot, nē se s'ka dhe një qatip me vete.

Tani s'bëhëj më fjalë për mbledhje. S'po e merrte vesh i pari tē dytin. Ca hynin, ca dilnin. U ngrit Cen Rama dhe rrept i foli Lin Bodinakut.

-Lin, -tha, -Lin, na e prishe terezinë!

-Po pse, çfarë thashë unë. Unë thashë vetëm s'e besoj!

-Po mirë, kush tē pyeti ty në e beson apo jo?!... Po pse, ka burrë qē edhe e beson? Po pse unë e besova, a! Hiç s'e besova. Mos fol! Medemek prita unë sa tē vijë deri tek ti rrena. Domethënë ti e kuptove dhe unë s'e kuptova!...

Dhe po me atë ton, po me atë nerv, iu kthye tē madhit tē rrëthit:

-Po ti, allahile, a i ke parë vet ato ç'ka the, a ke qenë në Rusi?

-Jo, -tha i shkreti që e kishte humbur keq, -jo, po gazetat shkruajnë.

Cen Ramës ia pat qejfi tia jepte me një shuplakë ftyrës, por s'ishte punë burrash ajo. Ngarkoi Lonin që të merrej me atë, ta përcillte deri tek makina e vet shpejtoi e doli jashtë. Në mes të oborrit e prisnin dy miqtë e tij, që heshtazi mbanin vesh se ç'do bënte dhe kur e panë se po vinte drejt tyre, u qetësuant mjaft. Ata e futën në mes dhe, ngadalë, urtë-urtë u nisën për atje tek klubin, në qendër.

## **"DOVER"**

**M**artin Çeli hyri edhe në komisionin e nëntë. Gati në të gjithë komisionet, që organizonte Këshilli i rrethit, apo ai Bashkiak, z.Çeli do të nderonte patjetër. Dhe s'ishte pa interes kjo punë. Në se aftësinë e personave që merrnin pjesë në to, të kuptohemi jo për të gjithë, e kishte marrë lumi, prapë se prapë kofsha ishte e dhjamur. Ja, si vetë 7000-8000 lekë i merrte rrogë, por gati kaq ishin edhe të ardhurat prej komisioneve, madje këto shpesh shkonin edhe më tepër. Komision pronash, trojesh, fushash, pyjesh, malesh, detesh... Ç'ta zgjasin, me të drejtë mund të quhej stinë komisionesh. Por, kur zoti Çeli aderoi edhe në këtë të nëntin, çudia qe absolutisht e madhe. Ç'lidhje kishte ai me invalidë? Ai i kishte të dy sytë aty ku duheshin, ashtu i kishte edhe të dy duart, edhe të dyja këmbët. Megjithatë dikush tha se zoti Çeli ishte invalid. Dhe ky dikushi s'ishte sidomu kudo. Atij s'i mungoi as argumenti, as opinioni që e mbështeti pa rezerva. Një "degëz" e argumentit ishte kjo: ai, pra, zoti Çeli, edhe pse kishte vite i martuar, ende s'po ngjiste në gruan e vet, pra nuk ishte si në të tjerët, të sërës së Adamit, që në krye të nentë muajve

të japim rezultatin, fillimi siht në maternitet e pastaj në publik të gjërë. Por skeptikët thanë se kjo fatkeqësi mund t'i atribuohej fare mirë të shoqes së tij, Sonilës. Ajo vërtetë ishte si kone e vockël, e pakët nga trupi, që gjë të pakët e kishte, ama tepër në harmoni. Pylpat e vogëla e të bukura, belin e hollë e tepër të lakuueshëm, gjinjtë e vegjël si të një gjimazisteje akoma të parritur, por provokues sa më s'bëhej. Sytë të vegjël vërtetë, por bojë qelli. Shkurt, shpërthyese, energjike e dukej sikur tërë ditën vraponte. Pra, një tip i tillë, që të falte jetë, e padishim, edhe pjellshmëri. Sikur të mos mjaftonte kjo, erdhë prej një ish shoqes së saj një dëshmi, që ajo, Sonila e bekuar, jo vetëm që ish e zonja për ripërtëritjen e lloit, por në një rast, kur ajo s'ishte më tepër se 19 vjeç, falë një dashuri të tradhëtar, bëri një abort, duke pasur dy krijesa në shtatzaninë e vet. Por në atë kohë aborti quhej krim dhe planifikimi familjar tradhëti kombëtar, kështu që çdo gjë humbi si kripa në ujë. Atëherë vëveti fajtor i vetëm dhe i padiskutueshëm mbeti zoti Çeli. Ndaj zonjushës Sonila adhurimi u shtua pamasë, shpesh herë shprehej edhe keqardhje përfatim e saj të keq, shpesh herëvdhe pshërtëtivej, sidomos prej atyre lapardharëvë, që e imagjinonin veten të shtrirë në një shtrat, ku patjetër ajo kone aq e lezetshme, ashtu fare lakuiq, do t'i shëmbellente një akulloreje. Për zotin Martin që deri dje pjesëmarrja në komisione ishte trajtuar si akt makuterie, manjak lekësh, etj, pas kësaj dite, ky pasion u shpjegua ndryshe: si një akt kompensimi, që përpilen ta bëjnë këta tipa eunukësh, të tredhurish, para opinionit shoqëror.

Duke qenë të gjithë nën tryshnë e këtij gjykimi përfundë, askush nuk u habit kur ai vrapi edhe tek komisioneri i dhjetë, që kishte ngritur Bashkia përfundë vlerësuar filmat erotikë, pasi së fundi kishin mbirë si kërpudhat pas shiut. Ai doli një çast nga zyra. Bleu dy çokollata "Dover" dhe ia dha Albertit, kolegut të vet përfundit ia çuar Sonilës në shtëpi. Kish muaj që ia bënte këtë dhuratë të shoqes. I mbytur në punë, e sidomos prej komisioneve, dhurata e "Doverit", sikur kishte mbetur e vëtmja lidhje me të. Megjithëse një ditë fare rastësisht kishte takuar një nipin e Sonilës, pikërisht atë të voglin që shiste aty tek fundi i rrugës, aty në oborr me një trastë plot çokollata. Djali, si i zënë në faj, i kishte thënë se, me t'i shitur, ai lekët vinte e ia kthente tetos së vet. Atë çast zoti Çeli kishte ndjerë vërtete një dhembshuri dhe respekt të pazakontë përfundit e tij. Edhe mirë i vinte, edhe keq që ajo po sillej në atë mënyrë me dhuratën e tij. I vinte mirë se pse edhe e shoqja, ndonse s'i kishte hyrë kurifarë gjembi në këmbë përfundit ekonomike, me sa dukej e kishte kuptuar fort bukur sistemin e ri që kishte përvijuar ai, familja e tij dhe tërë

shoqëria. Pra, paraja! I vinte keq sepse ajo zemra e tij, e shtrenjta, e ëmbla Sonilë s'po shijonte shijen e ëmbël e të mrekullueshme të "Doverit". Kështu që prej atij çasti e shtoi nga një "Dover" në dy.

-Albert, - thirri ai shokun e vet. Tjetri u afrua buzëgas e po ashtu pyeti:

-A i ke numëruar sa "Dover" i ke dhuruar Sonilës deri tanë?

- pyeti ai kot, duke qeshur.

-Ç'rëndësi ka, - u përgjegj buzëgas Çeli. -Çdo "Dover" fal dashuri, -ia ktheu me fjalët e asaj që reklamonte në TV çokollatën.

-Ky komisioni i fundit, ky, po, ky është komision!

-Të them të drejtën, -ia ktheu Çeli, -hezitova në fillim, por kur pashë se në të merrnin pjesë dy zotërinj tepër të nderuar të qytetit. -mos m'io kërko emrat se nuk t'i them, - vendosa vetëm nga inati i njerit prej tyre... Kam punuar me të, dikur edhe unë si tërë të rinjtë, mbaja fotografi artistësh. Isha tifoz i Sofie Lorenit. S'di se si m'u zbulua, por ai, pikërisht ai, pra njëri nga ata, më quajti revizionist!

Të dy ia dhanë gazit. Alberti vazhdoi:

-Martin, për nder, në komision si ky, filmi erotik do të ishte më mirë që anëtarët të ishin beqarë...

-Ti je beqar nga qejfi, -ia priti Martini.

Dhe kishte thënë një të vërtetë të padiskutueshme. Alberti nuk vuante nga sëmundja e Martinit. Atëhere, kur ai u emërua inxhinier në Institutin e Projekteve, kishte pasur një flirt me pastruesen e drejtorisë. Një jevgë e kolme, nja dyzetë vjeçë, që e bënte atë punë edhe për një kallëp sapuni, e jo të hezitonte para atij inxhinieri të ri, bukurosh e me forcë kau, që tundonte tërë vajzat përreth. Kështu që ajo, me të marrë një shenjë prej tij, s'priti më gjatë por iu hodhi vet e para. Jevga i kishte nja katër fëmijë, por e taksi që të pestin ta kishte me Albertin dhe ashtu bëri. Sot e gjithë ditën, prej vitesh, një fëmijë nja katër-pesë vjeç, flokëverdhë, breth lumnueshëm në lagjen periferike.

Martin Çeli i dha dorën kolegut të vet.

-Dhe i thuaj t'i hajë. -porositi.

-Pse, mos ka filluar të merret me tregëti Sonila?

-Jemi në sistemin e parasë, i dashur, -iu përgjegj me gëzim Martin Çili e doli jashtë.

Aty e prisin anëtarët e tjera të komisionit. Ishin ata të dy zotërinjë dhe një i tretë, një oficer i liruar nga reformat, të cilin e kishte caktuar vet kryetari i Bashkisë, pasi e kish hequr nga komisioni atë anëtaren femër. Ç'duan femrat në këto lloj

komisionesh? - i kishte thënë si inspektorit përkatës. Ky i ziu, duke u dridhur, i kishte thënë se s'ka asgjë të keqe. Atëhere ver tët shoqe ia kishte kthyer kryetari që ishte bërë pishman në çast, pasi iu kujtua se e shoqja e inspektorit përkatës s'kishte mbushur ende 40 ditë, që ishte ndarë nga kjo jetë. Kështu që kishte venë oficerin e liruar, jo vetëm nga që edhe diçka ekonomikisht e ndihmonte, por edhe për burrë korrekt e njihte.

Të katër u dërtuan për tek kinemaja Nr.7, ku do të shfaqej filmi erotik. Pañe e ç'nuk panë aty, por z.Çeli i mbeti në mënd ajo dashuria e atij amerikanit me atë sybajamen e Hong-Kongut. Ç'aventura! Ç'dhurata bëri amerikani për të, por ja, vinte nata dhe ajo mace, i vidxhej nga shtrati e shkonte e shkapërdhehej, duke u lëpirë në ca bodrume të errëta, me një kinez nja dy pëllëmbë, por siç pohonin gazetat e vendit, i shquar, madhështor për penisin e tij. Në fund të shfaqjes komisioni diskutoi. Më entuziasti ish ai zotëria që kish mbajtur qëndrim të repte dikur ndaj fotografisë së Sofia Lorenit. Ky është një film i mrekullueshëm, -tha ai. - Të shfaqet, - vijoi, -s'jemi në kohën e monizmit kur na kishte mbuluar fërexheja, kominoшet, e kur rinia kishte turp të shihte trupin e vet. Kot nuk e përmbysem atë-sistem. Ç'janë këto dokrra, -iu përgjegj zotëria tjetër, -përse u përbys ai sistem, për kofshët e asaj?... Të jetë për mua, -tha oficeri i liruar, - i pushkatoj fare ata palaço. Kë quani ju palaço? -ndërhyri ai kundërshtari i dikurshëm i Sofie Lorenit, -artistët? Artistët! - ia priti oficeri i liruar. Pse artistë i quan ata që të nxjerrin përpara syve jo vetëm prapanicën, por dhe t'i tundin allatet?

Zoti Çeli s'po merrte pjesë në diskutim. Ai, gati duke dremitur, solli ndër mend përsëri atë amerikanin, që e donte aq shumë atë sybajamen: Sepse i vajti mendja tek Sonila e tij. Ajo do të kishte rënë në gjumë tanë. Çokollatat patjetër do t'i kishte ngrënë. E kapi një dëshirë e ethshme të shkontakte pas saj, ta puthte, ta përqafonte e të shtrihej një me trupin lakuriq të saj. Diskutimi mbaroi dhe ai ashtu, me atë ndjenjë, me vrapt vajti në shtëpi. Ishte yrëtetë vonë: Hyri në dhomën e gjumit. Ndezi atë dritëzën tek koka e shtratit. S'ishte asgjë ajo sy bajamja e Hong-Kongut para Sonilës së tij. E ndërsa po kundronte bukurinë

përrallore të së shoqes, ju drodhën gjunjët prej lodhjes së ditës. U shtri dhe e zuri gjumi sa të numërojë deri në tre. Të nesërmen komisioni do të shikonte është film në kinema Nr.5. Zoti Çeli e bleu dhe dhuratën e zakonëshme për të shtrenjtën Sonilë. Po të mundoj, - ia tha Albertit.

-Përkundrazi, po marr pjesën time. Ja, sot në mëngjes ai çamaroku, nipi i Sonilës, më dha tërë këto lekë, - qeshi me të madhe, -për teton e vet. Po s'kam për t'ia dhënë të gjitha.

-Blija përsëri çokollata, blija përsëri "Dover".

-Të mbytet në dashuri, - qeshi tjetri dhe ndërrroi bisedë. - S'më tregove gjë për filmin e djeshëm?

-Të shohim edhe këtë sot, pastaj - dhe ai i la dy çokollata "Dover" në dorë dhe doli. Por atë ditë komisioni nuk pati mundësi të shihte filmin. Kinemaja Nr.5 ishte dhënë me qera për dasëm. Komisioni protestoi Madje i telefonuan edhe kryetarit të Bashkisë, i cili që nga ana tjetër e telit u përpooq t'i qetësonte, duke akuzuar mediokritetin e ditës ndaj kulturës botërore, por qetësimi i vërtetë u arrit kur komisionit iu premtua se përsa kohë kishte humbur, do të paguhej.

Zoti Çeli u kthyte më herët për në shtëpi atë ditë. Nga që ishte më i lirë, më i ngeshëm, ndjeu vapën përvëluese të ditës. Në oborrin e shtëpisë, çezma atje tek këndi, të fal freski. U hodhi një grusht ujë syve. U mat t'i therriste Sonilës, por ndërroi mendje. Me siguri vapa atë do ta ketë lodhur dhe ajo mund të jetë shtrirë. Ngjiti shkallët me kujdes dhe po me atë kujdes, hapi derën e dhomës së gjumit.

As aty s'kishte njeri, veç kuverta dhe çarçafi mbi krevat ishin kokolisur, sikur të kishin luajtur fëmijë. Pas pak u dëgjuai një e qeshur. Ishte e qeshura e Sonilës. Ai u afrua pranë dritarës dhe pa pikërisht atje tek çezma Sonilën, që kishte venë pëllëmbën tek rubineta dhe e hidhte ujin tutje nëpër oborr. Pastaj drejt çezmës vrapi një djalë. Z.Çeli e njohu. Ishte Alberti, që tanë po bënte ai veprimin që pat bërë më parë Sonila. Pra ata freskonin njeritjetrin me ujë dhe shkriheshin në gaz. Zoti Çeli u bë një me harenë e tyre dhe gati pavetëdije zuri të qeshë me zë në katin e dytë, po ky që një çast, vetëm një çast, pastaj ata të dy atje tek çezma

u përqafuan fort me njëri-tjetrin e zunë të shkëmbejnë të puthura plot afsh. Zoti Çeli e humbi, u hutua dhe, ashtu siç ishte me gjunjët që zunë t'i dridheshin, ra mbi komodinën që kish pranë vetes, duke tërhequr plot zhurmë sirtarin e saj, prej të cilit ranë dhe u shpërndanë në dysheme dhjetra çokollata "Dover".

## ZJARRI

**U**shtria që do të sulmonte Tokën e Diellit, priste vetëm urdhërin e Kryekomandantit. Vetë ky kishte thirrur shtabin ushtarak dhe atë çast iu drejtua gjeneralit që do të udhëhiqte atë betejë të lavdishme, të mërzitëshme, ndoshta dhe tepër të përgjëkëshme.

-Gjeneral, ju nuk keni qenë ndonjëherë atje. Shih ç' emër ka: Toka e Diellit. Dhe është vërtetë një emër i merituar. Vend më të bukur në botë zor se ka. Vetëm atje, vetëm atje, po ta përsëris, do të gjesh të rrinë kaq pranë, sa ç'kemi gishtarinjtë e dorës, fushën, malin dhe detin! Kjo është një mrekulli. Është një mrekulli e pashoqe e vet natyrës. Por, ndërsa natyra mbi atë vend është treguar kaq dorëlëshuar, kaq zemërgjerë, djalli, ky element tjeter, ky bashkëudhëtar i jetës, tek njerëzit e atij vendi ka bërë kërdinë, të duket dhe jo të duket, por është e saktë se ai, djalli atje në zemrat dhe mendjet e tyre, ka edhe djepin e lindjes, edhe shtratin e vdekjes. Ti, gjeneral, e di fort mirë se ne jemi përpjekur, dhe jo vetëm jemi përpjekur, që t'i trajtojmë ata ndryshe nga të tjerët. Disa prej asaj fare njerëzore kane arritur të bëhen ministra, kryeministra, papë.

perandorë e fundi i tyre ka qenë, siç ua ka përcaktuar ai djalli i tyre: o tradhëtarë, o kanë vrarë njëri-tjetrin! Jashtë asaj toke, me atë emër të mrekullueshëm, ata kanë lënë nam, kanë ngritur qytete, kanë krijuar shtete, kanë themeluar universitetë dhe shkencë që, sot, tërë njerëzimi merr jetë por, ama, në vendin e tyre, për ta s'ka pasur as dy pëllëmbë vend për varr. S'kemi lënë mjet e mënyrë që ata të hyjnë në hullitë e kësaj bote, madje edhe krushqitë i kemi perdonur. Ja, unë vet, gjeneral, gruan e dytë e kan nga ai lloj, por po të them se fëmijët e saj që janë edhe fëmijët e mi, ndonëse ende s'ia kanë mbushur 15 vjeç, janë gati që për një kokërr vezë të therin njëri-tjetrin. Prandaj shkurt dhe prerë: asnje fije mëshire, asnje fije tërheqjeje, zjarr, zjarr, vetem zjarr, që ta shpëtojmë botën prej atij çibani të qelbur!

Ditë më pas, ushtria e venë nën komandën e gjeneralit e të shtabit të tij, nisi marshimin drejt "Tokës së Diellit". Ushtri më të çutitëshme kurrë s'ishte parë deri atë kohë. Në përbërje të saj kish ushtarë nga të gjithë llojet e rracave, nga ta gjithë llojet e feve, por i tillë ishte dhe armatimi, i cili fillonte prej shigjetës e shpatës e mbaronte me armët më moderne të kohës. Në këtë shumllojshmëri njerëzish e armësh, s'ishte i llojshëm qëllimi; jo, ky ishte i njëjtë dhe për të gjithë si një rudhër i prerë: Zjarrin Tokës së Diellit! Për këtë qëllim, veç kundërshtarit kryesor dhe aleatëve të tij të ngushtë, ishin bashkuar edhe ushtri shtetesh që s'kishin të bënин për jetë të jetës me Tokën e Diellit., madje as në harta s'e gjenin dot, pra ishin bashkuar thjeshtë të nisur prej çudisë, se ë'na qenkësh ky vend që i bëkërke karhillëk një bote të tërë.

S'dihet sa zgjati ky marshim, kur një ditë prej ditësh udhërrëfyesit, njerëzit e rikonjucioneve, i thanë gjeneralit se tanë paskeshin mbritur në Tokën e Diellit. Kjo për të s'kishte qenë e vështirë për t'u kuptuar: ja deti një hap më tutje.., ja edhe fusha ku ai kishte dislokuar njerëzit dhe armët, ja edhe mali mbi kokë. Ndërsa ishte i befasuar prej kësaj mrekullie, ai s'mund të harronte detyrën dhe pyeti në se kishte apo jo forca mbrojtëse ky vend. Dikush i tha se ato qenë dhe ishin futur nën dhe e prit kur të dilnin si mizat. Dikush u shpreh se nga që është vjeshtë e ka qenë një stinë e mbarë për vendasit, udhëheqësit qofshin ata ushtarakë apo civilë, ishin zënë me zjerjen e rakisë apo me përgatitjen e verës. Një i tretë shtoi se të dy palët, civilët e ushtarakët, ua kishin mbathur, pra e kishin tradhëtar vendin. Megjithatë gjenerali urdhëroi për pushim, por porositi që sytë t'i mbanin hapur. Trupat, që do preheshin deri në

agim, do t'i ngrinte çadrat atje pranë pyllit buzëdetit; aty urdhëroi që t'ia ngrinin edhe tendën e vet, ja, atje nën ato pishat e mëdha. Dhe vetëm kur i raportuan se çdo gjë ishte gati, ai thirri kuadrot e shtabit dhe i porositi që, së pari, të bëhej kujdes me zjarrvénësit, që jo vetëm të ishin në gatishmëri, por dhe të dinin një më një detyrat, që flaka të përpinte gjithçka, edhe qiejt! Kjo punë të niste që me të zbardhur dhe zjarri të ndizej që nga këmbët e tyre e ashtu pëllëmbë për pëllëmbë të përfshinte tërë Tokën e Diellit. Kjo do të thoshte që të justifikoheshin jo vetëm shpenzimet e jashtzakonshme, por dhe shpresat e tërë vendeve pjesëmarrës me ushtarët e tyre në këtë mësymje përmbytëse mbi banorët e mallëkuar të kësaj hapësire të përndritur nga vet zoti. Tek u jepte këto porosi oficerëve madhorë të shtabit, ai kishte mirë paravsh se ushtritë e tij deri tanë ishin vërtëtë të suksesshme. Në tërë atë marshim të gjatë e të lodhshëm, trupat kishin ruajtur forcën e kompaktësinë e tyre, aq sa komandanti i prapavijave thoshte me mburrje se deri tanë s'na ka humbur qoftë edhe një brisk xhepi, qoftë edhe një kapele ushtari.

Me të mbetur vetëm, gjenerali mendoi të qetësohej paksa dhe se do t'i bënte mirë për këtë të shëtiste aty përreth. Doli tutje çadrës. Në çast iu bë se nga diku aty afër vinin ca tringëllima zilesh e këmborësh. U hodh dhe një hap më tutje dhe pa siluetat e dy barinjve vendës. Kërshëria, por edhe nuhatja prej ushtaraku, e nxitën të hidhte edhe disa hapa më tej, por kur pa se ata të dy, pasi u vërvshëllen 10-15 de leve të tyre po vinin drejt tij, vuri dorën në brez dhe priti. Ata folën të parët:

-Gjenerali, -tha ai më i moshuari. -E kini ngritur çadrën ligjsh. Atij vendi i themi Logu i Vetëtumave. A e di pse? Sepse aty edhe në korrik vetëtimat ta fikin jetën e jo më tanë që akoma nuk ka dalë vjeshta dhe vetëtimat mbijnë pikërisht këtu e i drejtohen qillit!

-Largoje çadrën prej aty. -tha më i riu dhe që të dy barinjtë bënë tutje, për andej nga patën ardhur.

Gjenerali pandehu se kish folur me fatnazmat. Një heshtje varri që sapo ra, ia përforcoi edhe më këtë mendim. U trondit tepër. Oguri i zi e mbajti të mbërthyer për minuta të tëra, deri sa më në fund, vendosi t'i bënte dredha atij. Nuk guxoi të shkonte në çadrën e vet dhe mirë bëri. Pas asaj nate, nën peshën e një gjumi të rëndë, plot bubullima në kokën e tij dhe në qill, ai pa ish çadrën e tij të kthyer në shkrumb e hi e, sikur të mos mjaftonte me kaq edhe njëra nga pishat, e djegur dhe e përzhitur, ishte shembur përdhe. Ndërkohë, zjarrvenësit, që u kishin shpëtar për mrekulli vetëtimave të natës.

tani edhe pse tē lagur deri nē palcë, pasi e kishin kaluar atë natë tē tmerrshme jashtë, po shkumonin zjarr nga goja, nga sytë dhe nga veshët. Ata mezi prisnin urhdrëin e gjeneralit, pér t'ia filluar dasmës së tyre, por çuditërisht ky nuk po ngutej, përkundrazi, tjetër gjë po mendonte. Jo, si oguri i mbrëmshëm nuk ishtë pjellë e fantazisë së tij. Ai tani po kujtonte me një qartësi tē tejdukëshme se ata që e paralajmëruan, se ata që nē fund tē fundit i shpëtuan jetën, ishin dy qenie tē gjalla. Ishin barinj vendës... me dhentë e me vërvshëllimet e tyre... Pikërisht ata i kishin shpëtuar jetën dhe ai, si njeri i uniformës, e kishte parim: e mira shpërblehet vetëm me të mirë!

Dërgoi njerëz pér t'i gjetur dy barinjtë dhe shpejtë tē dy shpëtimtarët e jetës së tij, ishin aty pranë. Ja, ai më i vjetri nē moshë dhe pranë tij edhe më i riu.

-Më shpëtuat jetën, -tha gjenerali, -dhe unë dua ta laj këtë borxh!

-Ne, ne s'kemi bërë asgjë, -tha më i moshuari.

-Ne, ja ashtu kot, kaluam këndej e shkëmbyem dy fjalë me ju, gjeneral, -tha më i riu.

-Në fund tē fundit, edhe ti, gjeneral, rob zoti je, - foli i moshuari.

Gjenerali sikur i mati me sy e iu drejtua:

-Unë kam vendosur t'ju shpërblej!

Ata tē dy vunë buzën nē gas.

-Do t'ju shpërblej e kjo s'ka diskutim, ja po e filloj me ty, - iu drejtua më tē moshuarit, -Pér çfarë ke nevojë ti?

Ai ngriti supet e buzëqeshi, pastaj çuditërisht tha:

-Pér asgjë!

Gjeneralin s'po e mbante vendi. Bëri ca ecejake kot më kot dhe nē një çast i foli po atij:

-Ku e ke shtëpinë ti?

Ai i tregoi me dy fjalë se ato dy kasollet, ose ato dy kolibet rrëzë kodrës, ishin shtëpitë e tyre, nëse edhe zotëria e tij i merrte pér shtëpi.

-Do tē ngresh një shtëpi dy katëshe, tē gurtë. Me tërë këtë forcë, me tërë këtë ushtri që kam unë, shtëpinë në drekë e ke gati... Po nuk na the pér çfarë tjetër ke nevojë?

Bariu i moshuar po kalonte nē një gjendje jermi. Ai kaq gjë e dinte se burrat, e veçmas burrat me uniformë, nuk e lëshojnë kurrë fjalën si lopa bajgën! Po ç'të kërkonte ai tjetër gjeneralit?! Pse pak

ishte tē jetonte nē shtëpi dykatëshe e tē gurtë?

-Asgjë më, -tha nën zë.

-Jo, -ia preu gjenerali. Kérko ç'të duash! - dhe kur vuri re se ai heshtte, vazhdoi vetë: -Sa dhen ke ti?

-Gjysmat, -iu përgjegj ai. -Gjysmat e tufës. 7 kokë.

-700 do tē kesh, -ia ktheu gjenerali. -Ç'më kushton mua kjo? Asgjë, veçse tē pakësoj disi racionin e mishit pér trupat e mia, që nuk i numëron dot.

Bariu i moshuar zuri tē hidhej përpjetë nga gëzimi.

-Po ti? - iu kthyë gjenerali tjetrit. Çfarë dësheron?

Dhe kur i.riu po bëhej gati tē përgjigjej, ai më i moshuari që po kércente, e ndërpreu kércimin dhe ia dha ulërimës.

-Ç'pate? -tha gjenerali tepër i alarmuar.

-Mos, mos! -tha ai që pak më parë po kércente e sakaq, u hodh tek këmbët e gjeneralit, duke i shtrënguar e puthur gjunjët.

-Mos, gjeneral, aman! Po i dhe edhe atij, merri edhe këto që m'i dhe mua. Nuk i dua!

Gjindja aty pérreth, së bashku me tē edhe gjenerali, ngriu nē vend. Zjarrvénësit dukeshin sikur flakën po e mbanin mbi pëllëmbët e duarve gati, mjaftron një shenjë dhe ndiznin dynjanë.

-Prisni! -iu drejtua gjenerali zjarrvénësve. -Prisni!

Një klithmë habie dhe një zhuzhimë deti përshkoi tërë atë ushtri tē madhe. Ç'po ndodhete! Për çudinë, habinë apo pér tē dyja bashkë gjenerali thirri:

-Misioni ynë mbaroi.

Një fërgëllimë armësh ngjethi tokën dhe qiellin. Gjenerali vazhdoi më i qetë:

-Këtu nuk është aspak i nevojshëm zjarri ynë. Këta e paskan zjarrin midis tyre.

... Dhe vërtetë ai zjarr ka vite, shekuj që djeg, nuk duket së largu, sepse është zjarr pa tym.

## **EMËR HARRUARI**

**I**shte koha kur dilnin ligje, ligje, aq shumë ligje sa as krahasimi si kërpudhat mbas shiut nuk është aspak i saktë, madje as i përafërt jo. Ai parlament, në këtë kuptim, bëri vërtetë epokë. Jo më kot udhëheqësit e tij, kur vinte radha pér të evidentuar kryevlerat e asaj legislature, kryeaftësi nxjerrjen e ligjeve quante. Vendi linte pas një epokë disa dekadash, ku ligji, një gjë aq e thjeshtë dhe aq e domosdoshme, krahasohej thjeshtë mballomë, këpucë e vjetër, që bezdiste urdhërin, komandën, vet Njëshin! Ja, pra, pse lindnin ligje çdo javë, çdo ditë, çdo orë. Disa merrnin rrugën e mundimshme të zbatimit, disa ktheshin pér t'u riparë, ende pa kaluar rrithinat e kryqytetit e disa vdisnin para se të lindnin. Kjo shkaktonte një marramendje të madhe, hutim tek njerezit. Natyrisht më të ndjeshëm ishin studentët e juridikut, ata ishin të sigurtë se tezat e provimeve të ardhme do të ishin më të rëndë, gjyqtarët gjithashitu, shumë prej tyre po e mallkonin profesionin, pasi tani u duhej të bënin një shkollë të dytë, por në këtë mes dukej hapur që avokatët ishin vërtetë të lumtur jo rastësisht disa prej tyre, që e

filluan këtë profesion në ca zyra mizerje, ku as xham në dritare nuk kishin, zunë shumë shpejtë të ndërtojnë ca kjoska, përfundimisht perëndimore, të mbuluara me tulla të kuqe gjermane e të rrrethuara me xama xais. Pushtetarët poshtë, nëpër komuna, bashki a prefektura, pak a shumë, ishin po në atë gjendje si avokatët, natyrisht me ca ndryshime të vogla. Ndersa ata, ruajtësit besnikë, mbrojtës të së drejtës së njeriut, por edhe tahmaqarë parash, ligjin e kthenin në lëmsh, ose kur ishte lëmsh e ngatërronin më keq, ata pushtetarët poshtë tregoheshin më të zellshëm, më të devotshëm, veç lodheshin tepër shpejt: ky heroizëm i tyre nuk zgjaste më tepër se sa ora 10° e orarit zyrtar, ku pasi i kishin qorollepsur e dendur me ca shpresa të kota qytetarët hallexhinj, përfundonin në ato klubet në katin përdhesë të institucionit të tyre, ose disa metra më tutje, në bar-restorantet, ku kërciste kofsha e pulës. E pastaj veç t'i shihje kur ktheheshin aty në prag të mbarimit të tetëorëshit, hundëkuqë, gojëshqyer, me kutërbimin e erës së fernetës, të rakisë, të birrës a të të gjithave bashkë. Në morinë e këtyre njerëzve që përballeshin me ligjin, që e interpretionin dhe e zbatonin atë, kishte edhe nëpunës të vërtetë, të devotshëm dhe të aftë. Një ndër ta ishte edhe "kompetenti". Kështu e thërrisin të gjithë. Pagëzimi që i kishte bëré shoqëria, vet koha, ia kish çuar në harrim emrin e tij të lindjes, që në fund të fundit, ç'thoshte ai emër? Gjë e rëndomtë, dëshira e njerit prej prindërve. Dhe ai shkrihej nga kënaqësia, gëlonë si det gjëzimi kur e thërrisin ashtu. E thërriste Prefekti, Kryetari i Bashkisë, pa le ata mediokrit e komunave, ishin gati ta quanin gjeni. Ai vet vinte nga fonderitë e gizës, s'dihej dhe s'mund ta përcaktoje dot cila forcë politike ia kish dhruar atë kolltuk, pasi prej saj s'kishte mbetur asnjë shenjë, asnjë ngjyrë, nga që kompetenti i ndrronte ato, pra partitë, më shpesh se sa të mbathurat. Vartësit e tij rrinin pranë penës së tij, si dhentë në mërzim. Thoshte një fjalë ai: neni kaq, i ligjit kaq, ose ligji X, pika 11 dhe ata të zeztë turreshin të sqaronin qytetarët, të kupto hemi deri sa të vinte ajo ora e shenjtë: 10, ora e piyeve dhe kofshës së pulës! Eprorët e dëgjonin me vemendje, a thua ishte vet ky, ligjbërësi dhe në çdo kohë kërkonin ndihmën e tij, edhe pse gazetat zyrtare, me pompozitet, si tulla mbi tullë, ata vet i mbanin mbi tavolina. Ky opinion i madhërishëm që ekzistonte për të, nuk mund të pranohej në mënyrë absolute nga të gjithë. Kishte dhe ca, që po i quajmë gojë të liga, të cilat e etiketonin simkokëbosh, fjalamani, se kishte mbetur po ai fonditori dështak. Veç gojët e liga, gojë të liga mbeten! Ato nuk mund të errësonin

aspak reklamën e sukseseve të tij, që bëri televizori një javë rresht, ku shumëkush doli në përfundimin se është fatkeqësi e madhe që tipa si "kompetenti" ynë nuk shkojnë direkt në ndihmë të ekipit të Kryeministrat, por tresin intelektin me këta druvarët e bazës. Nën këtë trysni ishte qytetari X, bashkëqytetar i "kompetentit" që për 40 vjet rresht, zbrit këtu 12-13 vjet të fëmijërisë, pra për 27 vjet kishte qenë luftëtar dhe mbrojtës i shkëlqyer i ekonomisë socialiste, tani së fundi, me qenë se deti u bë kos, po kërkonte edhe ai tasin me kos që i takonte. Kur hyri tek "kompetenti" ishte ora 11° dhe jo pa qëllim zgjodhi këtë orë. Pra ai s'ishte si ata idhtarët e orës 10° me të cilët qytetari X kishte paguar, siç shprehej vetë, qimet e kokës! Ky ishte nëpunës së mbari. Ja, veç ta shikoje: i freskët, i pashëm e i vemendshëm. E dëgjoi qytetarin X me vemendje dhe i rekomandoi të gjente ligjin 77, 777, që do t'i hapte horizont dhe do t'i krijonte mundësinë që të plotësonte kërkesat dhe pretendimet që vet qytetari po prezantonte. Falenderoi "kompetentin" dhe iku. Të nesërmën e tutje, qytetari X u bë një nga lexuesit dhe studiuesit më të zellshëm të bibliotekës dhe s'kishte qenë aty qysh nja dy muaj para se të shkonte ushtar, me qëllim që të mësonte ca këngë rreshtore se i kishin thënë do të turpërohej atje në rresht, kur dhe djem fshati prej malësive të thella, dinin vargjet dhe meloditë e tyre. Sipas Illogarive të tij, i dilte mbi 20 vjet pa shkuar aty. Hyri në sallë duke mbajtur nën sisetulla e djathtë dhjetra gazeta zyrtare, me qëllim që të gjente sa më parë ligjin 77, 777 ... Kishte qenë një gjë magjepsëse leximi i i atyre gazetave zyrtare, e sidomos faqet ku ishin hedhur moria e ligjeve të reja, madje, në shumë raste, kur mundtë të kuptonte përbajtjen e tyre, gëzohej si fëmijë dhe niste e bënte monolog me veten e vet. Eh, luftëtari i ekonomisë së përbashkët, si pa u ndjerë, po kthehej në një kundërshtar i rreptë i saj. Se ajo kokë e mbushur me dogmën e lirisë "kolektive" e "interesit të përgjithshëm mbi atë vetiak" paskësh qëndruar edhe vet si e tepërt mbi supe. Ky njeri i aparatit të sistemit të vjetër, jo vetëm që preu çdo lidhje qoftë edhe mostalgjia me të, por duke mbetur disi një hapësirë vakum në ndërgjegjen e tij, tashmë nën moton: individi, e drejta dhe liria e tij mbi të gjitha, -po e kalonte edhe këtu masën. Zuri të kërkojë biografinë e vet, deri tek katragjyshi, kështu që iu desh të përkthente prej osmanishtes tërë tapitë e fisit, për të dalë ballëlartë në kohën e re dhe natyrisht i armatosur pak në teori, por i dokumentuar i pasur! Ky mund, kjo përpjekje atij i kushtoi gati 6 muaj dhe pikërisht aty nga fundi, gjeti dhe ligjin që i pat rekomanduar "kompetenti". E

lexoi dhe e rilexoi me dhjetra herë. Ishte po ai ligj, pra, po si numër, veçse përbajtja e tij s'kishte asgjë të përbashkët me problemin e vet. A mund të kishte gabuar "kompetenti"? Kurre... Vetëm ai njeri nuk mund të gabonte. Po si, si ta shpjegon bte qytetari X?! Të vinte e ta takonte vet dhe as më shumë e as më pak, përzgjodhi përsëri orën 11<sup>11</sup>. Nuk i kishte harruar ai ata birbot e orës 10<sup>12</sup>. Trokiti në derën e zyrës, e pastaj kur përgjigja vonoi, hapi paksa derën. Urdhëroni, -dëgjoi një zë femre. Ishte sekretaria e "kompetentit" që i tha se ai nuk ndodhej aty. Qytetari X i vajti mendja për keq. Mos vallë dhe "kompetenti" ishte katandisur si të tjerët?!

-Jo, jo, -i tha sekretaria, - ju mund ta takoni atë vetëm në mëngjes, se pastaj, pastaj...

-Çfarë? -u tremb qytetari X, edhe ai tek gotat, tek kofshat e pulës?

Ajo sepse qeshi. Ai s'ka kohjë për atje. Ai tani ka fabrikën e vet dhe ka shumë punë.

-Fabrikën e vet? -tha nën buzë qytetari X dhe pasi u informua se ku e kishte "kompetenti" fabrikën e tij, u nis për atje.

Nuk u mundua shumë. Aty tek hytrja, ai prezantoi identitetin e vet dhe priti. Sa kaq u pa "kompetenti" që po vinte drejt tepër i habitur.

-Nuk më mban mend? -tha qytetari X.

-Natyrisht.

-Natyrisht, -përsëriti tjetri. -Si mund të më mbani mend? Kam ardhur para 6 muajsh tek ju dhe juve...

Tjetri ia futi një të fërshëllyeri si të trempte lopët.

-E pastaj, -tha.

-Unë ligjin 77.777 e gjeta...

-E gjetët? - qeshi ai.

-E gjeta, por është në kundërshtim me përbajtjen që ..

Kompetenti i bëri shenjë që të heshtte e duke qeshur i tha

-Gjysma e së keqes.

-Si? -u çudit qytetari.

-Si? Ca të tjerë nuk gjejnë as numrin, as përbajtjen Ti nuk qenke fare pa fat. -i ra supeve sikur t' i thoshte: "E tanë shko, kolopuci im"!

## ERË PLEHRASH

**Q**ytni ynë i vogël, tepér i vogël, futur mes malesh, anës një lumi-përrua, që tërë stinën e nxehtë kthehej në një mal plehrash erëmbytës, e kishte të tepërt të mbante mbi vete çizmen e një kapiteni e jo të gjeneralit, siç i pëlqente ta quante veten ai. Gjenerali ishte një hollak i sertë, me hundë të kuqe, që siç thoshin, rruhej dy herë në ditë dhe mbante pasqyrë xhepi me vete, por pikë më e dobët e tij, ishin çizmet, të cilat po t'ia lejonte rregullorja, do t'i mbante edhe tani në mes të korrikut, megjithse askush s'e përjashtonte mundësinë se i mbante netëve të shërbimit. Vendi më i preferuar i tij ishte pjaca, kafeneja e Rozës dhe jo se bëhej kot pas dorës së saj.. jo. s'ishte qejfli kafeje ai, por për zmabakun e pronares sytë xixa i lëshonin. Këtu plotësonte dhe një dëshirë tjetër: karshillëku i tij, tashmë tepér i dukshëm, u përplasej bashkqytetarëve të vet, të njojur e të panjohur të cilët në një farë mënyre, disa syrësh, patën kontribuar në emërimin e tij në atë post. Por kjo i takonte të kaluarës. Tani ai u thoshte atyre se nuk jam më ai muratori i papërfillshëm, por jam ndër burrat më të zot, më të pasur-vërtetë rrugën s'e kishte të vogël.

-më të bukur- këtë pohim edhe vet e bëri me frikë, me dyshim në fillim, por prej kohësh besonte se padyshim ishte edhe i atillë. Për sa kohë që gjenerali rrekej pas filxhanit të kafesë dhe vështrimeve shigjetë të drejt gjoksit të zbuluar të pronares, kundërshtarët e tij dhe këta më të shumtët ishin të rinj, fironin nga kafeneja dhe tërë pjaca. Më të guximshit shëtisnin atje tutje dhe ai i numëronte si kokrra misri, duke u caktuar me mend radhën kur do t'i binin në dorë për të provuar atë shpikjen e bekuar të perëndimit, shkopin e gomës, siç pohonte me krenari.

Por fare papritur ai u zhduk disa ditë. U shfaq përsëri e përsëri nuk u pa. Shpértheu me fuqinë e një ere marremndëse lajmi se gjeneralist po i vinte fundi, se para tij ishte vënë alternativa o të pranonte transferimin, o lirimin. Gëzim i madh në pjacë. Të rintjtë u sulën plot gëzim tek kafeneja e Rozës. Humori dhe shpotitë bridhnin lartë e poshtë. A thua se qyteti s'po e ndjente më atë erën e keqe që vinte prej malit të plehrave buzë lumi- përrua e s'po ngopej me ajrin e pastër. Tek vendi i preferuar i gjeneralistit u shty tavolina më tutje dhe u vu një saksi e madhe me një goxha luleshqiponjë mbi vete. Kur e pa se makina e tij voziste vetëmpërvetëm me shoferin, lajmi i përhapur, mori trajtat e faktit e sidomos kur Roza, në prani të të gjithëve, e quajti shoferin e gjeneralistit zagar dhe ai nuk e ndie fare, por mori paketën e cigareve e doli jashtë, s'kishte më asnë fije dyshimi se gjeneralist ia ngritën patavrat. U rrit së tepërmë besimi i qytetarëve ndaj shoqatave dhe organizatave të ndryshme për tek të cilat ata kishin dërguar dhjetra ankesa e peticione, bile dhe raporte mjekësore, ku denonconin hakmarrjen e gjeneralistit ndaj qytetarëve të lirë. Shumica këtë meritë ia astribuonte Shoqatës së të Drejtave të Njeriut, nga që ajo drejtohej prej atij specialistit të PT, një mediokër, por që e quante veten mysliman të madh dhe pretendonte se e njihte kuranin me rrënje e degë, kur e mbante vetëm si stoli nën sjetull. Por kjo gjëndje e hareshme, e lirë, siç lindi papritur, po ashtu u fashit. Qyteti përsëri sikur zuri të ndjejë erën e plehrave, ndërsa ajo luleshqiponja atje tek lokalit i Rozës, s'dihej në ç'qoshe kishte përfunduar. Përsëri u vendos tavolina, karrikja, duke krijuar prapë mjedisin e vjetër dhe, në qendër të tij, mbi përsëri, ai, gjenerali, këtë radhë më spitullaq, me një kostum të zi, të prerë bukur, me atë radion dhënëse e marrëse që e mbante tërë ditën pranë gojës, sikur e lëpinte, por po atë çast e kishte vënë mbi tavolinë, me foni të ngritur tepër, që tërhiqte vëmëndjen e njerëzve jo vetëm aty pranë, por edhe të makinave që kalonin rastësisht. I bëri nja dy-tri shenja

Rozës, që, edhe pse dihej fort mirë përbajtja e tyre, për nga forma dukej sikur i thoshin ta paraqitej pranë tij, në mundësi dhe me hap rreshtor, por Roza që me siguri ia kishte pirë lëngun jo që s'ia vërvshëlleu, por i ngriti lart gishtin e madh, sikur t'i thosh: Hip këtu të shikosh Stambollin! Jo më kot ishte krijuar mendimi se Roza ishte ndër të rrallat, ndër njerëzit e zakonshëm, pa poste e funksione, që mund t'i kundërvihet atij, kjo falë natyrës së saj të lirë e të guximëshme, por dhe faktit tjetër që asaj i punonte i shoqi në Bashki dhe ish e mirënjosur shoqëria e tij me Kryetarin e Bashkisë, që veç lidhjes epror-vartës, i bashkonte edhe një hall i përbashkët, të dy vuanin nga prostati.

Të rintjtë, që padyshim ishim më entuziasztët për largimin e gjeneralit, pasi në mes tyre shumë ishin ata që e kishin provuar mbi kurriz atë shpikjen e famëshme të Perëndimit, shumë ishin edhe ata që e kishin provuar edhe majën e çizmeve Ilustrafine të tij, u mbërthyen prej një pesimizmi të pasembullt. Era e rëndë, e keqe që vinte prej bregut të lumit përrua, pushtoi përsëri hapësirën. Për netë me radhë ata nuk u panë as në pjacë, as tek kafja e Rozës. Ai ishte aty, madje më i egërsuar. Vet Roza pohonte se natën vonë kur ajo mbyllte lokalin, dikush e ndiqte nga pas deri prapa shtëpisë së vet, nuk kishte mundur të dallonte, por nisur prej tërsëllimës së çizmeve, patjetër që do të kish qenë ai. Pas këtij pohimi i shoqi i saj u thirr prej gjeneralit në zyrë. Kjo i çuditit të tërë. Pse vepronë ai kështu? Mos vallë kërkonte të gjente një formë për të thyer Rozën? Po a mund ta arrinte ai këtë! Pak kush e besoi, megjithatë grupi i djemve ngarkoi flokverdhin, atë basketballistik gjatë, i njohur prej tyre si dashnor publik i saj, të merrte vesh ç'ishte kurdisur. Ajo u tha se "ai i kishte kërkuar tim shoqi që unë t'i bëja një listë me emrat e atyre që ishin më të interesuar për largimin e tij. E kishte kërcënuar, vërtetë burrit tim i kishte shpëtuar shurra në karrike, se ti e di që ai është i sëmurë, por atë propozim të ndyrë s'ia kishte pranuar, madje kishte thënë, që edhe unë u çudita, se për largimin tënd do të kërkoj edhe unë në Këshillin Bashkiak. Kjo do të ishte fitore për ne, në se e bën burri yt këtë, atëhere unë... Do të hiqje dorë prej meje - e kishte ndërprerë Roza dhe aty për aty ia kishte puthur buzet plot pasion, pastaj pa pikë turpi, më erdhi së bashku me tim shoq në lokal, vazhdoi ajo. Me të ikur burri, a e di ç'më tha gjenerali? -shpërtheu Roza. Dua të bëj dashuri me ty, më tha. Kjo dihet nga të gjithë, tha flokëverdhë, por s'dihet kjo tjetra ama, ia preu ajo, dua të bëj dashuri, më tha dhe kam gjetur vendin, atje buzë lumit- përrua. Po pse atje?

Pse pikërisht atje? Sepse derri në pleh e ndjen rehatin, shpërtheu ajo. Në se më tradhëton unë do të të var atje tek shtylla në pjacë, tha flokverdhi. Unë më mirë shkoj me një qen, se sa me të, tha ajo. E tani shko e u thuaj çunave që tash e tutje kemi dhe Bashkinë me vete. E vërteta është se ky lajm qe qetësues i plotfuqishëm për ta dhe në darkë, aty tek kafeneja e Rozës, djemtë vërvshuan të gjithë dhe në mes tyre ai syzja që para nja dy ditësh e kishte ngrënë një shkop në stadium, se bëri shaka duke përmendur emrin e njërit nga liderët e partive në pushtet. Pra, po ky u ngrit e ligjëroi ca vargje tip-parodi për gjeneralin. Nja dy ditë më pas, syzja u thirr nga i plotfuqishmi i lagjes dhe u gjobit për vargjet e publikuar, para se të shihnin dritën e botimit, të cilat padyshim binin në kundërshtim me moralin e ri të shoqërisë. Fakti që u përdor gjoba, kur kishim të bënim me një atakim direkt me gjeneralin, u mor si shenjë dobësie, por ai s'ishte më ai i dikrushmi. Dhe për netë me radhë ai nuk u pa tek vendi i preferuar për të. Dikush propozoi përsëri të vendoset prapë luleshqiponja, por këtë radhë ajo që kundërshtoi me forcë, ishte Roza. Dhe mirë bëri, sikur ta dinte, në mbrëmje ai mbiu përsëri aty, duke lënë t'i dukej aqik gryka e kobures dhe një pâlë pranga që të tmerronin më tepër se e para, varur në anën e majtë. Të gjithë që e panë, të gjithë ata që ishin përfshirë në idenë e largimit të gjeneralit nga qyteti, mbetën të shokuar. Mos vallë ky njeri po luante me qytetin dhe me tërë qytetarët jojën e maces me miun? Mos vallë vet ai ishte përhapësi i asaj thashetheme dhe këtë e bënte me qëllim që të peshkonte ata që do të tregoheshin më entuziazztët, pra kundërshtarët që mezi prisnin ta qëronin prej atij qyteti. Dhe s'ishte pa sukses në këtë veprim. Të mos shkojmë larg, por vetëm atë mëngjes, kur flokëverdhi, falë adhurimit, reputacionit sportiv në atë qytet, se prej një polici të parëndësishëm gati e hëngri shkopin e gomës. Shkurt mund të lëvizte kalaja atje në kodër të qytetit, por gjenerali kurrë. Këtë përfundim, këtë gjëndje shpirtërore e ndërrroi si me shkopin magjik Roza. Roza, vetëm ajo, pikërisht një dëshmi e saj, një e dhënë e saj, inspiroi të rinj e të vjetër. Bashkia jo vetëm që do të përkrahte ankesat dhe peticionet, madje ajo kishte avancuar. Kishte përcaktuar edhe kandidatin që do të zëvëndësonë gjeneralin. Ishte ai, kryetari i Shoqatës së të Drejtave të Njeriut. Specialisti i PT. Po ç'ne ai?! Ai s'kishte as shkollë, as dreq. Po pse, mos kishte pasur gjenerali, apo kishte pasur ai para gjeneralit?! Ja, pra, që paskësh qenë thënë që ky vend edhe pse numëronte tashmë 6 Universitete, prapë se prapë të mos shpëtonte prej këtyre hajvanëve! Megjithatë askush s'e

vriste mendjen për këtë. Mjafton që ai të largohej, pa ç'i... të ëmën! Roza, si për të qënë plotësisht e besueshme, përcaktoi edhe afatin; fundi i muajit, ishte edhe fundi i gjeneralit! Për ditë të tëra ai s'u pa tek lokal. Disa djem, edhe pse kundër dëshirës së Rozës, e vunë që e vunë luleshqiponjën tek ai vend, ku krekozej gjenerali. Shumëkush zuri të numërojë ditët me gishtat e dorës. Por çdo gjë mori fund më shpejtë se sa pritej. Një mbrëmje vonë, syzja, pasi u nda nga shokët, i dëndur rëndshëm me birrë, shkoi anës lumit-përrua për të urinuar pikërisht aty ku plehrat qelbnin keqas. Dy hapa larg tij, dikush rënkonte a shfrynte, s'mund të përcaktohej. Ai bëri më tej dhe krejt papritur iu përplasën syzet me një palë çizme, me dy këmbë të futura në to dhe dalëngadalë, miopi shquajti një trup burri hedhur mbi një trup tjetër. Edhe pak përpjekje dhe ai dalloi qartë gjeneralin. Po, ai ishte. Gjenerali na paskesh qenë edhe homo! Ja, këtë askush s'e dintë. Por edhe syzja kot e krijoi atë mendim. S'kaloi shumë dhe gjenerali u shkëput nga trupi tjetër dhe tepër i lodhur, i këputur, ra me kurriz në një arkë amballazhi plot mbeturina. Atëhere syzja dalloi edhe atë që pak më parë ishte nën gjeneralin. Ishte Roza. Ajo u ngrit, bëri sikur u shkund, e në çast u hodh, duke kakarisur mbi gjoksin e gjeneralit, me vithet për nga syzja, që iu dukën të shkretit, si një pjepër i ndarë më dysh!

## **VAJZA ME KOKËN MËNJANË**

**S**tudenti i arteve, Gent Olta mundi t'i jepte një të puthur të shpejtë të dashurës së tij Paulës, aty tek këndi i Disko-Klub "Tre diej". Bëri dy-tre hapa e pastaj u kthye sikur të kishte harruar diçka. I kapi njërën dorë vajzës, ia mbajti për një çast mbi të vetën dhe i la asaj një 30 dollarëshe aty mbi pëllëmbë. Paula nguroi disi, por kur u sigurua se ai kishte në xhep lekë jo vetëm për të paguar biletën e udhëtimit me tren, por edhe më tepër, zgjati paksa buzët e saja të lyera me një të kuqe të lehtë, i ceku me të tijat dhe u shkëput po aq shpejt. Genti priti sa rreshti lumi i makinave në bulevardin e madh e, me t'u ndezur semafori jeshil, vrapi me të shpejt për matanë. Aty kërkoi edhe një herë me sy të dashurën e tij, por ishte e pamundur. Atje për ku vështronte ai, ishte një grup i tërë vajzash që të mbërthyera prej haresë dhe asaj buzëmbrëmje pranverore, po hynin tërë gëzim në diskon "Tre diej". Do të kalonte disa orë të mrekullueshme me Paulën, aty, nën tingujt e muzikës dhe me pak kampari do të ndihej tërësisht i lumtur, larg monotonisë së ditës me ato leksione pak arkaike e pak moderne. Pastaj, rreth

mesnatës ai do ta parcillte të dashurën deri tek shkallët e apartamentit të saj. E pikërisht aty, si të thuash, do të zhvillohej prologu i ditës. Midis puthjeve, përqafimeve dhe nxitimit të saj për të ngjitur shkallët, ishte një tjetër çast i pakrashaueshëm. Dhe ai priste aty deri sa vajza të vinte çelësin në derën e apartamentit të vet, pastaj largohej. Por shpesh ai qëndronte edhe më gjatë. Qëndronte vetëm dhe përfytyronte atë, tashmë brenda në shtëpi, duke ecur në majë të gishtinjve, për në dhomën e vet. Kur ajo zhvishej dhe ashtu lehtë-lehtë shtrihej mbi shtratin e saj... Ah, ai kurrë s'kishte qenë kaq afër, kaq pranë saj! Natyrisht që disa herë ia kish kërkuar Paulës këtë mundësi, por ajo si duke qeshur i bënte shenjë sikur të trembte një pulë, duke vënë mbi buzët e tij gishtin tregues e duke i mërmëritur me përkëdheli: "është ende herët, fshatarthi im". Ai s'ia merrte për keq kur ajo e quante "fshatarthi im", madje s'gjente kurfarë arësyte ta merrte përfyuerje, kur vet ajo, vetëm për këtë muaj njojhe, mund t'i kishte dhënë qindra e qindra puthje e përqafime, ndërsa i jepte edhe të drejtë, në fund të fundit, qyteti i tij, atje në Jug, para qytetit të saj që shpejt po merrte përmasat e një metropoli të vërtetë, s'ishte gjë tjetër veçse një qyteth!

Sot ai s'mund ta provonte këtë kënaqësi. Në mëngjes kishte marrë një telegram urgjent, nga që nëna e tij ishte tepër e sëmurë. Atij, kur i ra telegrami në dorë, veç shqetësimit që i ngjalli, i erdhi turp edhe nga vetja. Kish tre muaj që s'kishte bërë qoftë edhe një telegram me të ëmën, madje për një çast mendoi se ai e kishte harruar fare atë. Dhe kë? Nënën e vet! Atë nënë që, tërë kujdesi e mundi i saj bëhej vetëm për hir të tij. Padyshim, mund të thuhej se ai, mes shokëve ishte për punë paresh, më xhepshpuari, natyrisht nga që kishte. E ëma, pronare e një lokal-bar në qendër dhe në krahasim me shoqet e saj i shkonte tregëtia më mbroth. Kjo ndihmë e pakursyer e të ëmës, ky lek, e dallonte atë, djalin e saj, studentin e arteve Gent Olta, të vishej më bukur, të ushqehenj më mirë, dhe të vinte në jetë një nga parimet e pashkruara të jetës studentore: të kishte një të dashur! Në se dy të parat: lekun, të dashurën i kishte tashmë të siguruara, ai po synonte për më tepër. Nuk donte të mendonte vetëm për këto katër vjet, jo ai donte të mbetej qytetar i përjetshëm i këtij metropoli fantastik, që veç të tjerave, i kishte dhuruar një të dashur si Paula, një yll të vërtetë bukurie, por që ta përballoje këtë të ardhme, atij i nevoitej një mik i fortë. Këtë, hë për hë, ai s'po e realizonte dot, veç shpresa e mbante vazhdimisht. Kishte vendosur të udhëtonte me tren, thjeshtë për të qenë më i sigurtë, thjeshtë për

të mos rënë pre e shoferëve provokues të takutive. Treni nisej në orën 20, kështu që ai mendoi të darkonte dhe njëherazi të vriste edhe ato dy orë që i mbeteshin. Zgjodhi barin luksoz në të djathë të bulevardit. Bar "Hëna" tepëqr i preferuar për bosët e artit, natyrisht për nga talenti se sa për nga pasuria. Një lokal tepër ambicioz, sidomos për romantikët e të gjithë moshave. Me një intimitet që të grishte sa hapej dera, por dhe me një të panjohur të madhe për Gent Oltën, për katin e dytë ku mbizotëronte një e kuqe për nga kafja e errët. Ku Genti më parë s'kishte guxuar të ngjiste qoftë dhe një shkallë për atje. Të tjerë ishin ata që frekuentonin atë kat, disa prej tyre ai i njihte qoftë dhe si fytyrë e si emër dhe vet shpesh, në se dikur Paula do të pranonte atë kërkесën e tij, që refuzohej prej saj me përkëdheli : është ende herët "fshatarhi im"!, në se realizohej ajo, ai atje, në atë kat misterioz do të kalonte orë të lumtura me të.

Zuri një vend aty pranë banakut. Sakaq u dha aty vajza që shërbente, një kamariere tepër korrekte, veshur me një rozë të ëmbël, e cila lëshoi vetëm një buzëqeshje dhe aq, priti sa mori porosinë dhe u largua.

Pas pak Gent Olta zuri të përtypite karkalecin e detit që iu servir, të rrëkellente gotën e verës. Herë pas here shikonte orën. Meraku për nënën po e ngacmonte më tepër e gjithnjë ndjenja e fajit që për muaj me radhë s'ishte kujtuar për të, po e bezdiste së tepërmë, madje i dukej sikur këtë akt të ndyrë, të tjerët në lokal po ia lexonin hapur. Vendosi t'i largohej këtij shqetësimi dhe ashtu, duke përtypur, duke rrëkellyer gotën e verës, vështroi si me urdhër rreth e qark. Ja, dytri tavolina më tutje shumë prej klientëve, ose të rastësishëm sepse qëndronin. Shkëmbenin ndonjë përshtëdetje dhe largoheshin tepër të kënaqur. Kush ishte aty? Ai u ngrit paksa dhe dalloi superstarin e sk nës së viteve të fundit: Albert Sina. Ja, ai, ai me ata flokë të zes, me atë mjekrën e prurë bukur dhe me sytë zhbirues si të Franko Neros. Albert Sina ishte idhulli i studentëve e se mos vetëm i tyre. Ja, në atë çast dy zonja, të shkuara në moshë, por nga ato që kërkojnë t'i sfidojnë vitet, po fluturonin prej kënaqësisë që u jepte biseda me të. Pas pak një çift i kërkoi autograf atij dhe ai, jo vetëm që ua plotësoi menjëherë, por vajzës i dha një të puthur në ballë, që aty, në sy të të tjerëve, e fisnikëroi akoma më tepër Albert Sinën. Dy fëmijë nja dhjetë vjeç, u shkëputën nga tavolina e prindërye të vet dhe shpejtuan drejt tij: ky me një lirshmëri të habitëshme i qfoi dhe në çast i hodhi mbi gjunjët e vet. Xhaxhi Alberti, xhaxhi Alberti! - kukurinin fëmijët, por doli që gjithë salsa u përfshi nga kjo thirrje

e shoqëruar me duartrokitje të lehta: atëhere ai, si në një spektakël real, u ngrit e zuri t'i përshëndeste. Tani ai dukej vërtetë i plot: si fizik dhe si shpirt, ai vërtetësish po interpretonte. I kishte kaluar të 50-tat por bukuria dhe freskia e tij injoronte kur të duash edhe lulen e rinasë. Gjeni, ja gjeniu! -mërmëriti Gent Olta. I bëri shenjë kamarijes dhe i tha asaj t'i conte artistit të madh një shishe verë spanjolle, që, për nga çmimi, e bëri kamarieren e shkretë të hutohej. Megjithatë, ajo për atë punë ishte aty dhe ashtu bëri. Prej tavolinës së Albert Sinës erdhi një urim anglisht. Sa do donte djali të ftohej atje. Po kjo paskësh qenë e pamundur. Me siguri Albert Sina dikë priste atje i vetëm, ndonëse i rrëthuar fund e krye nga adhurimi. Djali ia ktheu urimin duke e shoqëruar menjë buzëqeshje sa më të zgjatur, sa më të këndëshme, me qëllim që të mund të fiksohej tek ai tjetri, e, ku i dihej, ndoshta pikërisht ai mund të ishte miku që ta ndihmonte për të realizuar një herë e mirë qëllimin e tij, pikërisht ai që ishte në majë të metropolit, s'do ta kishte asp-ak të vështirë për t'i dhënë jo krahun, por gishtin, gishtin këtij djali të atij qytethi të jugut. Madje, aty për aty Gent Olta kujtoi se ai po e ftonte dhe zemra gati i luajti nga vendi, por jo qe vetëm marramendje, vetëm një lajthitetje. Albert Sina ishë ngritur në këmbë e tërë mirësjellje po takonte dy vajza, të cilat edhe pse ishin me shpinë nga djali, dukeshin të mrekullueshme. Ja, pra, ai jo më kot s'kishte pranuar kërkënd ta shoqëronte. Albert Sina hodhi krahët mbi supet e të dy vajzave dhe si në një sfilatë mode, i ra rrugës së ngushtë mes tavolinave. Aty, pranë djalit, ai sikur u përpinq të rrinte më gjatë, por njëra nga vajzat, ajo që e mbante kokën kthyer nga ana tjetër, e tërhoqi me të shpejtë dhe ata të tre ecën. Djali 'shtë ngritur në këmbë e që mezi e kishte pritur atë çast, tani rrinte si i ngrirë, me një pamje si prej të marri. Vajza me kokën mënjanë ishte përpjekur më kot të fshihej. Ai e kishte njohur, ishte dora vet. Paula e tij! Paula mikeshë e Albert Sinës?! Ja, pra u gjend mundësia për t'u lidhur me këtë njeri të fuqishëm. Shpejtoi e aty në krye të oborrit, ai shtangu. Alberti i dha dorën vajzës tjetër, ndërsa rrëmbeu, ose më mirë e ngriti hopa Paulën dhe zuri të ngjiste shkallët për në katin e dytë. Gent Olta u zvarg mbi parmak, dalëngadalë iu prenë fare gjunjët dhe u palit mbi shkallën e parë. Veç të tjerash, tani aty jashtë, vera e rrëkellyer më parë sikur i gurgullonte në tru. S'dihet sa kohë kish kaluar, kur ajo vajza që shërbente në lokal, e përmendi duke i folur:

-Kë prisni, z.Albert? Mos e prisni kot, ai ka pronotuar dhomën për gjithë natën...

Djali u shkund. I la asaj në dorë një shuk lekësh, bëri disa hapa çapraze në oborr, doli në bulevard. Lëvizjet ishin rralluar. I tërë qyteti i madh po flinte. Ai u përpoq të shpejtonte, po për ku? Lu morën këmbët dhe ra, u rrëzua pas një muri, duke gulçuar nga dhimbja : "O nënë, o nëna ime!"

1995

## **KALI**

**M**ajori kishte një zakon të keq, para se të jepte detyrën ose urdhërin, nxirrte nga xhepi një shami gati gjysmë metro të gjatë dhe shfrynte hundët aq fortë, sa të kujtonte teshtimën e një kali. Kapiteni, vartësi i tij më i afërt, para këtij veprimi zihej gjithmonë ngushtë, aq sa ky maraz po i kthehej në alergji. Në këtë gjendje ishte dhe atë çast kur majori së fundi, urdhëroi:

-Nxirrni bllokun, kapiten dhe sheno, atje tek maloku ka kohë që hyn e del një gollbordas, për të cilin ka të dhëna se i shërben një agjenture të huaj. Fshatin e tij e ka buzë kufirit dhe kufiri shtetëror e ka kthyer në vreshtë. Me sa kuptohet po përpinqet të shtrijë rrjetin e tij edhe në qytetin tone dhe pikërisht ka zgjedhur malokun.

Kapiteni ngriti kokën dhe e vështroi, edhe herën e parë kur dëgjoi fjalën "malok" ai e bëri po këtë veprim. Malok- vazhdoi majori,- unë quaj gjithë ata që bëjnë sheqerka. Në këtë rast e kam fjalën për atë që ka dyqanin tek pjaca. Më kupton? Kapiteni pohoi me kokë. Po a e di ti pse ka zgjedhur pikërisht atë, sepse ai, ai maloku tek pjaca, dikur ka shërbyer si xhandar në atë krahinë. Mos

vallë jemi para riaktivizimit të ndonjë agjenture të vjetër? Se dëgjo, kapiten, agjenturat e perfekcionuara punojnë me perspektivë jo 10 a 20 vjet, por dhe për një shekull. Kështu që malokut tonë, tani i ka ardhur radha për sulm.

-Ai tip kurrë s'më ka ngjallur dyshime, -tha kapiteni.

-S'jemi para dyshimit, kapiten, por para faktit. Ke ti ndonjë mjet për të penetruar në atë fole?

-Jam i papërgatitur, -tha tjetri.

-Gëzohem dyfish që s'jam unë vartësi juaj, -tha majori gjithë kënaqësi dhe po ashtu hodhi në tavolinë fotografinë e një vajze fare të re. -Do të përdorim këtë, është e bija e tij, maturante. Pse qesh? Nuk do merresh ti me të, jo, ti sikur edhe mirëmëngjes t'i thuash, do t'i futësh lemerinë. Këtu ai shpërtheu në të qeshur, ndërsa kapiteni vetëm sa lëvizi buzët. -Do të aktivizojmë nëntogerin, -përforcoi majori qetë-qetë. -Kë, artistin?

-Ç'artist?

-Nëntogerit, shokët e sërës së vet, i thërrasin artist, pasi ai dikur, para se të shkonte në shkollën ushtarake, u paraqit në një konkurs, për artiste, aktorë, si i thonë, por dështoi.

-Pse, -u çudit majori, për nga bukuria atij s'i gjendet shoku... Pse të ketë dështuar!

-Për faj të zërit...

-Po qe për zë, zë ka gomari sa të duash, por, ta them unë, e vërteta është ndryshe: ajo shkollë ka qenë, dhe do të jetë kurdoherë kundër pushtetit.

Kapiteni nuk e përtypi dot këtë, por ai i përmbahej parimit se heshtja është flori, prandaj nuk e zgjati veçse heshti.

-Si thua ti, -shpërtheu majori, -në se nëntogeri ynë i vardiset kësaj zōçke...ëëë...?

Kapiteni përsëri nuk foli.

-Ja ku po ta them unë. - këtë radhë u ndje hapur prepotencia dhe ironia tek ai, -ai djalë aq i bukur, edhe ne të dyve po të na vardiset, rrezik, rrezik të na i përbledhë!...

-Ama ç'shaka, -s'duroi kapiteni.

Të nesërmen nëntogeri bukuosh mori detyrën dhe e quajti atë si një dhuratë të zbritur nga qielli. Së pari do të shpëtonte për ca kohë prej asaj unifrome të mallëkuar, që të themi të drejtën, i hynte pak në hak bukurisë së tij tepër mashkullore e tepër të lavdërueshme dhe, tjetra, shumë herë me e gëzueshme për të, ishte gjahu, vajza, pasi do të mjaftonte vetëm t'i thosnin emrin e saj dhe

ai do të fluturonte. Kush s'e njihte Xhinën në atë qytet? Ajo mbahej për katër vjet rresht ylli i qytetit e sidomos tani në maturë vajza kishte arritur kulmin e rinisë së saj, majën më të lartë të bukurisë që kërkund s'i gjendej shoqja, veçse në ca revista të pakta: të huaja që hynin në atë kohë. Flokët të zes, të gjatë, që nxirrin në pah një fytyrë ëngjëllore, të bardhë qumësht. Sytë e saj të zes, të pastër e gjithmonë të gëzuar, një trup me të lartë nga shoqet, por dhe më elegante e më ndjellës. Nëntogeri, që absolutisht nuk binte më poshtë nga ajo, dhe ai këtë e dinte, qysh në muajin e parë të ardhjes në këtë qytet, në një rast fatlum siç e quajti ai, pati mundësinë ta shihte e ta prekte vajzën. Ishte ajo ditë, kur ai, në palestrën e shkollës kryente stërvitjen e zakonshme, dhe Xhina, pak më tutje, jepte e merrte duke u stërvitur mbi shkallët suedeze e në një çast vajza ra, por i shpëtoi demtimit, falë shkathësisë së nëntogerit që me nje kërcim iu gjend pranë duke e pritur hophthi mbi krahët e vet. Mbas kësaj ata, si rastësish përballeshin çdo mëngjes. Vajzën e kapte një purpur i lehtë dhe kjo e shtynte nëntogerin jo pa krenari t'i pohonte vetes se po fitonte mbi të, aq i sigurtë po ndihej sa një ditë të nxeh të shtatori aty buzë lumi, ku më të shumtën e herës lajhe rinia, ai gjeti rast dhe i pëshpëriti vajzës ca fjalë të marra nga një libër i Xh.Gollsuorthit: "Ty, Xhinë, të shtie në dorë kur të dua. "Vajza vetëm kishte buzëqeshur, por buzëqeshja e saj të përvëlonë zemrën, të hutonte dhe të gëzonte ditët, por të linte pa gjumë natën. Në se ajo ende s'më ka puthur vet e para, pa dyshim që e ka penguar uniforma, mendonte i shkreti nëntoger... Po tani, tani... Ai e kishte hedhur tutje uniformën e vendin e saj e kishin zënë një palë xhinse, një golf dhe një xhakovento. Krejt tjetër dukej tashmë ai djalë. Liria e fituar ia shpaloste më bukur linjat e trupit prej gjimnasti, ia nxirrte më në pah fytyrën simpatike.

-Dhe kujdes se mos biesh në dashuri, - e porositi majori, - ti je i ri, me perspektivë, s'ke pse të lidhësh jetën në këtë qytet mizerje. Këtu vetëm tri gjëra duhen respektuar...

-Cilat?

-Ato tri parrullat në pjacë, ajo që i uron jetë të gjatë Udhëheqësit, ajo që pëershendet partinë, dhe ajo në të majtë që bekon popullin tonë që do aq fort Udhëheqësin dhe partinë... Dhe sakaq majori nxorri shaminë e gjatë. Kapitenin e mbërthyen mornicat. Le të fliste majori edhe nja dy orë të tjera, veç atë që dreq zakoni aq të pështirë kali, kali, ia nisi - tha nën zë kapiteni dhe me të shpejt i futi krahun nëntogerit e bëri të dalë jashtë.

-Kisha dhe diçka tjetër, -tha majori, -po nejse, do të shihemi...

Ata të dy kapërcyen pragun dhe duke zbritur nëpër shkallë dëgjuan atë shfryrjen e llahtarshme të hundëve.

Të hënën në mëngjes, ndërsa Xhina ishte duke hyrë në oborrin e shkollës, pa tek shkallët e godinës atë, nëntogerin që i qeshur, nisi të vinte drejt saj.

-E paskeni kryer herët stërvitjen sot? -pyeti ajo.

-Nuk erdha për stërvitjen, -iu gjegj ai, -por... dhe heshti një çast aq sa mundi të dëgjonte dihatjen e nxituar të vajzës, e pastaj vazhdoi :

-Xhina, a s'e vë re ndryshimin?

-Çfarë? - belbëzoi ajo dhe ai pa vullnet vështroi atë nga poshtë lart, atëhere kur shikimi i tyre u këmbye, vajza u mberthye prej një zjarrmie të vërtetë.

-U lirova nga ushtria, erdha të bisedoj me drejtorin tuaj, në se ka nevojë për ndonjë mësues fiskulture. A do të pëlqente të më kishe mësues, Xhina? Të paktën shkallët suedeze, s'do të ishin më shkallë të rrezikëshme...

Vajza këtë radhë qeshi çiltër e plot kënaqësi.

-A do të pëlqente? -përsëriti kot ai dukë iu afruar më pranë saj dhe ajo bëri po atë veprim, por shpejt shtangu. I shtrengoi vetëtimthi dorën atij dhe iku.

-Mbasdite, -tha nëntogeri dhe nuk ia ndau sytë deri sa më në fund Xhina humbi mes shoqeve. Që vajza kishte rënë në dashuri plotësisht me të, ai u bind atë buzëmbrëmje me shi duke pritur aty pranë apartamentit të saj. Dy ditë më parë ai i bëri një ftesë Xhinës për të parë atë filmin e ri që kish ngjallur aq interes sidomos tek rinia, në një nga oraret e pasdites. Xhina e kishte pranuar ftesën e ashtu siç bëjnë gjithë gjimnazistet, i kishte kërkuar një shoqes së saj t'i bënte shoqëri, gjë që as nëntogeri s'pati kundërshtim. Shoqja e Xhinës ishte një bionde e mrekullueshme, një manjake, e vërtetë e modës, mjaftonte një informacion i rëndomtë se në kryeqytet preferoheshin fustanet e gjatë dhe e para që do ta vishtë atë në këtë qytet të humbur do të ishte ajo, ose në rastin e tanishëm, kur ngado kishte shpërthyer minifundi, bjondia sikur përpiquej t'i imponohej këtij qyteti që sidomos ndaj kësaj mode lëshonte jo mallëkime por bubullima, prapëseprapë biondia e veshi minifundin një pëllëmbë mbi gjunjët e saj të bukur, duke manifestuar rininë e freskinë e trupit të saj pa e çarë kokën për kërkënd. Pra ata shkuan të trë në kinema dhe nëntogeri që si dhe shumë të tjerë kishte një përfytyrim 'prej

leshkoje ndaj bjondes, gati për sa kohë zgjati shfaqja e filmit, e mbajti dorën në mes të kofshëve të saj. Biondja, më ngushtë s'e kishte parë veten. Në sallë s'kishte ku të hidhje kokrrën e mollës, e megjithatë aty nga fundi i filmit ajo tepër e egërsuar i ngjeshi thonjtë mbi lëkurën e dorës së tij duke i shkëputur një copë goxha të madhe. Më pas, atë ngjarje të shëmtuar; biondja ia tregoi Xhinës. Kështu që atë buzëmbrëmje me shi Xhina erdhi vetëm e vetëm për t'ia përplasur atij të vërtetën në fytyrë, por vajza e urtë e humbi, u qulli, u zbut dhe zuri të qajë, si të ishte ajo fajtorja. Nëntogeri me mjeshtëri, e ktheu me të shpejtë në sulm për bionden, duke e akuzuar për mashtruese, xhelozë. Se të themi atë që është: Që duket, por që s'mund të preket nga kushdo, e vulosi arsyetimin e vet nëntogeri, -a s' thonë për ne se jemi çifti më i bukur i qytetit?!

-Më trego dorën, -tha vajza duke qarë.

· Ai ia zgjati e në çast shpërtheu:

-Ah, për këtë s'të fola. Harrova, por ja po ta tregoj. Në dalje, aty ku grumbulli i njerëzve ishte më i madh, ajo më mbërthehu dorën e djathë, ja këtë, dhe po ma afronte pranë buzëve të saj. Më kafshoi. Bisha. Me siguri që s'di të puthë ndryshe. Vajza u tulat. Ai i rrëmbeu kokën midis dy duarve të veta dhe e puthi, fillimi shët në ballë, por e ndjeu se buzët e saj po kërkonin ato të tijat dhe sakaq ato zunë të lumturojnë njëri-tjetrin. Ndenjën gjatë aty. Ai u interesua për familjen e saj e natyrishët, duke çuar ujin në mullirin e vet, pati ç't'u raportojë shefave të tij, duke i informuar se golllobordasi, s'ishte gjë tjetër, veçse mik i familjes e që vinte aty dy-tri herë në javë për të përgatitur bozën që shiste i ati i Xhinës në dyqanin tek pjaca.

-Na përgatiska bozën! -ironizoi majori. -Ç'i thua kësaj ti, kapiten?

-Në fakt, -tha kapiteni, -në atë lokal ka kohë që tregëtohet bozë.

-Vazhdojeni detyrën, -tha majori.

Kapiteni u gëzua, jo nga që s'do merrte detyrë tjetër, por në kësi rastesh, kur majori s'kishte ç'të thoshte ndonjë gjë të re, nuk demonstronte atë zakonin e tij të keq. U ngrit nga karrikja i kënaqur, duke i dhënë një shenjë nëntogerit se së bashku mund të kthenin ndonjë gotë andej nga fundi i rrugës kryesore.

Edhe në ditët që pasuan nëntogeri s'pruri asgjë të re, veç asaj që golllobordasi ishte mik i vjetër i familjes dhe që vinte aty për të përgatitur bozë. Majori tashmë po shqetësohej seriozisht. Zuri të dyshojë mbi aftësitë e nëntogerit dhe një natë, pasi bisedoi deri

vonë me kapitenin vendosën t'i kërkojnë një informacion më të gjerë Degës N, që mbulonte Gollobordën dhe përgatitën së bashku një plan të ri.

-Domethënë, -i tha ai aty në zyrën e vet nëntogerit, -asgjë e re?

-Që gollobordasi është...

-Dokrra, -e ndërpree majori.

Ndërkohë u hap dera dhe hyri kapiteni.

-Kam patur një krizë veshkash mbrëmë, -tha ai, -dhe...

-Ruhu prej ndonjë krize tjeter, kapiten, -iu përgjegje majori, - nejse... Gëzohem që je më mirë. Atëhere... A jo, jo kështu as nuk jepet, as nuk merret detyra. Njëri i sëmurë, tjetri vështron si i çakerdisur, -ai nxorri me të shpejtë shaminë e gjatë dhe zyra buçiti nga shfryrja e hundëve të tij. Kapitenit iu duk vetja si në një stallë.

-Fillojme, - oshëtiu zëri i majorit, që në çast hapi sirtrain e tavolinës së vet, nxorri një çelës dhe ia zgjati nëntogerit. -Merre, ky është çelës dhome, se i kujt dhome do të ta tregojë kapiteni.

-Unë, kur e diskutuam bashkë, ju thashë se...

-Rëndësi ka kjo që kam vendosur unë, -tha majori. -Pra dhomën do t'ua tregojë kapiteni. Atje, në atë dhomë, ka, ç'far nuk ka, të gjitha të mirat... për moshën tënde, sidomos, nëntoger, një krevat dopjo, një...

Nëntogeri, me sa duket hyri në temë e buzëqeshi.

-Mos doni t'u blej dhe një prezervativ? - qeshi ai, qeshi dhe kapiteni pak më tutje, edhe nëntogeri madje më i kënaqur.

-Se dëgjo, ti djalë, shumë gjëra të rëndësishme në këtë botë i zgjidh për bukuri shtrati. Thonë se N.Bonoparti, pikërisht në shtrat, zgjidhët shumë nga enigmat e betejave të tij. Si thua, kapiten?

Kapiteni i ndenji besnik parimit të vet, heshti. Majori i bëri shenjë nëntogerit të dilte jashtë e ky doli në çast. Aty vetëm për vetëm me kapitenin, majori urdhëroi:

-Të fotografohet!

Nëntogeri e realizoi pa ndonjë vështirësi të madhe detyrën e vet. Ndërsa shoqet e Xhinës po vraponin për në palestër, ai e thirri atë, e nxorri në qoshe të shkollës e, pasi e hipri prapa biçikletës, fluturoi së bashku me të. E gjendur në atë dhomë krejtësisht të panjohur, por e mbajtur pastër dhe bukur, vajza ishte pushtuar sa prej frikës, aq dhe prej gjëzimit, se ai që ndodhej pranë ishte njeriu i zemrës së saj... dhe në fund të fundit sa herë kishte ëndërruar për një çast të tillë. Edhe nëntogeri s'ishte më aq i pavarur ndaj dashurisë

me Xhinën. E filloj thjeshtë, ashtu si dhe në shumë raste të tjera, se dhe Xhina do t'i nënshtrohej, do të realizonte ç'kishte për të realizuar e pastaj çdo gjë do të palosej në dosjen e kujtimeve të një rinie plot epshe e seks. Por rastin me Xhinën ai s'po mund ta trajtonte si me të tjerat. Kjo jo më tepër se sa reagimit apo ndjenjës së tij, i kushtohej vajzës që me siguri dashuronte për herë të parë, ku çdo gjë të mirë, fisnike, të zgjuar, të bukur ia dhuronte pa rezervë partnerit dhe kur tek ai, jo vetëm që s'mund t'i vesh re të metat por edhe gabimet ia fal. A nuk kishte vepruar kështu Xhina me të?! Atë natë kur ai së bashku me kapitenin pinë nga një gotë, u hap disi kjo bisedë. Kapiteni, ndoshta për herë të parë nuk e respektoi deri në maksimum parimin e tij të artë të heshtjes dhe me gjysma fjalësh a me ndonjë sentencë i kishte bërë të qartë më të riut, se dashuria në zanatin tonë është më e dëmshme se kolera për atë të zakonshmin. Se jeta me uniformë s'ka dashuri, por ka urdhëra. Se kur të mund dashuria, duhet të lesh mbi tavolinën e majorit, koburen, gradat etj, e pastaj të marrësh dashurinë... e pastaj, pastaj... jeta vazhdon, kishte buzëqeshur duke rrëkellyer gotën kapiteni.

Në fund të javës kapiteni, pasi lau dhe stampoi fotografitë e bëra fshehurazi në dhomën ku bëri dashuri nëntogeri me Xhinën, - dhe duhet thënë se nuk u kushtoi aspak vemendje, -i futi në zarf e me të shpejtë ia shpuri majorit në zyrë. Ky, përkundrazi, i soditit me shumë endje ato fotografi herë gjysmëlakuriq, herë lakuriq fare aty mbi shtrat të të dy të rinxve. Kërkoi në telefon nëntogerin.

-A mund të dal unë? - tha kapiteni.

-Jo, jo, - bëri tjetri.

-Por ju do t'i jepni detyrën e re atij, pra s'ka të bëjë me mua, kështu që... Kapiteni donte vetëm e vetëm të largohej, por kur pa se tjetri e nxorri shaminë e gjatë... Ndërkohë ra dera. Zhurma e shfryrjes së hundëve u përgjysmua, sepse kapiteni me të shpejtë kishte shkuar drejt derës.

-Prit, -tha majori, duke fshehur fotografitë në sirtarin e vet. Kapiteni hapi derën dhe brenda hyri nëntogeri.

-Ç'rezultat dha shtrati? -pyeti majori.

Nëntogeri qeshi e nën zë foli:

-Asgjë veçse gollobordasi është mik...

-Dhe që vajza ishte e virgjër. -shpërtheu majori, -nejse, tani të thirra për tjetër gjë. Të pata thënë se në këtë qytet mizerje, të duhej ta lidhje jetën dhe mirë bëre, se në këtë qytet vetëm ato të tre

gjërat që të kam thënë, ato tre parrullat tek pjaca duhen respektuar dhe këtë unë s'e vë në dyshim. Ja, pra, kam këtu përpara urdhërin e transferimit tuaj. Që sot në mëngjes ju kini filluar punë në ministrinë tonë.

Nëntogeri u ngrit me të shpejtë nga karrigja. Kapiteni edhe pse e shikoi vëngër, mundi të shquaj se mbi lëkurën e butë e të bukur të nëntogerit, në çdo milimetër, lulëzoi ndjenja e karierës.

-Mund të nisem që tani? - pyeti nëntogeri shend e verë.

-Patjetër, patjetër, makina ju pret jashtë. A shkojmë dhe e përcjellim, kapiten?

Disa ditë pas largimit të nëntogerit, në anë të një rruge të fshehtë, pa rënë në sy të opinionit të shkollës e më gjérë, Xhina u gjend ballë për ballë me majorin, pikërisht në zyrën e tij. Vajza ndihej tepër e tronditur. Prej bukurisë së saj s'kishte mbetur asgjë, veçse syve dhe flokëve palë-palë mbi supe.

-Qetësohu, -i tha majori.

Vajzës iu duk sikur ai i tha vdis, për të ajo s'kishte asnje njobje, ndonëse prej djemve të qytetit ai etiketohej: "Hundëderri". Kaq gjë Xhina e dinte, por ajo kurrë as me mend s'e kishte thënë një epitet të tillë.

Përse ta kishte thirrur ai "hundëderri" këtu? Por ajo mori vesh arsyen më shpejt nga sa priste. A nuk ishte interesuar madje deri në mërsi edhe nëntogeri për atë mikun e shtëpisë së tyre, pra për gollobordasin?! Kështu që vajza s'tha gjë tjetër veçse ato që i pat thënë edhe të dashurit të vet, ose më mirë ish të dashurit, pasi po atë mbrëmje kishte bërë një bisedë me bjonden, me shoqen e saj te dikurshme, e cila i tha se ai tip nuk është nga ata që e kthejnë kokën prapa. Dhe vërtetë ai kishte kaq ditë i larguar dhe ajo s'dinte asgjë, asgjë...

-Këtë përrallën se ai është niku i familjes suaj, mos ma trego mua. - prishi heshtjen majori.

-Ç'di unë tjetër? - tha vajza.

-Se ai vjen aty për të përgatitur bozën.

-Po, -tha vajza.

-Budallaçkë... ti, ti s'do as veten tënde, por s'dashke as babain tënd.

Vajza zgurdulloi sytë. Ç'hynte babai këtu? Ç'të këqe i paskej bërë ajo të atit!?

-Dó ta shpëtosh tët at, apo jo?

Vajza sikur e mbledhi vëten. U ngrit në këmbë dhe

përsëriti në mënyrë të vazhdueshme dhe rrëptë :

-Dua të ikë, të ikë...

-Jo, -tha tjetri. -Ti do të rrish këtu dhe do të bësh nga sot e tutje ç'të themi ne...

-Në asnjë mënyrë, -tha vajza, -e si e ndërkryer përsëriti: - Dua të ikë, dua të ikë...

-Ti s'ke ku të vesh, -ia priti majori. -E mos kujto se po luan me kuklla këtu!

Ajo u bë gati të shkonte drejt derës, por ai e mbërtheu prej dore dhe ashtu me kokën ulur, e çoi drejt e tek sirtari i vet. E hapi atë me dorën tjetër, nxorri fotografitë lakuriq të Xhinës, dhe i hodhi mbi syprinën e tavolinës...

Vajza, kur pa veten aty, ulëriu një çast dhe ra pa ndjenja . Me të shpejtë hyri kapiteni. Ai, pa thënë asnjë fjalë, rrëmbeu kanën e ujit që ish mbi një tavolinë të vogël, u ul pranë vajzës, ia mori kryet në dorën e vet, dhe ai ia fërkoi fort e fort damarët e qafës, ia freskoi ballin me ujë, deri sa vajza u permend. Majori, që vërente si hutaq veprimet e kapitenit, dalloi mbi fytyrën e tij një si dhembje të thellë. Hëm, ia bëri me vete majori. Edhe ky palo ushtarak qenka! Dhe tek e kundroi se si vajza po mirrte veten, futi në sirtar togun e fotografive që kish nxjerrë pak më parë, e urdhëroi:

-Boll për sot. Të lihet e lirë. Nesër vazhdojmë përsëri. Kemi plot e plot gjëra të bukura për të biseduar me Xhinën...

Kapiteni ndihmoi vajzën gjersa ajo arriti jashtë derës dhe aty e priti një tjetër njeri. S'vonoi e kapiteni u kthyte përsëri në zyrë.

-Sapo mbrriti ajo kërkesa që i kemi bërë Degës N...

-E ç'hotë? -pyeti majori.

Kapiteni ia zgjati letrën dhe ai nisi ta lexojë. Nuk e mbaroi dot së lexuari, kur ia plasi një gazi plot zhurmë, sa e qeshura dukej se gurgullonte nga gurmazi i kërcyer paksa jashtë i majorit. Mbase nga kjo pamje e qeshura molepsi kapitenin, i cili tjetër gjë mendonte në ato çaste.

-Ti qesh kot, -térhoqi vërejtjen majori.

-Jo, -tha kapiteni. -Edhe unë e kam lexuar atë shkresë.

-Domethënë, ky që survejojnë na qenka vetëm një bozaxhi?!

-Bozaxhi, - tha kapiteni.

Dhe si tē komanduar nga një i tretë, tē dy ia dhanë persëri tē qeshurës, veçse kapiteni queshte dhe i binte leht-leht kokës me grushte.

Tē nesërmen një lajm i kobshëm, që në mëngjes herët, mbërtheu tërë qytetin. Xhina atë natë s'kishte shkuar në shtëpi. Familja e saj e kishte kaluar lehtë, duke menduar se ajo do tē kishte bujtur tek tē afërmët e saj, por atë mëngjes, atje tek ai pellgu në lumë ku lahej më tepër rinia, trupi i saj u gjend pa jetë. Vajza kishte mbytur veten. Kapiteni e dëgjoi si rastësisht këtë tragjedi. Ai s'po guxonte tē pyeste kërkënd. Doli në pjacë. Pa dyqanin e tē atit tē Xhinës, ai ishte mbyllur. Edhe dhjetra dyqane tē tjerë, privatë e shtetërorë, ishin tē mbyllur. Pra, s'ishte nevoja tē pyesje. Tragjedia kishte ndodhur me tē vërtetë. Atij iu bë sikur jo vetëm njerëzit e rastësishëm që kalonin, por edhe gurët, edhe ndërtesat, edhe pemët e rrugës, i pëshpërisnin në vesh: vrasës, vrasës! Ti je vrasës dhe sakaq fluturonin. Ai ecte, ecte ose kishte ende aq forca sa ta shtynte veten deri aty, aty... ku ai ngriti kokën lart dhe në atë ndërtesën dy katëshe, pa në katin e dytë, tek ajo dritarja e hapur një kokë kali, ky që vetëm një çast se pastaj ai shquajti atë që nxorri atë shaminë e gjatë një gjysmë metër, e cila tanë iu bë kapitenit si një litar që zgjatej e zgjatej prej aty e vinte drejt qafës së tij.

## **ARUSHA**

**S**ë fundi, kapiteni i thanë të dorëzonte revolverin. S'ishte aspak punë e lehtë kjo për të, aq më shumë që ishte mësuar ta mbante në brez për gati 20 vjetë. Oficer pa revolver! Ai më kot u përpoq të gjente diçka të përafërt me këtë gjendje. Jo, kjo ishte e padurueshme. Do të kundërshtonte, deri sa ishte thjeshtë urdhër i komandës, ai edhe mund ta kundërshtonte. Një dritë jeshile ekzistonte. Do të bënte ankesë në parti. Ai s'kishte qenë kurri anëtar i saj, por e dinte fort mirë se ajo, pikërisht ajo ishte kryekomandante, e megjithatë kapiteni ndërrroi mendje. I thanë se për masën e marrë, për transferimin dhe për heqjen e revolverit ishte marrë edhe pëlqimi i saj. Atëhere, s'më mbetet gjë tjetër, tha ai, të dorëzoj edhe kapelen. Po, po, kjo duhet bërë, madje sa më shpejtë. Si? Të dorëzonte dhe kapelen?! Po Partia, që i kishte ndarë të dyja masat nga njëra-tjetra, që i kishte marrë armën dhe i kishte lënë kapelen, mos vallë kishte vepruar ashtu thjeshtë për qejf? C'kërkon ti, të të marrë iant edhe ajo? Dhe inati i Partisë është dhjetëfish më i madh se ai i mushkës së Papës, tha kapiteni, duke sjellë ndër mend një tregim të Alfons

Dodesë. Kështu që i hoqi nga koka të gjitha ato marrëzira. Falenderoi për nderin që po i bëhej, duke i hequr revolverin... po vështrimi i kolonelit aty pranë e ndihmoi të korigjohej shpejtë dhe tha me zë të lartë se falenderonte veçanërisht Partinë që po e lejonte të mbante kapelen.

Mori fletën e transferimit dhe u nis për në malet e Polisit. Aty bëheshin punime, si fortifikata, kupola e të tjera të këtij lloji. Shkurt aty ishte një brigadë pune, e ndarë në toga e skuadra. Ushtarët ishin gjysmë ushtarë, ndërsa oficerët ishin më pakë se gjysmë oficerë. Kjo përshtypje krijohej fare lehtë edhe prej një syri të rëndomtë e jo më t'i shpëtonte kapitenit. Kapiteni ish mësuar me jetën e rregullt, disiplinën e çdo gjë në maksimum ushtarak në ish brigadën e tij. Ndërsa aty, në atë togën që i dhanë në dorëzim, vetëm ngjyra jeshile të kujtonte ushtrinë, por edhe kjo e kombinuar me opinga dhe me atë shkopin prej thane që mbante në dorë, e bënte pamjen tepër qesharake. Natyrisht në këtë pamje të re kapiteni nuk ngatërroi kapelen, madje kjo mori një vlerë të dyfishtë. Mbajtja pastër dhe në rregull e saj iu kthye në qëllim. Ajo jo vetëm mbronte dinjitetin e ushtarakut, por edhe atë të individit, të tij si njeri, që edhe pse i kishin marrë revolverin, prapë se prapë kishte një forcë që ende ruante respekt dhe përkujdesje për të. Kjo e qetësonte dhe vështirësitë e realitetit të ri nuk po e lodhnin, nuk po e mërzisin, veçse kur dëgjoi prej ushtarëve për atë ngjarjen që kishte ndodhur një dy ditë para ardhjes, midis arushës, klyshëve të vet dhe dy fshatarëve, u shqetësua mjaft. Dhe të dy fshatarët kishin qenë të armatosur. Madje, edhe pse kishin armë, atyre as që u kish shkuar ndër mend të provokonin atë djall egërsire, që kur breth me klyshët e vet, bëhet dhjetë herë më e rrezikëshme. Njërit prej tyre i kishte shkarë këmba. Kaq, vetëm kaq ishte dashur dhe ata të mjerë, për punë minutash, ishin kthyer në copa mishi të gjakosur. Dhe ishin me armë, tha kapiteni, ndërsa unë s'kam as brisk rroje. Dhe jo vetëm kaq, por më duhet të ruaj edhe jetën e ushtarëve të togës, të cilëve as që ua bën syri bëf. Pa le po më kanë bërë edhe seicili nga një thikë teneqeje dhe kujtojnë se e kanë sigurinë në xhep. Ditën hiqen të tillë se, kur i zë nata ata vinë e mblidhen pranë çadrave si pulë të lagura. Veç ama natën e bëjnë gjumin top. Lodhen tërë ditën, kjo është e vërtetë, por dhe kapiteni nuk lodhej më pak, megjithatë ushtarët flinin, flisnin se ishin të rinj dhe shkujdesje, melhem i moshës, bënte të vetën. Ndërsa kapiteni përgjonte, përgjonte për orë të tëra dhe flinte, ose më saktë i dorëzohej gjumit kur kapitullonte

çdo gjë në qenien e tij.

Arusha dhe bëmat e saj po bëheshin bisedat numër një të ditës. Ajo ishte parë të bridhët edhe pranë arave buzë fshatit. Kulmi arriti kur ajo, së bashku me klyshët e vet, gati sa nuk e shqeu më dysh rojtarin e mullirit të blojës. Atëhere kapiteni me të shpejtë thirri ushtarët. Urdhëroi që thikat, të cilat i mbanin të fshehura, tani e tutje, t'i nxirrin, t'i mbanin te varura në brez, madje porositi edhe nja për vete. I porositi ushtarët që perëndimi i diellit t'i gjente të gjithë në çadër. Ushtarët edhe pse ishin nga ajo "dorë" që s'përbënte interes të veçantë për eprorët lartë, përkundrazi, për kapitenin cili tani i njihte gati të gjithë u treguan djem të mirë e të matur. Ata i morën për urdhër porositë e këshillat që u dha. Po ç'mund të bënte ky hap mbrojtës për ta dhe për vet kapitenin?

A vërtetë ato palo thika do të prapsnin furrinë e arushës dhe të klyshëve të saj! Ato ngjanin si lodra kalamajsh. Po jeta, jeta e tij dhe e atyre djemve të rinx s'ishte lodër. Natyrish që kurrë s'mund të jetë e tillë. Le të mos më duan mua, as mua as ushtarët, veç ne gogla s'jemi, nuk jemi... djalli ta marrë! Kjo e shtyu kapitenin dhe i nisi një kërkesë komandës që nënreparti të paisej qoftë edhe me një pushkë çfardo. Po edhe kjo i doli huq. Atëhere vendosi ta kryente vet detyrën e rojës, duke mbajtur pranë vetes një lopatë xhenjëre me një bisht gati 2 metor të gjatë. Me t'i zënë gjumi ushtarët, ai bënte disa hapa më tutje e ngujohej aty, duke përgjuar për orë të tëra. Fati i madh që moti ishte i ngrohtë. Një natë zemra i iku nga vendi. Një si hije, tutje tij, u shfaq dhe u zhduk. U tret në terrin e natës. Por pas pak një si rënkim, si ulërimë më pas, e bëri të dridhej si purteka dhe do ti që as fuqi që të thërriste nuk kishte? Ùmek si fëmijë. Papritur qetësia u kthyesh përsëri. Ai mbajti vesh për një farë kohe e pastaj, me lopatën xhenjere në dorën e djathëtë bëri lehtë-lehtë disa hapa më poshtë. Pikërisht atje tek ajo gëmusha e madhe ai u ngatërrua mbi ca shkarpa të hedhura andej-këndeje e ra mbi një vend të butë, shtruar me gjethë, si t'i kishte bërë dorë njeriu. Të nesërmen nuk e bëri përfjalë atë ç'ka i ndodhi mbrëmë, vceç me njië drithërimë prindi në zemër i vështroi ushtarët një e nga një, të cilët ashtu, të urtë e të dashur, largoheshin për të kryer atë dreq detyre në ato transhe të thella e të rënda, që zor se gjendej mendje njeriu që të provonte vlerën e tyre në ato gryka malesh e shkëmbinjsh. Edhe në mbrëmbjen e asaj dite, kur ushtarët kishin kohë që flinin dhe nëpërmjet gërhimave nxirrin lodhjen e tepërt të asaj pune të rëndë, kapiteni e kishte zënë vendin e tij të rojes dhe përgjonte, përgjonte. Nuk

kaloi shumë dhe aty u shfaq e njëjtë gjë e mbrëmshme. Mendoi të zgjonte një nga ushtarët, por nuk e bëri mbasi qetësia qe e shpejtë dhe e plotë. Ai nisi të dyshojë tek vetja. Mos vallë si mbrëmë si sot s'sëstë asgjë e vërtetë? Mos vallë ish një fiksim?! Ndërsa ishte në këto mëdyshje, atje poshtë dy hixe ngacmuan sakaq cipën e natës dhe humbën atje tek gëmusha. Ai mbërtheu fort bishtin e lopatës, por pa lëvizur nga vendi. Priti mos dëgjonte ndonjë zhurmë, por më kot. Guxoi, mori një gur të vogël dhe e hodhi për nga gëmusha. Qetësi. Hodhi edhe një gur tjertër, kur ja befas, prej aty doli dikush, duke lëshuar në terr një kollë të thatë. Njeri- tha kapiteni i shtangur, njeri! Ai po afrohej. Kapiteni njoju një nga ushtarët e vet.

-Po ti? -pyeti i habitur dhe në çast shquajti prapa ushtarit një vajzë fshati, që qëndroi një hap më larg. Ushtari nisi t'i tregojë...

-Po pse këtu e gjete të bësh dashuri ti? Kam dy netë që ruaj me gjak të ngrirë.

-Ku të shkoj? -iu përgjegj ushtari si i zënë në faj. -thellë në pyll s'shkoj dot. Ti e di... arusha ...

-E pastaj? - e ndërpren kapiteni.

-Vijmë këtu, -u përtyp tjetri, -se dhe po të marrë puna për keq ju s'do ta kurseni një plumb për atë egërsirë.

-Unë s'kam armë - tha kapiteni. -Pse qesh?

-Armë s'kemi ne.

-Cilët ne?

-Ne pra, unë dhe shoket e mi. Ti e di fort mirë se unë dhe ata e fillojmë ushtrinë me lopatën në dorë dhe me lopatë e mbarojmë.

Kapitenit s'i erdhi mirë, ndonse ajo që tha ushtari ishte aq e vërtetë sa q'ishte dhe nata që kishte mbuluar gjithësinë.

Kapiteni ktheu krahët e ndërsa po bëhej gati të largohej, u kthye e tha :

-Domethënë se ti dhe shokët e tu e dinë se unë kam armë, ashtu e di edhe ajo vajza pranë teje, rrezik edhe gjithë fshati, ë?

-Ne u gjëzuam të gjithë kur erdhe ti. -ia ktheu ushtari, që e mori vajzën më pranë vetes. -Para teje na komandonte kapteri, por edhe ai si ne ishte, nuk i besohej arma. Ne atëhere bënim roje me radhë, nuk flinim të gjithë gjumë si tanë.

-Dhe bëni një gjumë për shtatë palë qejfe. -ironizoi kapiteni.

-Po, po, u lumtë! Flini, flini, se ju mbroj unë, ja me këtë - dhe ai i ra fort bishtit të lopatës. U largua gati me vrapi e shkoi drejt e në çadrën e vet. Të nesërmen në mëngjes, madje para se të përcillte ushtarët në punë, nisi një kërkësë tjetër për t'u paisur me armë. Këtë

kerkesë e nisi fill e në linjë partie. Se ç'kishte një shpresë se këtë radhë zgjdhja do të ishte e shpejtë. Dhe aty nga fundi i javës, kur pa se po vinte vet koloneli, i shoqëruar me dy ushtarë të armatosur me automatikë, shpresën e ktheu ne realitet. U përshëndet me kolonelin dhe ishte ai kolonel që dikur me atë qortimin e lehte e kishte ndihmuar më së miri.

-Arusha këndej paska bërë kërdinë, -tha koloneli, si për ta justifikuar çudinë e kapitenit, i cili i hidhte sytë sa tek njëri automatik tek tjjetri. Ai kontrolloi punimet. U interesua shkarazi për jetën dhe ushqimet e ushtarëve. Në të errur, ndërsa kapiteni tjetër gjë priste, koloneli fare papritur, i zgjati dorën për t'u ndarë. Atëhere ky me padurim dhe me një ndjenjë inati tha:

-Kam bërë nja dy kërkesa për armë, madje këtë të fundit e kam nisur në linjë partie. S'e kam për hallin tim, por rrëth meje janë edhe 10-15 ushtarë, të cilët më shohin mua në dritë të syrit. Ju vetë e thatë se arusha...

Koloneli, duke i dhënë shenjë, e ndërpreu dhe urdhëroi njerin nga ushtarët të lëshonte nëpër qiellin e sapo errur një breshëri të tërë. Kapiteni sepse mendoi se pikërisht atë automatik do t'i linte atij. Veç tjetër gjë doli.

-Nisemi, -tha koloneli.

Ushtarët hodhën armët në sup. Ata u vunë në rrugë.

-Nuk më dhatë përgjigje. -këmbënguli kapiteni.

-Kujt ia keni bërë kérkesën? - u hoq i paditur koloneli.

-Këtë të fundit?

-Lëre, -tha koloneli. -E kam të qartë, të dyja kérkesat partia i ka marrë.

-Ende s'është bërë asgjë - tha me pezëm kapiteni.

-Ajo, ajo i di të gjitha kapiten, me siguri do ta plotësojë kérkesën.

-Kur, kur të më ketë shqyer arusha?

-E the vet i pari, vetë e the, - kërcëu papritur koloneli dhe duke qeshur, i shtrëngoi dorën fort e u largua.

Kapiteni e humbi paq. Dridhëj e dridhëj. E nxorri inatin me shkopin e thanës, duke e bërë copë-copë. Iu kujtua dita kur pat dorëzuar revolverin. Vetëtimthi hoqi kapelen nga koka. Ndoshta duhej dorëzuar edhe kjo, -tha ndoshta! Dhe sado që kanë kaluar kaq kohë nga ajo ditë, askush nuk e di në se kapiteni e ka bërë edhe dorëzimin e dytë apo jo.

## **KRAHËT E URTËSISË**

**Nj**ë re e bardhë kishte vënë diellin përpara. Sipër, në majë të malit frynte një erë e ftohtë që të kujtonte dimrin. Ishte tetor, ende nuk ishte vjelë rrushi në këto anë, por ishte ajo erë e harlisur që lajmëronte njerzit se dimrin e kishin në prag.

Ata të dy që ecnin të heshtur dhe njëri pas tjetrit, vinin nga qyteti dhe ishin veshur tepër hollë. I pari mbante një këmishë vishnje me mëngë të përveshura. Flokët i kishte të ngrënë tek balli dhe në mes të kokës i ishte formuar një gjysmë hëne. Tjetri ishte shumë më i ri. Këmishën e kishte lidhur si shall rreth qafës dhe mbi shpinë mbante një çantë sportive. Ky, herë pas here, lëshonte ndonjë gulçimë me mllef. Nuk ishte shenjë lodhjeje se sa shenjë mërzitjeje. Diku ndaluan.

-Hidhe këf mishën supeve - tha më i moshuari.

Djali bëri sikur nuk e dëgjoi. Fshiu me shami gjoksin e djersitur e pastaj në qejf të vet, fërkoi krahët, të cilët, sipas lëvizjeve, formonin një kërcim muskuqsh gati sa një vezë.

-Mjeshtër - foli djali, -nuk bëre mirë që e pranove këtë punë.

Mjeshtri nuk iu përgjegj, por dora e djathtë, që gjer në atë çast diçka kërkonte në kasetën e veglave, mbeti si një dege e thyer. Djalit i vajtën vetveti sytë atje. Dora e djathtë e mjeshtarit iu duk më e shëndoshë e më e sertë se tjetra. Pas pak ajo ra mbi tokë me gishtinj të hapur. Djalit iu kujtua se në firmën e tyre, kur bëhej ndonjë punë e paqme, sidomos kur bëhej prej të rinjve, thuhej: "E keni bërë si me të djathën e mjeshtrit".

-Më dëgjove ç'thashë, -vazhdoi djali. -Nuk duhej ta kishe pranuar, sipërmarrësi i firmës ta ka bërë me qëllim. E kërkon të mbaruar në fund të muajit! Por mos harro, muaji edhe tri ditë me gjithë të sotmen ka.

-Do të punojmë.

-Përpjetë të hidhemi... hëm... Unë kam qenë në fillim të javës atje dhe e kam parë se ç'punë e madhe është për t'u bërë. Po ai ta vari ty këmborën.

-Ç'këmborë u habit mjeshtri.

-Muaji do të mbyllët. Puna nuk do të mbarojë. Ai e di fort mirë se kështu do të ndodhë dhe përgjegjësia do të bjerë mbi ty, do që ti... ti... Unë hë për hë për vete nuk çaj kokën e, në erdha, erdha se me vjen keq për ty.

Mjeshtri qëlloi tre-katër herë me pëllëmbën e dorës kupën e gjurit. "I ardhka keq për mua, -tha me vete. -Pse t'i vijë keq? A mos vallë unë jam bërë?" S'pati kurajë ta mbaronte mendimin. Iu bë vetja si ndonjë ulok, shurdh e qorr, me dorën e djathtë zgjatur përpëra, ku djali i hodhi një lëmoshë.

-Unë atij s'ia kam përtuar dhe ti e di, -tha djali.

-Dhe të kam folur.

-Nuk di të bëhem unë.

-S'të ka thënë kush të bëhesh urë.

Nderkohë, pranë tyre kaloi një zetor i ngarkuar me arka boshe, që u kthyte për në vreshtin matanë përroit.

Djali u ngrit, hodhi çantën mbi shpinë dhe mori përpjetë rrugës së këmbësorëve. Mjeshtri i vajti pas. Pas shtegut hapej një pllajë. Aty ishin dy rezervuarët të rrethuar me paisje hidraulike. Në të majtë ishte një barakë e vogël. Djali u nis për atje, kurse tjetri qëndroi në buzë të rezervuarit të parë. Përfshiu me sy atë masë të madhe hekurash dhe me mend filloj të rendiste radhën e montimit të tyre. Nga baraka erdhën disa të kërcitura të forta e me rrapëlli. Nga baraka erdhën disa të kërcitura të forta e me rrapëlli.

"Bo...bo... ai njeri edhe me veten zihet" - tha mjeshtri e, me të kthyer sytë andej, pa të fluturonin prej derës së hapur copia

dërrasash, kuti konservash dhe një kovë pafund. Pas pak djali doli. Turfullonte i téri.

-Këtu nuk punohet ... Atje, në atë kolibe qensh, nuk flihet!

-Ne nuk do të dimërojmë këtu, -tha mjeshtri.

-Qoftë edhe një orë. Ai, që na dërgoi këtu, ta llogariste.

Mjeshtri nuk e zgjati, por nisi nga puna. Djali rrëmbeu një shkop e tha:

-Unë nuk punoj.

-Po ç'të të bëj unë? - hapi krahët tjetri.

-Ai, ai, -tha djali, duke bërë me kokë nga qyteti, ndërsa shkopin që kishte në duar e bëri copë-copë.

-Po t'ia mbajë, le të vijë, le të vijë e të me thotë gjysmë fjale, pa ka për ta parë... Nuk punoj! ... Nuk dua të punoj!

Djali herë rrötullohej në vend, herë shtrinte grushtin e godiste në ajër. Pa ç'pa dhe më në fund ia dhë vravit poshtë përroit. Mjeshtrit i vinte për të qeshur. Ah, ç'lumturi ishte të kishe forcën, gjallërinë, moshën e tij! Ah, ç'pasuri ke ti, mor djalë! Por ç'fat, ç'fat i madh është që tërë atë forcë, tërë atë zjarr e pasuri t'ia japësh punës. Kushedi ç'mrekulli mund të nxjerrësh.

Ai e pati zili djalin, e pati zili nga koka deri në këmbë, jo se vet ishte ndonjë i plakur e shëndetlig, përkundrazi, mbahej mirë dhe as kollë duhani s'kishte. "E, -tha, -dielli diell quhet në të katër stinët e vitit, por bukurinë e ka ai i pranverës".

Kaloi kohë e djali s'po dukej. Ai u shqetësua. Mos iku? Po, po... dhe ikën. Inat të madh kishte marrë. Hodhi sytë përqark, por nuk e pa. Hyri në barakë. Këmisha e djalit ishte atje dhe ai u qetësua disi. Po ku të ketë shkuar? Mori edhe vet rrugën për nga përrroi. U ngrit mbi sopin aty pranë dhe pa se atje në mes të vreshtit, një grup vajzash po ngarkonin me rrush zetorin. Ai që merrtë njëherazi arkat e vajzave dhe i vinte radhë ishte djali. Gjoksi i gjërë i shndriste prej djersës. Mjeshtri qeshi me gjithë zemër. "Pa shiko si punokërka atje. Punon dhe qesh. E më të lumte, more djalë! "U mat ta thërriste, po sepse i erdhi keq dhe u kthyte andej nga kishte ardhur.

Kur hija ra nga ajo anë dhe dielli po puthte majën e malit, djali u nda nga vajzat. Ato iu luten të merrte dy-tri bistakë rrushi e djali s'ua prishi. Për sa kohë punoi me vajzat, e kishte harruar fare mjeshtrin, por ja, tani që po shkonte, iu bë sikur e kishte në krahë.

"Po më tha një fjalë, ç'farë fjale, një gjysmë të më thotë, ika, ika me të vërtetë. Megjithse më vjen keq ta lë vetëm. Unë për të erdha. Më erdhi keq dhe erdha. Se po të ishte për atë m... e firmës,

asnje këmbë nuk hidhja më tutje. Po mjeshtri pse i bindet atij?... E, pse i bindet? C'do t'i bëjë ai mjeshtrit? Do t'i heqë kategorinë?... Na, hip këtu të shikosh Stambollin! Atë titull ia ka dhënë tjetërkuhi atij e jo ti, more vesh? Po atëhere ç'e pengon që s'i kundërvihet? Po pse, ka moshë mjeshtri për sforcime, për sakrifica? E, më duket se e gjeta. Mosha, patjetër mosha do të jetë që ia ka flakur tej guximin. "... Sepse u drodh dhe u ligështua sa s'kish ku të vinte më. Djali nuk ishte aq i papjekur as të mendonte se për të, s'do të kishte pleqëri. Do të vinte edhe ajo moshë kur kokën do t'ia mbulonin thijnat, do t'i rruhej balli dhe fytyra, do ta linte edhe fuqia e muskujve. Të tëra këto do të ndodhnin, por atij kurrë ama s'kish për t'iu larguar prej vetes zjarri i guximit. Madje, ai ishte i bindur se kjo ndjenjë, më shumë se sa për mish e kockë, kishte nevojë për zemër. Prandaj u droth dhe u ligështua atë çast kur mendoi se e gjeti shkakun e mos kundërshtimit të mjeshtrit. Atë çast ai vuri në dyshim bindjen e vet, vuri në dyshim vetveten dhe erdhi e u qullos e u telendis aq shumë, saqë, po ta shihnin ato vajzat, të cilave u ndihmoi pak më parë, rrrezik s'do ta njihnin.

Mjeshtri, atje tek rezervuari, po punonte. Djali u afroa dhe vuri dy bistakë rrushi mbi një gur. Tjetri, që e kishte vënë re me kohë, nuk i tha gjë, por zgjati dorën e nisi të hante rrush. Djali e mori si shenjë pajtimi këtë veprim. Ndjeu një gëzim t'i nxehë zemrën, u vrejt e i erdhi turp për sjelljen e vet. Mjeshtri vazhdonte të punonte dhe djalit i vajtën sytë te një vijë gjaku që i rridhëte nga bërryli i dorës së djathëtë.

-E vrava pak, -tha mjeshtri dhe ndërkohë pllakosi mbi plagë një cigare të hapur.

Djali me një kërcim u gjend në rezervuar. Detalet e paisjet e rënda sikur fluturonin në duart e tij. Atë punë që tjetri e kishte bërë për disa orë, djali, me siguri po të vazhdonte me këtë ritëm, do ta arrinte pa u errur. Shumë shpejtë shpatullat e tij të gjëra e vezake kallonin djersë. Ai punonte lakuriq nga mesi e lartë. Ta kishte ëndë ta kundroje atë qërim e tendosje muskujsh. Mjeshtri e vështronë heshturazi e gëzohej "Djall karakteri ka, megjithë më pëlqen"; tha me vete.

Kur u err, ata e lanë punën.

-Të kishe marrë një palë çizme e jo të punoje me këmbë në llucë, -tha djali.

-Nuk m'u kujtua... Të pakten, të të ishte kujtuar ty.

-Mua... hëm... Unë të thashë se kam ardhur për hir tënd. Më

vinte keq për ty e...

-Unë s'jam ndonjë plakaruq.

Djali nuk foli por shkoi në përrua për t'u larë. Gjatë darkës nuk folën fare, por kuptohej se seicili kishte diçka për të thënë, mjafton që të gjendej një shkak. Kur ra në shtrat, më shumë për të shprehur para gjumit atë që i ziente në gjoks, djali tha :

-Nuk do ta mbarojmë dot.

-Ne do të punojmë.

Djali nuk e priste këtë përgjigje. Ai kishte menduar se mjeshtri do të thoshte: "Do ta mbarojmë se s'bën!" Atëhere djali do t'i përdorte të gjithë fishekët, deri tek bomba, siç mendonte ai. Do t'i thoshte se ti je... je frikacak. Se ti nuk e kupton që ai tjetri të vë përpara detyrash të tillë, që të të ulë para syve tanë, pasi ne të nderojmë e të duam të të kemi me kokën lart...

Pas pak djalin e zuri gjumi. Ai nuk gërhiste, nuk lëvizte në shtrat. Në atë krah që binte, ashtu e gjente mëngjesi. Mjeshtri i mbante sytë të hapur dhe ndiente sikur në tëmtha i ishte ngulur një thumb grerëze. Ai djali që flinte si shqerrë, dy pëllëmbë më tutje, e kishte pickuar keqas. U bë dy herë që në tonin e zërit të tij ndihej mëshirë, keqardhje. "Dreq. fare, mos vallë jam bërë për t'u mëshiruar? Ndoshja jam bërë pa e kuptuar as vet, tamam ashtu siç na bëhet ves diçka pa dashgje. E na bëhet ky ves diçka e mendjes, e zemrës dhe mësohami me të, ashtu siç mësohami me ujin, me bukën, me gruan, me fëmijët. Kështu që edhe unë do të jem mësuar me mëshirën. Bukur, për nder! Pse s'thua që tani në fund, në vend ta mbyll me nder, siç i thonë fjalës, me kapak floriri, do ta mbyllkam me një derë haleje..."

Të nesërmen u ngrit po me këtë ndjenjë e me një shije bakri në gojë. Djali ende flinte po në atë krah që kishte rënë mbrëmja. Mjeshtri u vesh me kujdes, mori veglat dhe u nis për në punë. Pa mbrëritur mirë, në krahun tjetër u gjend edhe djali.

-Si fjete? -pyeti djali.

Mjeshtri lëvizi paksa dorën e djathtë. Djali kërkonte të thoshte diçka. Ai mendoi për një çast se tjetri i dinte ato mendimet e fshehura që mbante në kokë. I erdhì turp dhe shau veten. Pse mendoi aq keq për mjeshtrin? C'e shtyu? Ai ia hodhi fajin natës së errët dhe asaj barakës karakatinë. Ja, sot në mëngjes ndiente respekt e afërsi më të madhe për të. Ai kishte mësuar prej tij dhe këtë s'do ta harronte tërë jetën. Ai e kishte zili dhe ëndërr aftësinë e dorës së djathtë të tij, që ishte kthyer për kohësh në një njësi matëse të punës së mirë. Deri afërt, drekës ata kishin bërë goxha punë dhe

kishin qëndruar vazhdimesht të heshtur.

Dikur djali tha:

-Do ta mbarojmë, mos ki hall!

Mjeshtrit iu duk sikur tjetri i tha: "Mos vdis, i kam dhënë fund!"

-Po vetëm për një gjë do të të lutem, a do të ma plotësosh?

-Të pranoj lëmoshë prej teje. -tha mjeshtri.

-Të pranosh lëmoshë prej meje? Kush e tha këtë?

-Ti.

-Unë?

-Po atëhere pse ardhe me mua?

-Erdha të të ndihmoj.

-Të më ndihmosh...

-Nuk pranon?

-Ndihmë po.

-Djali heshti, fshiu djersët që i kullonin çurk e pastaj tha :

-Ti më urren!

-Nuk është e vërtetë.

-Derisa paske menduar aq keq për mua.

-Kam gabuar, -tha mjeshtri, i sigurtë që djali kishte thënë të vërtetën. Në qoftë se djali kishte ardhur me të thjeshtë i nisur nga një ndjenjë mëshire, do ta kishte pranuar patjetër. Ai ishte i bindur se djali nuk dinte të shtirej.

-Çfarë më kërkon, se jam gati ta kryej.

-Nuk është thjeshtë dëshira ime, -tha djali, -se sa nderi që duhet t'i bësh kësaj dore, -djali drejtoi gishtin tregues te dora e djathtë e mjeshtrit. Ai vështroi i çuditur dorën e vet.

-Po, po, për hir të kësaj dore, për ty, për mua e për të gjithë.

-Fol, -tha ai, duke vështruar sytë e djalit, që të kujtonin dy zjarre sipër në mal, -fol, se ka vdekur që do të ta plotësoj.

-Nesër, gjallë a vdekur, do ta mbarojmë këtë punë që kemi nisur, por me të ardhur ai sipërmarrësi këtu, dua t'ia përplasësh në fytyrë, t'i tregosh vendin atij mendjemadhi. Se ja ku po të betohem, në se do të të thotë gjysmë fjale, atje në rezervuar do ta mbyt!

-Ngadalë, -bëri mjeshtri.

Më të dëgjuar atë fjalë, djalit sikur i mbeti fryma. U ngrit me të shpejtë dhe iku. Tani ai u bind dhe u sigurua se, t'i kërkoje atij ndjenjen e guximit; ishte njësoj sikutr' ai t'i kërkonte vetes të fluturonte, drejt qiellit.

Kur ra natq, ai u kthyte në barakë dhe pruri përsëri dy bistakë

rrushi. Ndihej i gëzuar edhe pse përpiquej që të mos tregohej. E përshëndeti atë dhe u shtri në shtrat. Nuk kishte dëshirë të hapte ndonjë bisedë me të. Kishte arritur në një përfundim që e qetësonte mjaftë: kështu janë njerëzit. Nuk mund të mblidhen te një njeri të gjitha të mirat.

Gjumi po u fërkohej nëpër qepalla, kur po sillte ndër mend çastet e gëzuara që kishte kaluar edhe sot midis vajzave të vreshtit. Portretet e tyre i kishte aty përpara: Ja, ajo pikaloshja e gjatë dhe e lezetshme, ja edhe ajo që e thërrisin Roza, me atë krah të bukur bojë gruri, që i binin flokët e verdhë mbi gjoks, kur ulej të merrte arkën e rrushit, ja edhe...

-Sikur lamë një bisedë përgjysmë, -tha mjeshtri.

-Ti vet ia vure pikën, - foli i prekur tjetri. -Unë, po të kesh gjë për të thënë, të kam dëgjuar dhe do të të dëgjoj.

i pëlqeu ky pohim i djalit dhe vuri buzën në gas.

-Kur kam qenë i ri, ja, kështu si ti, kam qenë punëtor...

Edhe sot ashtu je, në këtë pikë ndryshimi është fare i vogël, por në të tjerat...

-Në cilat të tjera? Në rruhat? Në thinjat? ...

-Kjo do t'u ndodhë të gjithëve, -tha djali e, pasi u kollit, vazhdoi:

-Por unë dua të di, si ta them, djalli ta marrë!... I guximshëm, a ke qenë?

-Ta merr mendja.

-Po mirë, ç'është guximi, zog e të ka fluturuar nga gjoksi?

Mjeshtri u kapërdi me zor, por s'kishte mendim të tërhiqej dhe as djalin nuk do të linte të mbante në kokë atë mendim aq të keq që shfaqi për të.

-Të mos ngatërojmë nervat me guximin. Nervat e ndyjnë guximin. Dua të dal atje ku e nisa. Kur isha i ri, isha një brigadier që më ishte vënë keq. Jo se unë nuk punoja, por ai ishte nga ata që donte shumë lalelule. Unë s'ia jepja e nxehesha keq me të. Më mbërthenin nervat dhe ja, ai pikërisht këtë priste. Ma kishte zbuluar dobësinë, e s'ka njeri më të keq se ai që e di ku të dhemb ty. Se tamam atë plagë vete e gjakos. Dhashë, dhashë e vendosa të hiqja dorë nga fjalët me të. Iu kushtova i téri punës. Shkurt, atë kohë që harxhoja me atë, tanë po ia jepja punës. Guximi dhe gjallëria m'u shtuan dhe dashuria e shokëve gjithashtu. Iku vapa me gushtin. Plagën që ishte mësuar të ma gjakoste s'kishte ku ta gjente më. E, po dihet, murit me kokë nuk i bihet. Ai i ra deri sa e pësoi vetë... A më

dëgjon? Të zuri gjumi, or djali? Mirë, gjumë të ëmbël bëfsh!

Të nesërmen në mëngjes ata u ngritën më herët. Ende nuk kishte zbardhur dhe një erë e stohtë të thante fytyrën. Megjithatë e lanë vrapin tek objekti. Ishte dita e fundit e muajit dhe të dy ishin të mbërthyer nga shqetësimi i punës. As mjeshtri, as djali nuk donin që të ishin sadopak shkaktarë që firma të humbte këtë muaj. Herë-herë shikonin nga rruga kryesore se mos dukej sipërmarrësi. A s'u kishte thënë se ditën e tretë do të vinte patjetër? Por ja, po vinte dreka dhe ai s'po dukej. Djali punoi si asnjë ditë tjetër dhe pushoi për një farë kohe vetëm atëhere kur mjeshtri, tërë emocion, po bënte provën e përgjithshme te të dy rezervuarët. Paisjet ishin montuar saktë. Asnjë bulë nuk dilte prej tyre.

-Mbaroi? -pyeti djali.

-Të lumtë, -ia ktheu mjeshtri.

-Ai nuk po vjen.

-Ditë ka, do ta presim... Mos ke dëshirë të dalësh një herë andej, -ai bëri më kokë nga vreshti. -Shko, shko...

Djali hodhi këmishën krahëvë dhe iku. Mjeshtri zbriti në përrua dhe u la mirë e mirë. Pastaj vajti dhe u ul pranë barakës. Moti ishte i ngrohët dhe dielli në të perënduar i përkëdhelte fytyrën. Dremiti për disa çaste. Ashtu kujoti, por në fakt ndënji ashtu siç ishte për më se një orë.

'Si nuk erdhi? Kur na nisi bëri namin", tha për sipërmarrësin e firmës.

Ndërkohë pa se drejt tij po vinte djali. Iu duk i mërzitur dhe vërtetë djali në gjendje të tillë ishte. As rrush nuk kishte prurë me vete. Ç'të ketë ndodhur? -mendoi ai, dhe kur tjetri u ul pranë tij, e pyeti :

-C'ke këshfu?

-Asgjë, -iu përgjigj djali, që patjetër diçka fshihte, se mërzitja i lexohej dhe në fërfëritjen e buzëve.

-Ai nuk erdhi, -foli dhe u ngrit. Hyri në barakë dhe u shtritë në shtratin e vet.

Mjeshtri rrudhi buzët dhe mblođhi supet. Nisi era e freskët e imbrëmjes dhe ai hyri brenda. Nuk kaluan shumë çaste dhë në shesh u dëgjuan zëra vajzash. Djali u ngrit ndjenjur dhe mbajti vesh. Pastaj njera nga vajzat i thirri dhe ai doli jashtë. Mjeshtri po veshtronte nëpërmjet derës gjysmë të hapur. Një vajzë me flokë të gjatë e të verdhë, i zgjati djalit një shëjtarë me rrush dhe i lutej ta merrte. Ndersa tjëtra, një pikaloshë e shëndetëshme, i thà

-Mirë ia bëre atij tē poshtrit. I është qepur Verës si rrodhe dhe nuk e lë rehat.

-Ne po tē kërkojmë tē falur, -tha ajo me flokët tē gjatë, - mos na e prish qejfin, se s'dihet kur do tē takohemi përsëri.

Djali mori shportën, u nda me to dhe hyri brenda.

-Me kë qenke zënë? -pyeti mjeshtri.

Tjetri nuk u përgjegj. La shportën me rrush mbi tryezë e u mat tē ulej, por ndrroi mendje dhe ashtu në këmbë, siç ishte, foli :

-Mbrëmë, kur më pyëte në flije apo jo, nuk më kishte zënë gjumi. Ti më urove natën e mirë, mos kujto se unë nuk ta ktheva. Tërë ato që më tregove i kuptova dhe aty për aty vendosa se do tē përbaheshë më tepër. se nuk do tē nxehesha, po ja, nuk kaloi veçse një natë gjumi e disa orë ditë dhe e shkela premtimin, se vajti e më ndodhi ajo që dëgjove... Qëllova dikë, qëllova se nuk e durova dot!

-Pse, si qe puna?

-Më shau, më tha vjedhës, -u hakërrua djali.

Sytë sikur i lëshuan xixa. Mbertheu shportën dhe u bë gati ta flakte jashtë. Mjeshtri e mbërtheu nga supet.

-Ty, ata bistakë rrushi, t'i jepnin vajzat?

-Po, ato m'i jepnin. Ndërsa ai, që më tha vjedhës, më paska thënë për qëllimin tjetër jo se i qenka djegur barku... ai paska qenë...

-E dëgjova bisedën tënde me vajzat, -e ndërpree tjetri. -Dhe...

-... dhe e kam unë fajin e duhej ta kisha duruar, është...

-Jo, -tha mjeshtri.

-Si? -djali priste me ankth se ç'do tē thoshte më tutje.

-Mirë ia bëre, -ia ktheu tjetri. -Kur duhet, grushti është ilaç, -përfundoj mjeshtri.

Djali e vështroi pjerrtazi, sikutr donte tē zbulonte e të sigurohej për vërtetësinë e fjalëve që dëgjoi. Pas pak u çel në fytyrë dhe sytë e thellë shparndanë ngrohtësi. Mjeshtri i shkeli miqësish syrin dhe tē dy nisën tē qeshin.

-Ai nuk erdhni, -tha djali.

-Kurrë mos ardhët. Ne, ç'kishim për tē bërë, e bëmë, -tha mjeshtri. -Unë tanë do tē shtrihem. Do tē flë. Ah, ç'kam për tē bërë një gjumë tē gëzuar!

S'kaloi shumë dhe ai u shtri. Djali rregulloi shtratin e vet. Hodhi edhe një herë sytë nga mjeshtri dhe me tē vërtetë iu duk se tjetri po bënte një gjumë tē bukur, tē gëzuar, tē qetë. Vetëm dórë e djathët i lëkundëj lehtë-lehtë. Djali iu afrua, ia mori me kujdes dhe ia vuri mbi gjoks.

## **SHAKA E HIDHUR**

**I** quanin komisarë të dritës, edukatorë, pishtarë, mirëpo tani, të dy djemtë, të cilët jo më larg se një vit më parë, kishin qenë të rrëmbyer dhe tërë entuziazëm prej moralit të tyre, madje kishin trajtuar në sa e na sa tema - hartimi, tani që atë punonin si mësues në një fshat të Lenijes; nja 6 orë larg Gramshit, po e kuptionin vlerën reale të atyre llogove. Shkolla ishte ndërtuar mbi një rrëpirë, ku edhe dhitë e kishin të vështirë ecjen. Nxënësit, përveç mirësisë së fëmijës, ishin për të qarë hallin, veshur keq dhe ushqyer akoma më keq. Buka e misrit, një misër i verdhë dhe i thartë, zinte gjysmën e çantave të librave. Ata, të dy ishin të lindur dhe rritur në qytet, tepër larg këtij realiteti, kësaj mënyre jetese, por megjithatë ata përpinqeshin të mos kapitullonin para kësaj monotonie, para kësaj mërzitjeje. I vetmi mjet argëtimi dhe që ata e shfrytëzonin shumë, ishte një radio e vogël, dore, blerë së bashku me rrogat e para, por dhe kjo erdhi një ditë dñe u vu në trezik. Shefi i partisë në fshat, kishte deklaruar në një mbledhje se të dy mësuesit dëgjojnë muzikë të huaj: Pas kësaj dëgjimi i radios bëhej vetëm në dhomën e fjetjes,

them i dhomë fjetjeje e të vjen për të qeshur e për të qarë. Dy shtretër prej dërrase. Një dritare sa të futje grushtin, një dollap ushqimi që ishte përdorur me siguri në fillim të shekullit. Po bëheshin tre muaj që ata jetonin këtu, dhe po t'i pyesje, të dy të thoshin se po mbushnin 30 vjet.

Atë javë ranë shumë shira. Në një ndër këto netë, ata s'vunë gjumë në sy. Ç'shi kishte rënë jashtë, kishte kulluar edhe brenda. Djemtë kishin mbërdhirë dhe dridheshin si dy zogj të vegjël tek qoshja. Mërzitja kishte arritur në pikën e vet dhe të dy tashmë e kishin bërë me mendje se duhej ikur sa më parë, të braktisnin me punë e me dreq e t'ia mbathnin për në qytetin e tyre. Por ja që prisnin çdo të thoshte shefi i Partisë, i cili ishte lajmëruar dhe pritej të vinte. Nuk vonoi shumë dhe ai u dha në dhomë. Hetoi rreth e qark dhe, si me përtim, ngriti sytë drejt tavanit, i cili ende pikonte.

-Çudi, -tha, -vjet nuk pikonte!

Shprehje më idiote djemtë kurrë nuk kishin dëgjuar. Toni, më i serti u përplas mbi dëngun e rrobave të lagura, por ndërkokë, një vështrim kuptimplotë i ardhur prej Nikut, që ishte tepër më i urtë se ai, sikur e qetësoi. Ai-tjetri u largua, ashtu siç hyri, pa u përvendetur.

-Ky është derr, derr! -shfryu Toni.

Niku buzëqeshi, vuri gishtin tregues mbi ballin e shokut dhe tha:

-Mos na prish punë. Të e di që të shtunën unë martoj motrën.

-Edhe unë mbas teje do.të vij, -tha Toni. -Më ka marrë malli edhe për gurët e lagjes e jo më për njerëzit e shtëpisë. U bënë tre muaj që s'kemi vajtur një herë në familje... edhe ushtarë të ishim...

Kjo ishte e vërtetë. Të dy po i zhuriste malli. Kurrë s'ishin larguar për kaq kohë nga njerëzit e tyre. Kishin kërkuar leje edhe herë të tjera, por ja, ai i Partisë do të gjente e do të gjente një arsy që t'ua rfeuzonte. Me të mbaruar ato 3-4 orë mësim, ai u kishte vënë detyrë që një mbasdite t'u bënin sqarim politik fshatarëve atje në arë, e një ditë të shkonin në vatrën e kulturës për të propaganduar librin, kryesisht atë politikun, pasi për të, të tjerat ishin punë kalamajsh.

Çdo të djelë, që në orët e para, vinte e i zgjonte, dhe së bashku me ta, në mes të një skuadre nxënësish, zhvillonte aksionin e higjenizmit, sipas një modeli të një shkolle kineze. Djemtë ishin mërzitur, veçanërisht loni me zor po mbahej. Disa herë kishte vendosur ta braktiste fare punën, por ai e dinte se ishte bir i një

familjeje të madhe dhe rroga e tij ishte për tërë ato frymë, pastaj edhe për Nikun i vinte keq. Nuk mund ta linte vetëm. Tek i vetmi njeri që ata shpresonin se mund të krijonte një mundësi për t'u dhënë qoftë dhe 2 ditë leje, deri tani së fundi, kishte qenë ndihmës mjeku, i cili vinte në fshat 3 herë në javë, por edhe ai ua preu. Për një rast të tillë, ai kishte lëshuar një si biçim recet-raport dhe e kishte paguar me prerjen e rrögës për 15 ditë. E vtmja gjë që mund të bëj për ju, u kishte thënë ai, - është t'u bëj analizat...

-Ç'analiza? -kishte pyetur me habi Niku.

-Po ja, gjakun, urinën e t'ua çoj në qendër. Po ju me siguri që s'kini gjë. Nuk jeni të sëmurë.

-Ta merr mendja. -ia ktheu Toni. Veçse në pranon të të japim shurrë nga kali i rojes së shkollës, se për të dëgjova para nja dy ditësh që veterineri po i thoshte plakut të shkretë se kish rrezik t'i ngordhëte kali...

-Ti kërkon të tallesh, -ia kishte kthyer ndihmës mjeku e me kaq ishte mbyllur biseda me të, por ama, edhe shpresa e vetme ish djegur. Kështu që ata u detyruan përsëri të përplaseshin tek shefi i Partisë i cili, me të hapur gojën ata, u tha ta mbyllnin, por kur dëgjoi arsyen e Nikut për martesën e së motrës, ai sikur u përtyp. E, pra, ja kjo ishte marrë si shenjë e mirë dhe ata ishin gati sikur ai t'i urdhëronte që t'ua bënin sqarimin politik fshatarëve jo ditën, por edhe natën për tërë natën, nuk do t'ia kthenin. Prandaj, jo pikë shiu të binin nga tavani, por sikur edhe me gjyma të gurgullonte uji, Toni s'duhej të nxehet, të paktën deri të shtunën në mëngjes, kur ata të mirrin lejen. Të vraponin 6 orë në Gramsh e, me ndonjë makinë të rastit, drejt e në Elbasan. Ajo do të ishte vërtetë një ditë e mrekullueshme. Të dy kishin filluar të përshkruanin rrugën që do të bënin, takimin e papritur me njerëzit e tyre, puthjet e përqafimet me prindërit, motrat e vëllezërit. E pastaj, Toni, do të vishej më bukur e do të shkonte në dasmën e motrës së shokut të vet dhe do të shkonte si ndër dasamorët më të nderuar.

Ndërkaq ata ishin bërë gati për në shkollë, kur ja, aty tek gardhi u dha përsëri shefi i Partisë.

-Djema, -thirri ai. -Ajo faqe e malit u pastrua. Brigada e çpyllëzimit kishte bërë një punë të mirë. Gëlqere ua kam gjetur, gurët dot t'i gjeni vetë.

-Për çfarë? - habit Toni.

-Do të shkruhet ajo parrulla e madhe atje.

Niku e la një hap prapa Tonin dhe i foli shtruar:

-Po ti sikur na premtove...  
-Harrova, harrova, -tha ai. -Jemi në Nëntor dhe Nëntori është muaji i festave.

Po pse, dasma e motrës sime nuk është festë?  
-Dasma nuk është festë politike. Këto më duhen mua. Filloni sa më parë...

-Mut... -hungëriu Toni.

-Si the? - bërtiti tjetri, por nuk e zgjati, iku.

Ata, si me urdhër, u ulën njëri mbi një gur e tjetri tek kërcuri pranë këmbëve. Nuk folën për disa çaste. Më në fund Niku brofi në këmbë.

-Unë do të iki patjetër, të bëhet ç'të bëhet, -tha dhe u nis-për në shkollë. Diku i thirri Tonit, por ky nuk iu përgjegj. Atij diçka i feksi në mendje. Diçka po kurdiste. U pa të bisedonte, pas pak, me rojen e shkollës. U pa të bisedonte përsëri aty nga dreka dhe në mbrëmje kërkoi në tërë fshatin deri sa e gjeti ndihmës mjekun. Kur u kthyte në dhomë, qeshte apo s'qeshte me veten. Niku po bënte çudi.

-Të jesh i sigurtë që ti do të jesh i pranishëm në dasmën e motrës dhe patjetër edhe unë.

-Do të na përajshtojnë, do na përzenë nga puna.

-Budalla, -qeshi Toni. -Do ikim me leje, ke për ta parë. Më tepër si e qysh nuk i tregoi, por tepër i sigurtë, madje e ftoi Nikun të vinin bast, në se nuk e besonte. Dy ditë më pas ishte e premte. Ende s'kishin dalë nga dhoma, kur u dha aty ndihmës mjeku.

-Analizat kanë dalë keq. Bëhuni gati të niseni.

-Ç'analiza? - u habit Niku.

-Analizat e urinës. Ta merr mendja që do të na dilnin keq. Harrove Nik që mezi e ghidhive mbrëmë prej veshkave. -ndërhyri Toni, duke ia shkelur syirn dhe sakaq i tha ndihmës mjekut që të priste jashtë.

-S'po kuptoj gjë! - tha Niku.

Ai zuri të tregojë, gjithnjë duke qeshur, se urina që kishte shkuar në laboratorin e spitalit të Gramshit, kishte qenë e kalit të rojes së shkollës. Atëhere te dy ia plasën gazit.

-Me të mbrritur në Gramsh, gjemjë një makinë të rastit dhe fiu në Elbasanin tonë të shtrenjtë.

U përqafuan dhe tërë gëzim u veshën. S'kaloi shumë, ata të dy, së bashku me ndihmës mjekun, u nisën përrugë. Në të thyer të ditës, ishin pranë kodrës më të afërt të qytetit, nga aty dukej qartë

rruga që të conte në Elbasan dhe pikërisht atë çast, të dy djemtë po përfytyronin veten të lumtur kur do të takoheshin me ujerëzit e familjeve. Ah, ç'gëzim do të shpërthente! Tre muaj pa u parë s'është pak! Me të hyrë në qytet, ata s'mundën të bënin asnjë hap më tej. Një ambulancë dhe disa civilë nervozë, me siguri nga që kishin kohë që prisin, i hipën me nxitim dhe ndërkohë po ashtu, madje dhe me sirenë, ambulanca çante në rrugën kryesore. Shumë shpejtë mbrritën në spital dhe i vendosën në një dhomë të katit të tretë, veçse ajo pak ngjante si një dhomë spitali. Të dyja dritaret ishin të rrethuara me hekura dhe aty tek dera qëndronte palëvizur një polic. Me siguri do të ishte dhomë izolimi.

-Po na marrin për të çmendur, -qeshi Toni më tepër si për t'i dhënë kurajo shokut të tij, që s'po e kapte dot fillin.

U err plotësish. Kaloi dhe një natë e tërë dhe atyre kurrkush nuk u kishte dhënë qoftë edhe një shpjegim çfarëdo. Polici aty tek dera u duk vetëm kur futi nja dy herë supë me ca rriska të hollë buke. E shtuna u gdhi po në atë gjendje dhe po ashtu po vazhdonte, madje më e ngarkuar sepse shpresat se ata mund të niseshin për në Elbasan, nuk dukeshin kurrkund. Le që kot, se as që mund të bëhej fjalë fare se mund t'i nxirrin prej aty. Kryelaborantja s'kishte mundur aspak të konkludonte nga analiza e urinës dhe si për të qenë më e qetë, e kishte nisur për në spitalin e madh të Elbasanit, duke dhënë alarm se dyshonte për të dy patientët, që mund të ishin përhapës të një sëmundje të tmerrshme infektuese, prandaj dhe kishte kërkuar izolimin e tyre. Të shtunën nga Elbasani nuk erdhi përgjigje. E djela kaloi si çdo herë tjetër. Të hënën në drekë, spitali i madh i Elbasanit njoftoi se i kishte nisur analizat për në laboratorin e Institutit të Kërkimeve Veterinare në Tiranë. Vetëm të martën paradite mbrriti përgjigja e saktë: leptospirozë në gjak! Sëmundje që shfaqej kryesisht ndër kuaj dhe jo tek... Këtë përgjigje ua bëri të ditur po atë të martë të dy djemve, vet përgjegjësi i arsimit të rrethit, i shqetësuar edhe prej shefit të Partisë së fshatit që ishte thirrur urgjentisht.

-Që të dy jeni të pushuar nga puna! -tha ai dhe iu drejtua shefit të Partisë. -Ju keni ndonjë mendim?

-Unë jam dakort me masën tuaj, por unë them se këta jane larguar nga fshati me një qëllim tjetër, se atje në fshat, shoku shef, tamam këta ishin ngarkuar të shkruanin një parrullë të madhe që...

-Ka organe të tjera që do të merren me këtë problem. -e ndërpren ai dhe duke i futur krahun dolën prej dhome.

Nikut i ishin mbushur sytë me lot. Edhe Toni s'ishte aspak

në gjendje më të mirë, por duke qenë më kurioz , tha :

-Punë e madhe, punë e madhe. Nik! Mua për një gjë më vjen keq: që ti se përcolle dot tët motër, por s'ka gjë, ne do të vemë bashkë, ja kështu siç jemi, në shtëpinë e saj të re... dhe tani eja, vëlla, eja të largohemi nga kjo hale e mallëkuar.

Bënë të dilnin, por polici, që ende qëndronte aty, i ndali.

-Kthehuni prapa! Nga çasti në çast pritet të vijë këtu vet Prokurori i rrëthit, - dhe ndërkohë plot tërsëllimë ua përplasi derën në fytyrë.

# BARESHA ME SHAMI NEJLONI

*Novelë*

## 1.

**N**usja e djalit të madh, Bardha, e kishte për të tretën, a të katërtën herë, që dilte jashtë prej një heqje barku. I pat filluar apo mbaroi ajo darka madhështore, shtruar me rastin e 75 vjetorit të vjehrës së saj. Tujje, në oborr, aty nën fikun e madh ku ishte ngritur një banjo fushore, e cila sidomos gjatë verës, pasi u lehtësua diçi, ajo shtyu derën prej lese, por s'bëri dot një hap më tutje. Një e prerë si me thikë i ra bârkut tej e tej. Por vetëm aq. I kaloi shpejtë. Bëri disa hapa përpara, u mbush me frymë. Atë çast ia pati qejfi të qëndronte aty, në vetmi dhe në hapsirë. Ndoshta nga që s'donte të bënte më ato ecejaket shtëpi-banjo, kur të tjerët kishin mbi tre orë që e bënin gjumin gjumë, a ndoshta nga që edhe ajo natë qe vet mrëkullia e të grishte për tu shkrirë me të. Një qiell i magjishëm korriku, i lartë, mbushur me cicërima yjesht, me këngën e bulkthit, me një fllad jetëdhënës, sikur e përpinte dhe e kridhte në një si lëndinë ëndërrimtare..

Nën shegën e vetme të kopështit, ku ishte ulur tani, nata përjetohet nga tërë qenia e saj, disi e lodhur, e drobitur. Më larg, dritëza e vënë tek hyrja kryesore e shtëpisë, nën degët e shkuluarura të shegës, dukej tamam si yll nate, duke fshirë lehtas kufirin midis qjellit dhe tokës. Nuses i dukej vetja se lodronte në atë hapësirë të errët, por aq ndjellëse. Do që vërtetë po ndihej më mirë. Aty e kuptoi se ç'barrë të rëndë kish mbajtur mbi vete. Ajo kishte qenë kryekuzhinjerja e asaj darke. Për orë të tëra pranë zjarrit, e djersitur dhe e rrahu pamëshirë prej korenteve të rastit, atë e brente vazhdimisht meraku i cilësisë së gatimit. Të kënaqeshin të ftuarit, njerëzit e shtëpisë, e, mbi të gjitha, sebepçia, vjehrra, që. në kësi rastesh, ta bënte qimen tra pa fije ngurrimi. E, pra, ajo e kishte kryer detyrën me sukses. A nuk kishte qenë vet vjehrra, ose nënëmadhja siç e thërrisin të gjithë, që, disa herë rresht gjatë darkës, e kishte kërkuar Bardhën ta kishte pranë vetes? Por kjo e kish refuzuar me takt, duke lenë të kuptohej se lumturia e saj është të kënaqurit e të tjerëve, se herë tjetër, në një rast të përafërt ajo do të vraponte aty, pranë nënëmadhes, vetëm e vetëm që të ndjente pak ngrëhtësine e saj. Ajo kishte adhurim për të, sa shumëkush, që s'nihi as njëren, as tjetrën, do ta ngatërronte me servilizmin e rëndomtë, por do të gabohet. Bardha, që kur kishte hyrë në këtë shtëpi, vite të shkuar, s'kish qenë gjë tjetër, veçse një çupëlinë e zakonshme, e cila s'kishte ditur të bënte qoftë dhe një sallatë të thjeshtë. Tani artin e gatimit të pastërtisë dhe të nikoqirillëkut, ia kushtonte vetëm asaj, vjehrrës. E, se mos vetëm kaq! Edhe autoriteti i asaj familjeje të madhe, që deri tani kishte martuar tre djem e një vajzë dhe kishte pritur mbi dhjetë nipër e mbesa, për strumbullar nënëmadhen kishte pasur. Ajo, e vetëm ajo, priste e përcillte, ajo e nxirrte rakinë dhe gjithnjë në krye qëndronë vetë, me përjashtime të rralla; kur miqtë ishin të largët, për nga gjaku e jo nga rëndësia, nxirrte në krye të shoqin. Ai një shulak, i zbardhur fund e krye, çalaman qysh nga koha e ushtrisë, ku një oficer madhor, qejfli gjahu, e përdorte për t'i prurë thëllëzat a lepujt në pritë. Gabimisht ia kishte zbruzur çiften në thundrën e majtë. Po si mund të ishte lidhur martesa e nënëmadhes me këtë plakuriq, që zor se do të kishte qenë më i pashëm se sot, as në kulmin e rinisë së vetë?! Këtë pyetje Bardha e pat bërë qysh atë ditë kur vuri këmbën në këtë shtëpi, vite të shkuar, kur vjehrra vërtitej diçka mbi të 40-tat, por që ndriste me bukurinë e një njëzetëvjeçareje, kur ende linjat e vajzërisë ruheshin si me magji tek trupi i saj i drejtë e lakmitar. Kulmi i kësaj çudie arriti kur nusja e madhe vuri re se vjehrra flinte

në dhomë të veçantë, e ndarë nga çalamani, që, me sa i kujtohej tani aty nën shegë, s'mbahej mend pa qimet e bardha në fytyrë. E pra, atë zakon ajo vjehrra e saj e ruajti edhe pasi erdhën dy nuset e tjera, edhe pasi shtëpia u mbush me kalamaj. Dhe në atë dhomë nuk hynte dot kushdo, me përjashtim të Bardhës, që kishte për detyrë të ndrronte buqetën me lule mëngjes për mëngjes. Kaq, vetëm kaq! Shërbimet e tjera ajo i bënte vet: shtrati, shtresat, mbulesat, ndrresat, çdo gjë i takonte asaj e vetëm asaj. E tërë dhoma e vet i nënshtrohej përkujdesjeve të saj, një përkujdesje dhe merak që i befasonte të tria nuset, të cilat, heshtazi por kuptueshmë s'uronin gjë tjetër veçse të kishin një pleqëri të bukur, të pastër e të hijshme si të nënëmadhes, së cilës i vinte si në trup, si në të linjta dhe në odë erë lulesh... Këtë zakon nuk e harroi as atë natën që mbushi 75 vjet. U ngrit dhe me hapin e saj, ende energjik, shkoi në dhomën e zjarrit, ku varte diku çelësin e dhomës. U kthye e nisi të përcillte të ftuarit. U vonua më tepër kur përcollitë bijën, Faten. Ato të dyja, nënë e bijë shkonin si të ishin shoqe... Bardhës, që tani ishte qetësuar plotësisht s'i bëhej kurrsesi të hynte brenda në shtëpi. Gjumin ia kishin përzënë kujtimet, që po i buiçnin si ujë burimi. Nata e korrikut, thellësisht e qetë, edhe pse gati po thyhej, i nxiste fantazinë. Bardha e dinte mirë se Fata, pa nënëmadhen, zor se do të ishte ajo që është sot. Në të vërtetë Fata ishte për t'u patur zili. Siç thoshte shpeçh e ëma. "Në se u kap kureshtja të dini si kam qenë unë e re, ja shihni Faten...", por Fata tani është me dy fëmijë dhe prapëseprapë i thoshte hënës dil të dal. Ajo kishte një shtëpi gati vilë. I shoqi ishte ndër afaristët më të suksesshëm të kësaj ane, madje vitin e fundit ai kishte nisur të investonte në turizëm, në bregdetin e Jugut. Megjithatë, kjo e shumë të tjera që i takojnë Fatës, pa nënëmadhen mund të kishin mbetur ëndërra, ëndërra...

Nusja e madhe kujtoi atë kohë kur njeri prej kunetërve të saj, ai i mesmi, me të dalë nga burgu, këmbëngulte ta martonte Faten me një ish shokun e vet. Vëllezërit e tjerë nuk hynë në këtë mesele, por kunati i mesëm kishte përkrahjen e çalamani dhe gati e fitoi davancë. Pikërisht në këtë çast kishte ndërhyrë nënëmadhja, që, aty për aty, sajoi se gjoja Fata na paskej rënë në dashuri me dikë dhe "... ai shoku yt, -i ishte kthyer të birit, -po ta marrë vesh këtë të vërtetë, zor se do ta pranonte lidhjen me Faten..." Kjo ra si rrufeja në quell të kaltër. Madje jo vetëm mbi kunatin dhe vjehrrin, por edhe mbi vet Fatën, e cila kurrë s'kishte hapur një bisedë të tillë me të ëmën. Aty për aty nuk u ndie dhe bëri mirë. Dy ditë më pas, vajza i tha së ëmës se ç'ishte ai llaf që nxorri nga goja, kur vet s'i kish thënë gjë. "Nuk

më ke thënë, -ia ktheu nënëmadhja, -por para se të flisje ti, moj bijë, flet pasqyra. A nuk e sheh që ia ke hequr gjithë ndriçimin?" Kështu u mbyll ajo e keqe dhe Fata u la na fatin e vet.

Si përçollti të bijën, Faten, nënëmadhja hyri në dhomën e ngrënies, ku ende ishin ata të familjes. Takoi në fillim djemtë. I puthi të tre, ashtu bëri edhe me nuset; i dha dorën plakut, porositi që nipërit dhe mbesat në dhomën e madhe te pushonin ahengun. Aty tek pragu u kthyte paksa dhe kush ishte i vëmendshëm shquajti lotët që i rrodhën si kokërrza breshëri nëpër faqe.

## 2.

Nusja e madhe, që ende vazhdonte të rrinte nën shegë, hapi grushtin e dorës pavetëdije. A thua po blidhite pikërisht ato kokrra lotësh. Po pse qau... pse? Mos vallë nga që u plak! Hëpërhë nuk i jepete dot përgjigje kësaj pyetje. Pse sot c mori vesh ajo se mbi të rëndojnë 75 vjetë? Ajo është e lumtur, e lumtur padyshim. Çdo donte më tepër një nënë? Shtëpinë plot djem, nuse, nipër e mbesa e mbi të gjithë atë Faten e saj që e ka mirë e t'umirë. Nënëmadhes s'i ka qarë syri kurrë! Po sot ç'i pati ata lot? Apo të rit, të rit e saj... dhe shiko-shiko, m'u mbush trupi me mornica. Nuses iu mblohdh një lëmsh në grykë. Rinia e vjehrrës, nënëmadhes, kishte qenë vërtetë një tragjedi. Bardha prej vitesh kishte dëgjuar historinë e dashurisë së bareshës me shami nejloni, që s'ishte për kërkënd tjetër veçse për vjehrrën e saj. Ajo e kishte dëgjuar atë histori nga gra dhe nuse të lagjes dhe s'ishte thjeshtë thashethem, që lind livadheve a mullarëve, por ishte një e vërtetë, të cilën e kishte vulosur gryka e kobures dhe koburia s'di të lindë thashetheme. Baresha me shami nejloni e kulloste grigjën e vet pranë repartit ushtarak. Aty ajo ra në dashuri me Kapitenin e Artilerisë, një djalë i gjatë, lastar, me mustaqe spic të zeza, e me ca sy që të përpinin të gjallë!

Shkak për këtë dashuri, me sa i kujtohej Bardhës na paskëj qenë manari që baresha me shami nejloni, mbante pas vetes, ashtu siç mbanin tërë shoqet e veta. Një manar lara-lara, me një këmborkë të vogël si dorë fëmije, që pasi puthej e përkëdhelej prej bareshës, vidhej prej saj dhe, duke tundur atë kokën e bukur me atë këmborën e vogël, zhdukej për ca kohë matanë gardhit të repartit. Zemrën e manarin ná e paskesh fituar dhe ai dreq kapiteni. Edhe ai bënte me manarin po ashtu siç bënte baresha. Kthehej manari po aq gazmor, veçse këmborka e vogël nuk tingëllonte. Natyrishët që në fillim bareshës me shami nejloni kjo gjë nuk i ra në sy, por më vonë ajo

zuri tē shqetësohej pér këmborkën. Dhe ja, një ditë kur e kontrolloi, hoqi shukun e barit nē tē dhe papritur ranë mbi dorën e saj karamele. Baresha qeshi. E befasuar vështroi përqark. Mendoi se dikush prej shoqeve e ka bërë atë lojë, por kur loja përsëritez nga dita nē ditë, deri sa më nē fund prej këmborës ra një shami nejloni, asaj i ngriu zemra. Në atë anë një dhuratë e tillë s'ishte thjeshtë lojë, jo! Kaq gjë baresha e dinte. Kush e dërgonte atë? Ajo pa diku larg saj Kapitenin e Artilerisë, i cili qeshte e qeshte. Ajo bëri me vrap tutje, a thua ai i kishte zënë diellin, por e pati tē pamundur tē largoje nga përfytyrimi i saj atë tē qeshur tē shkrepëtimtë, aq tē pastër. Ditë më pas, këmborka binte çokollata, çamçakiz dhe një herë pruri dy gisht letër: Kapiteni i artilerisë i tregonte emrin e vet dhe kërkonte... Nga ajo ditë vajza e ndaloi manarin tē shkonte matanë. Kafshëza e gjorë nuk po i bindej, madje shpërthente nē një blegërimë vajtimtare. Kapiteni i bënte shenjë që ajo t'i dërgonte manarin. Vajza qeshte dhe fshihej gjithnjë me një sy hapur drejt tij. Erdhi një ditë e ajo vendosi t'ia rikthente lirinë manarit. Nuk e duronte dot zemra e saj tepër e njomë atë blegërimën vajtimtare, pastaj pse tē mos e themi hapur: edhe një si dëshirë e kishte pér ta vazhduar atë lojë që herë-herë ia mbushte shpirtin me ca gurgullima krojesh e zérash. Së fundi, kapiteni me anë tē këmborkës i dërgoi një letër më tē gjatë, ku i betohej dhe i përbetohej pér dashurinë e tij. Baresha e lexoi me dhjetra herë atë letër dhe i bëhej sikur Kapiteni i Artilerisë, diku sipër kokës së saj, i gjatë dhe i bukur, qeshte nën ato mustaqet spicë. Pér një çast ai iu shfaq vërtetë aty. Atë kohë baresha, si me inat, vuri grigjen përpara, por manari i saj lëpihej ende tek çizmet e kapitenit. Ajo sikur u nxeh, e ndolli me blegërimë dhe manari ia dha vrapit drejt e tek zonja. Vajza, ashtu po me inat, ia hoqi këmborkën nga qafa. Kapiteni i Artilerisë u ul befasisht nē gjunjë dhe zuri tē rrahë tokën. Baresha s'e dha veten, por më t'u kthyer brinjazi seç ndjeu një tē piskuar mu nē zemër. Hodhi edhe një herë vështrimin pjerrtas drejt kapitenit. Ai përsëri rrihete tokën. Vajza ngau rrugën. Aty nē kthesë ia vari përsëri këmborkën manarit, ndërsa tē nesërmend, kur ende dielli s'ishte ngritur mbi dy hostenë kur ende vesa shndriste livadheve, ajo u pa nē kullotë përsëri me grigjen e vet, po me një ndryshim tē madh, që e detyroi kapitenin tē vepronë si i ndërkryer, duke bërë ca kollotumba prej tē çmenduri e tē hidhej e tē kapërcente dy e nga dy mbi shkure e gëmusha. Baresha kishte lidhur nē kokë shaminë e nejlonit, tē dhuruar dikur prej tij. Kaq u desh! Kapiteni fluturoi pran saj: e rrëmbeu pér beli, e puthi nē gushë e nē buzë,

duke u betuar se dëmbante këtë kukull të bukur e të pastër, ja, mu aty në xhepin e tij. Por s'qe e thënë! Ajo dashuri u pre e u hodh tutje, thjeshtë si një gjë pavlerë, tamam kur ishte në pikun e vet. Vjaza ishte marrë si bijë me shpirt nga një teze e saj. Kështu që tezja, bashkë edhe me të shoqin, një xhahil i vërtetë që kurrë nuk thoshte "shëndet", me siguri diçka kishin nuhatur a dëgjuar, prandaj lajmëruan urgjentisht njerëzit e asaj miqësie që ishte lidhur kur vajza s'ishte më tepër se dy vjeç. Ajo qenekj fejuar ende bebe dhe nderi e zakoni e donte të mbahej fjala. Pala tjetër u përgjegj se ishte e gatëshme: e në se ishin vonuar deri tani, shkak ishte bërë se djalit të madh ende s'po i dilte fati, sepse fejesa e taksur për të, ishte prishur për ca arësy që s'ishte vendi të tregoheshin. Ata do ta rregullonin vet atë të keqë. Nusja të bëhej gati për djalin e dytë, për atë që ishte caktuar. Këtë Bareshës ia rrëfyen në të hyrë të vjeshtës. Ajo e humbi. U hutua. U lig dhe lutej nga mëngjesi në mbremje, në se kishte zot, le t'ia merrte jetën! Ajo diçka kishte dëgjuar për këtë fejesë, ato zëra i vinin si nga një kohë tjetër e largët, e harruar. Ca më tepër që për vite të tëra kurrikush s'ia pat zënë në gojë. Dhe ajo gjithnjë e kishte quajtur punë të myllur, madje dhe të turpëshme. Tani, si nëpër një mugëtirë plot ciknë, i erdhë në mend se, ende e parritur mirë, ia kishin treguar atë, bandillin: një kokëmadh, flokiriq, dhe me një trup prej bualli. Kurrë, kurrë! -betohej vajza e gjorë. -Po kush e dëgjonte? Me tezen mundi të këmbente dy fjalë, por edhe ajo më e tulatur se një pulë, e drejtonte tek ai nursëzi, i shoqi, që deklaronte me mburje dhe arrogancë se tërë brezi i tij mbi këto marrëveshje ishte martuar, se përndryshe nuk do ta njihte qeni të zonë.

Nga ana e vet, Kapiteni i Artilerisë, thurte plane se si ta rrëmbente vajzën. Dashuria për bareshën, që gjer dje ia shtronte rrugët me lule, tashmë iu shndrrua në një dhembje që i dukej se do ia brente jo vetëm kockat, por edhe ëndrrat. Ajo i ish shndrruar në një si flakë, që e ndjente se i vaponte nëpër gjak. Por për dreq, guximi që kërkohet në të tillë raste, i shuhej më shpejtë se flaka e kashtës dhe ai e shikonte vetveten vocërrak.

Tutorët e vajzës dhe të afërmit e tyre sajuan për të turli farë broçkullash magjie. Herë i vinin bar nën jastëk, herë i fusnin kocka zogjsh nëpër xhepa e, kulmi arriti kur vajza gjeti një shuk lesh maceje në rracionin e bukës. E trembur, e drobitur, pa asnje përkrahje, ajo po shkonte drejt gjunjëzimit. Kjo e detyroi kapitenin të hiqte dorë prej planeve në letër e të përballej vet me tutorët e vajzës. Po pse tertiqeshin ata! Në një çast të tillë, kur e pa veten fillikat, por i

papërkultur siç ish, aty hapur tha se në se ata nuk pranonin t'i jepnin Bardhën, ai do të vriste veten! Dhe s'ish nga ata që s'e mbante fjalën. Tërë ajo dashuri e madhe mbytej nga vërvshimi i pikëllimit. Në një buzëmbrëmje, me koburen në dorë, drejtuar nga vetia, vetëm çudia e shpëtoi se për të shkrehur e shkrehu! Gjëmimi i armës ende kumbon në ato anë. Kaq u desh. Kapiteni u detyrua të ekte nëpër një kalvar mundimesh e vuajtjesh. I harruar dhe nga shokët e miqtë, u zhduk po aq befasisht sa ishte shfaqur. Baresha me shami nejloni, me atë shami që s'e pa më dritën e diellit, iu nënshtrua fatit të zi! U nis nuse për tek ishte taksur, duke u munduar të zbukuronte atë portret të shëmtuar që patën ngritur për të. Më kot përpiquej t'i zvogëlonë kokën e madhe, t'ia shtronë ata flokët iriq, apo nga buall ta shndrronte në qëngj. Si të mos mjaftonte kjo e keqe e pranuar me mundim, ajo që i ndodhi më pas, ishte plotësisht shkatërruese. Në ditën e parë të martesës, në shtratin bashkshortor, nuk gjeti atë, por vëllain e tij, çalamanin, që dikur e patën gjuajtur për derr, pikërisht atë shulakun që të krijonte sot e gjithë ditën përshtypjen se nuk rruhej kurrë, shulak që prej kaq vjetësh quhet ende si burri i saj ...

### 3.

Bardha s'dihej qysh kur ishte ngritur në këmbë. Si somnambul i vërtetë, vërtitej rrëth trungut të shegës. Ajo po qante gati me dënesë. Kishte kujtar vite dhe kishte qarë. E kapi një dëshirë lehtë-lehtë të hynte në odën e vjehrës e pasi të kundronte mirë e mirë atë fytyrë të bardhë, hënore, të mbeshteste kokën tek këmbët e saj e të prehej deri në agim. Pse të ishte aq fatkeqe rinia e saj? Pse, kur ajo buron vetëm ëmbëlsi e pastërti si rrallë kush në atë familje? Si mund të shkatërrhej dashuria e saj me kapitenin e artilerisë, ajo dashuri që ishte kthyer në një histori të dhimbëshme e tregohej gojë më gojë! Madje edhe sot, kur baresha me shami nejloni festonte 75 vjetorin e jetës, kishte njerëz që pohonin se ajo dashuri kurrë nuk u shkatërrua, se ja, baresha, vjehrra e saj e kishte rigjetur kapitenin dhe kishte bërë dashuri me të për shumë vjet me radhë pas martesës së dhunëshme me çalamanin. Tregonin se ai çalamani, një verë të tërë e kishte kaluar sipër fikut të madh ku kishte ngritur një tendë të fshehur dhe nga ku përgjonte lëvizjet e së shoqes, me shpresë se do ta kapte atë, së bashku me kapitenin e saj, siç i thonë fjalës, me presh ndër duar. Njerëzit e ngacmonin çalamanin, e thumbonin duke i thënë se... "Ja... ç'të gjen kur e merr gruan të bukur, se kur vet çalon

në të majtën, s'është keq që të gjesh një grua që të çalojë në të dyja", madje pati që shkuan dhe më tej. "Deri sa ty të erdhi e mira në thes, e pra, kuptohet që s'mund ta gëzosh vet, përndryshe ç'të bëjmë ne të gjorët që të mirën as me gisht s'e ngjyejmë dot?" Këto e marrosën çalamanin dhe e detyruan të hipte majë fikut fill me t'u errur dhe deri në agim. Pagjumësia e natës mbushej për bukuri gjatë tërë ditës së bardhë, ku ai, përsëri po aty në tendën e vet, prehej dhe bënte një gjumë për shtatë palë qejfe. Në një rast të tillë, tregonin, pra, kur dielli përvëlonte dynjanë. Kapiteni i Artilerisë pasi i kishte dhënë shenjën e zakonshme të dashurës së tij, kishte pritur një çast e pastaj, që të dy, ai dhe ajo, kishin qenë në një mendje, të shkonin për të bërë dashuri tamam atje nën hijen e fikut të madh. S'ka më mirë se hija e asaj peme për të përballuar vapën. Të dy të dashuruarit u puthën e u përqafuan, bënë edhe atë punë, për të cilën digjeshin të dy, dhe pas kësaj, kapiteni, pak i lodhur por i lumturuar sa më s'bëhej, i gjatë si ishte, u shkuluar mbi degën që kishte mbi kokë. Ku ja, atë çast i kapi syri çalamanin që bënte një gjumë vdekjeje. Të dy të dashuruarit diç kukurisën me njëri-tjetrin. Kapiteni zgjodhi nja dy kokrra fiq rrek, pra fiq të tharë e të vyshkur, i lidhi me një fije bari së bashku, u ngjit paksa në trungun e pemës dhe me ngadalë lëshoi drejt hundës së çalamanit, dy kokrrat e vyshkura të fiqve, të cilat ashtu siç tundeshin, duke shën si hallatet e një keci të vogël.

#### 4.

Nusja e djalit të madh vuri buzën në gaz. Asaj qejfi ia donte të kishte ndodhur kështu, por pak e besonte, madje jo vetëm këtë, por edhe gjëra të tjera që kishte dëgjuar rreth vjehrës së saj dhe kapitenit i quante shpifje, thashetheme. Por kur ky thashethem u tha nga një njeri i fisit të tyre, dhe iu tha vjehrës në sy, nusja u trondit tej mase. Ajo, tani mbështetur pas shegës e me sy drejt qillit të thellë, u ndje pak e lodhur. Nuk donte ta kujtonte atë rast, kishte të bënte direkt me të, por ja, atë **natë kujtimet e kishin vënë** tërësisht nën vete... Bëhej një **dasëm tek** një fqinj i tyre. Kur dasma kishte arritur në harenë e saj, një kushëri i largët i të shoqit, student i vitit të parë, që e kishte marrë **vesh** se ajo kishte mbetur qysh **prej** tre vjetësh **me** barrë, e jo se i shoqi i kishte vdekur, jo, ai ishte mirë e shëndoshë si molla, por për burrë buk bëhej më, pasi ishte aksidentuar në vend të lig, aty ku mashkulli mbaron si mashkull. Studenti e kishte provokuar dhe nja dy tri herë më parë Bardhën, por nuk i kishte ndezur, kështu që gjeti një çast dobësie të saj aty

në dasëm, e tërroqi gati me forcë në fund të oborrit, duke e mbuluar përgjatë rrugës me të puthura e ledhatime, dhe aty rrëzë gardhit kur edhe ajo s'po kundërshtonte dot se digjej nga afshi i mashkullit, prej vitesh të harruar, ai e shtriu dhe plot pasion. plot forcë rinie me buzët herë mbi gjinjtë e saj, herë mbi buzët e nxehtha e thithëse të nuses, e kreua sa hap e mbyll sytë atë punë, duke gërtihitur e gulçuar sikur ta gudulisin nënjetë duar një herësh. Ndoshta kjo zhurmë e pruri vjehrren, nënëmadhen aty pranë, e cila, sakao, e kapi studentin për veshi duke i thënë mistrec, kurse ky, si gjeli majë plehut ia pati:

-Ti shiko Kapitenin e Artilerisë, atë shiko!

Vjehrра u largua tutje në errësirë, ndërsa nusja ishte mbledhur kulaç e dridhej si purteka. Studenti e ngushëllonte duke i thënë se në se ajo do të bëjë ndonjë gjë të ligë, do të bëjë... çfarë mund të bëjë?

-Unë qysh nesër do t'i mbush muret e lagjes me emrin e Kapitenit të Artilerisë. Dy ditë më pas, vjehrра e thirri nusen e i tha:  
- Ti je e re, shumë e re, prandaj je edhe e lirë të bësh si të duash. Unë të kam dashur dhe do të të dua...

Nusja qau me lot përvëlues. Thellë donte t'i hidhej në qafë, por s'guxonte. Kishin kaluar vite dhe ai muhabet kurrë s'u hap më. Pse ma fali? - pyeste veten nusja. -Pse? Mos ndoshta nga që edhe unë ia dija më së fundi një sekret të saj?! Të ishte ky shkaku që ajo s'më kallzoi, s'më dënoi?! Po, pse ç'sekret i kisha mbuluar? Aq sa ç'tha studenti, unë kisha kohë që e dija, veçse pasi ia tha ai, dhe ia tha në sytë e mi, mua më dukej sikur ç'ka përflytej, s'përflytej ashtu, kot më kot. Ndërkohë, më vonë, kur pas asaj ngjarje, asgjë s'ndryshoi në marrdhëni e atyre të dyjave, ku çdo gjë u kthye në rrjedhën e zakonshme po aq normalisht si gjithnjë, nusja e djalit të madh përpinqej të shpjegonte ato fjalët e vetme që i pat thënë vjehrra: "...Ti je e re, je e lirë..." Ç'fshihej pas tyre? Mos vallë me ato dy fjalë ajo kishte dashur t'i thoshte se sakrifica jote, me burrë e njëherazi pa burrë, s'ishte e vlefshme, s'kishte pse bëhej? Dhe vërtetë a s'po ndihej ajo kohë e pa kohë më e lodhur, më e drobitur? Pse t'i thahej barku, të mbetej qyqe, pa fëmijë, kur ende ishte e re dhe e freskët? Po sikur të ishte ajo në vendin tim ç'do të bënte, do të çante përpara, do të ikte? Po pse s'e bëri kur i ra mbi kokën e vet? Pse e keqë më e vogël ishte ajo që i rrëmbue rininë dhe bukurinë asaj? Shumë ujra kanë rrjedhur nga ajo kohë! Ujra kanë rrjedhur, por ngjarjet s'janë ujra dhe kurrë s'rrjedhin si ujë! Me ato ç'ka tha, me ato fjalë që thellë-thellë as vet s'i kuptonte, u përhoq të ngushëllonte vetveten.

që në atë çast një drithërimë i përfshiq gjuniët dhe falë trungut të shegës se do të ishte përplasur për tokë sa gjatë-gjerë.

-Qyqja! -tha -sa shumë fola këtë natë.

I dukej vetia sikur të ishte kthyer prej një udhëtimi të lodhshëm e të gjatë, po edhe e kënaqur që më në fund kishte mbrritur aty ku duhej. S'po mendonte gjë tjetër, veçse të shkonte me të shpejtë në shtratin e vet, për të kaluar me gjumë ato orë të mbeturatë natës.

## 5.

U largua me të shpejtë prej shegës ku kaloi tërë atë kohë. Me të dalë në rrugicën e kalldrëmtë, gati ngriu në vend. Një hije vidhej rrëzë murit të shtëpisë. Herë shfaqeja, herë zhdukej, herë ecte urithi dhe herë në këmbë. Kur doli aty nën dritëzën tek dera kryesore, u pa qartë që ishte hije njeriu. Nusja, gjithnjë pa guxuar të merrete aq frymë, u tmerrua kur hija pasi hyri brenda i vuri edhe llozin derës. Që s'ishte nga njerëzit e shtëpisë, kjo nuk diskutohej. Po ç'të ishte? Vjedhës? Në se ishte vjedhës përsë duhej të vinte llozin! Nusja e djalit të madh e mblođhi veten. I ra me kujdes përqark shtëpisë dhe trokiti në dritaren e dhomës së saj, që s'ish më e lartë se një bojë njeriu nga toka. Prej aty i shoqi u zgjat paksa e sakaq nusja u gjend brenda. Shumë shpejtë njerëzit e rritur të shtëpisë, të alarmuar tej mase zunë të kontrollojnë nëpër dhomat e fëmijëve, në katin e parë e të dytë, në dhomën e miqve, në të dyja banjot, por asgjë nuk u duk.

Nusja e djalit të madh nuk tërhiqej. Atëherë kontrolluan në dhomën e plakut, që bënte gjumë lepuri. Ky me të marrë vesh si ish puna, kërceu përpjetë!

-Të kontrollohet shtëpia, brenda dhe jashtë!

-Jashtë s'është nevoja, -tha djali i madh. -Llozin ai që ka hyrë brenda ia ka vënë vet derës.

-Ku është plaka? -pyeti.

-Vetëm dhoma e saj s'është...

Ai, sikur mezi ta kishte pritur këtë rrëmbeu një shkop, që rrallë e përdorte dhe çalë-çalë shpejtoi për tek oda e nënëmadhes. Trokiti, trokiti fort disa herë, por edhe pse u bë gjithë ajo zhurmë, andej vinte vetëm heshtja, veçse inati i çalamanit s'kish të rreshtur.. Përsëri zhurmë e përsëri trokitje të egëra.

-Ç'është? -u dëgjuar zëri i asaj më në fund.

-Hape derën! Dikush na ka hyrë në shtëpi.

-Shko fli, shko o i uruar! -foli butësisht nënëmadhja.

-Nuk jam vetëm unë këtu prapa derës, jam ...

-Të gjithë një ëndërr paskeni parë?... Shkoni, shkoni flini!

Po pse tërhiqej çalamani? Djemtë u vunë në mëdyshje, por ai si kurrë ndonjëherë i urdhëroi të bënин çmos të hapej dera. Nusja e djalit të madh, herë pas here, shikonte nga plaku. Inati, egërsia si dhe një urrejtje që dallohej edhe tek ato trokitje në derë, ajo kurrë s'i kishte vënë re tek ai. Diçka parandjeu, diçka të keqe dhe vetveti i vajti mendja tek Fata, madje e quante të domosdoshme praninë e saj aty në mes të të tjerve.

-Hape, hape derën, -ulërinte plaku.

-Të zbardhi dita, ja po zbardh, -u dëgjua zëri i nënëmadhes.

Përsëri të bërtitura, zhurmë! Plaku po shkallonte.

Po ti hape, të shkretën! -tha një nga djemtë.

-Ashtu! Më thërrisni Fatën! -tha nënëmadhja.

Nusja e djalit të madh, që e pati me kohë këtë mendim, tashmë e kishte kapërcyer oborrin e shtëpisë, e ndjekur nga pas prej një frike të plotë. Kur ato të dyja u kthyen, aty tek oborri shtangën. Plaku tashmë ulërinte. Fata vrapi është koridorin e gjatë. Kur mbrriti në fund të tij, nënëmadhja sikur e parandjeu ardhjen e saj dhe hapi ngadalë derën. Të gjithë, me në krye çalamatin u dyndën brenda.

-Nxirre, nxirre! Ku e ke fshehur! -bërtiste plaku.

Në të vërtetë ajo s'kishte fshehur kërkënd. Ata që ishin më të qetë, djemtë, nuset dhe Fata, aty në fund të shtratit, në këmbë, vështronin ngultasi e tërë befasi një plak të hollë, tepër të gjatë dhe me një palë mustaqe spic, por të bardha, të bardha ...

-Kapiteni, kapiteni i artilerisë, -belbëzoi dikush.

Djali i madh u sul me grushtin përpjetë drejt tij, po nënëmadhja ia preu rrugën. Grushti i tij gati ra mbi fytyrën e saj, veç në atë kohë Fata iu sul të vëllait si një shqipe e vërtetë, duke ia ngulur dhëmbët mu tek kyçi i dorës së mbledhur grusht.

-Mjaftë, mjaftë! Bëni tutje! -thirri nënëmadhja, me një ton të tillë që do të prapste qoftë dhe një ushtri të tërë. -Ti, ti, -vazhdoi t'i thërriste djalit të madh, -hajd, shko tek yt at -dhe tregonte me gisht çalamatin, -ndërsa ju...

Dy djemtë e tjerë e kishin humbur paq! I mesmi, që shquhej për guxim e gjaknxehtësi, kishte vënë duart në kokë dhe gulçonte si të ishte plagosur mbi zverk. I vogli shtrëngonte motrën pranë vetes e cila qante, veçse qante.

-Ju të dy dhe ti, Fata, -foli nënëmadhja, që tani përfundimisht e kishte vënë situatën nën vete. -Ju të tre, këtij plaku që qëndron aty

në bisht të shtratit, i puthni dorën! ... Ai është babai juaj!

Në dhomë sikur ra tavani. Të gjithë mezi mbusheshin me frysë, të gjithë sikur nuk guxonin, a nuk donin të shikonin njërit-tjetrin. Sikur të vinte prej një pusi të thellë, u dëgjua zëri i mekur i Fatës, që më tepër belbëzoi emrin e të ëmës.

-Bija ime, -ia ktheu ajo. -Dua t'i jetoj këto dy ditë që më kanë mbetur, krejt ndryshe nga këta 75 vjet ...ë, mirë e kam?

I hodhi dorën mbi flokë dhe si me frikë ia afroi kokën për nga gjoksi i vet.

Nga jashtë, hipur mbi shegën e vetme a mbi fikun e madh, erdhi një këngëzim ngjethës shpendi. Qyqja rrallë këndonte aty. Nusja e madhe sokëlliu disa herë, pastaj me gurë qëllonte drejt shegës, herë qëllonte për nga fiku. Pas pak, ajo e shquajti shpendin mbi fikun e madh dhe zuri të hidhte gurë përmbi të.